



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Tregjet potenciale për eksport

Mars 2015



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND



*Empowered lives.
Resilient nations.*

**Tregjet potenciale për eksport
për
Sektorët e përpunimit të ushqimit, bujqësisë, përpunimit
të drurit, materialeve ndërtimore, turizmit dhe punimeve
artizanale**

MIRËNJOHJE

Financuar nga Ministria për Punë të Jashtme të Finlandës në kuadër të projektit Ndihmë Tregtisë.

Raporti i përpiluar nga:

Gëzim Tosuni – **Autorë**

Visar Vokrri – **Autorë**

Kontribut i veçantë i ofruar nga:

Vlerësimi i Cilësisë, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë:

Teuta Purrini Xhabali, Menaxhere e projektit, “Ndihmë Tregtisë”

Artane Rizvanolli, Konsulente e jashtme

Anita Smailovic, Bashkëpunëtorë projektit, “Ndihmë Tregtisë”

Erëblina Elezaj, Analiste për hulumtim, Ekipi për Hulumtime dhe Politika, Çështje Gjinore dhe Komunikim

Iris Duri, Statisticiente, Ekipi për Hulumtime dhe Politika, Çështje Gjinore dhe Komunikim

Burbuqe Dobranja, Bashkëpunëtorë për Informim Publik, Ekipi për Hulumtime dhe Politika, Çështje Gjinore dhe Komunikim

Danijela Mitić, Analiste për Komunikim, Ekipi për Hulumtime dhe Politika, Çështje Gjinore dhe Komunikim.

Ky dokument nuk ka të drejta të rezervuara, prandaj përmbajtja e pjesshme apo e tërësishme mund të përdoret pa lejen paraprake të UNDP-së. Sidoqoftë, burimi duhet cituar.

Analizat dhe rekomandimet në këtë raport paraqesin qëndrimet e autorëve dhe nuk paraqesin qëndrimin zyrtar të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Ministrisë për Punë të Jashtme të Finlandës.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	5
1. HYRJE	7
2. SHKËMBIMET TREGTARE	8
3. REGJIMI TREGTAR	10
3.1. Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA)	11
3.2. Preferenca Autonome për Tregti e BE-së (PAT)	12
3.3. Marrëveshja e tregtisë së lirë me Turqinë	12
3.4. Sistemi i Gjeneralizuar i Preferencave të SHBA-ve (SGjP)	12
4. TREGJET POTENCIALE PËR EKSPORT	13
4.1. Bashkimi Evropian	13
4.1.1. Vështrim	13
4.1.2. Marrëdhëniet me Kosovën	14
4.1.3. Pasqyrë e tregut	15
4.1.3.1. Përpunimi i ushqimit	15
4.1.3.2. Bujqësia	15
4.1.3.3. Përpunimi i drurit	16
4.1.3.4. Materialet ndërtimore	16
4.1.4. Procedurat e Përgjithshme të Importit të BE-së	16
4.1.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës	19
4.1.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore	21
4.1.6.1. Kërkesat teknike	21
4.1.6.2. Kërkesat mjedisore	22
4.1.7. Kërkesat e sektorit	23
4.1.7.1. Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia	23
4.1.7.2. Kërkesat për eksport për përpunim të ushqimit dhe bujqësi	25
4.1.8. Përpunimi i drurit	25
4.1.9. Materialet ndërtimore	26
4.2. Shtetet në CEFTA	28
4.2.1. Shqipëria	28
4.2.1.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike	28
4.2.1.2. Marrëdhëniet me Kosovën	28
4.2.1.3. Pasqyrë e tregut	29
4.2.1.4. Procedurat e përgjithshme të importit	31
4.2.1.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës	32
4.2.1.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore	33
4.2.1.7. Kërkesat e sektorit	34
4.2.2. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)	35
4.2.2.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike	35
4.2.2.2. Marrëdhëniet me Kosovën	35
4.2.2.3. Pasqyrë e tregut	36
4.2.2.4. Procedurat e përgjithshme të importit	37
4.2.2.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës	38
4.2.2.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore	39
4.2.2.7. Kërkesat e sektorit	40
4.2.3. Mali i Zi	42
4.2.3.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike	42
4.2.3.2. Marrëdhëniet me Kosovën	42
4.2.3.3. Pasqyrë e tregut	43

4.2.3.4. Procedurat e përgjithshme të importit	44
4.2.3.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës	45
4.2.3.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore	46
4.2.3.7. Kërkesat e sektorit	47
4.2.4. Serbia	50
4.2.4.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike	50
4.2.4.2. Marrëdhëniet me Kosovën	50
4.2.4.3. Pasqyrë e tregut	51
4.2.4.4. Procedurat e përgjithshme të importit	53
4.2.4.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës	53
4.2.4.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore	54
4.2.4.7. Kërkesat e sektorit	55
4.2.5. Bosnja dhe Hercegovina	56
4.2.5.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike	56
4.2.5.2. Marrëdhëniet me Kosovën	56
4.2.5.3. Pasqyrë e tregut	57
4.2.5.4. Procedurat e përgjithshme të importit	59
4.2.5.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës	60
4.2.5.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore	60
4.2.5.7. Kërkesat e sektorit	61
4.3. Turqia	63
4.3.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike	63
4.3.2. Marrëdhëniet me Kosovën	63
4.3.3. Pasqyrë e tregut	65
4.3.4. Procedurat e përgjithshme të importit	66
4.3.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës	70
4.3.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore	72
4.3.7. Kërkesat e sektorit	73
4.4. Shtetet e Bashkuara të Amerikës	77
4.4.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike	77
4.4.2. Marrëdhëniet me Kosovën	77
4.4.3. Pasqyrë e përgjithshme e tregut	78
4.4.4. Procedurat e përgjithshme të importit	80
4.4.5. Kriteret teknike dhe të ambientit të sistemit të importit	82
4.4.6. Kriteret e sektorit	83
5. PROFILET E SEKTORIT	86
5.2. Bujqësia dhe Përpunimi i ushqimit	86
5.3. Materialet ndërtimore	91
5.4. Përpunimi i drurit	95
5.5. Zejet artizanale	97
5.6. Turizmi	99
6. VËREJTJE PËRMBYLLËSE	104
REFERENCAT	107

LISTA E SHKURTESAVE

AMCHAM	Oda Ekonomike Amerikane
APHIS	Shërbimi i Inspektimit Shëndetësor për Shtazë dhe Bimë
AUB	Administrata për Ushqim dhe Barna
BE	Bashkimi Evropian
BH	Bosnja dhe Hercegovina
BNRZH	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
CBP	Mbrojtja Doganore dhe e Kufirit
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore
CEN	Komiteti Evropian për Standardizim
CENELEC	Komiteti Evropian për Standardizim Elektroteknik
CIF	Kosto, Sigurim dhe Transport
DVA	Dokumenti i Vetëm Administrativ
EFTA	Shoqata Evropiane për Tregti të Lirë
ENS	Deklarata Përmbledhëse në Hyrje
EXS	Deklarata Përmbledhëse në Dalje
FMB	Fondi Masiv për Banim
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IARM	Instituti për Akreditim i IRJM-së
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
ISPM	Standardi Ndërkombëtar për Masa Fitosanitare
ITS	Institucioni Turk për Standarde
KE	Komisioni Evropian
KNMB	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve
KSTN	Klasifikimi Standard i Tregtisë Ndërkombëtare
MAD	Materiali Ambalazhues nga Druri
MARA	Ministria për Bujqësi dhe Çështje Rurale
MB	Mbretëria e Bashkuar
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural
MFN	Kombi më i Favorizuar
MINFAL	Ministria për Ushqim, Bujqësi dhe Bagëti
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
MTL	Marrëveshje për Tregti të Lirë
NAFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Amerikën Veriore
NMR	Niveli Maksimal i Radikalëve
NQO	Ndotësit e Qëndrueshëm Organik
OBD	Organizata Botërore e Doganave

OBT	Organizata Botërore Tregtare
PAT	Preferenca Autonome për Tregti
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
REACH	Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i materialeve kimike
RIOE	Regjistrimi dhe Identifikimi i Operatorit Ekonomik
RRPN	Rregullorja e Produkteve të Ndërtimit
SPP	Sistemi i Përgjithësuar i Preferencave
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
ShSUI	Shërbimi për Siguri Ushqimore dhe Inspektim
SHZHN	Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar
TJP	Tarifa e Jashtme e Përbashkët
TKV	Taksa për Konsum të Veçantë
TVSH	Taksa mbi Vlerën e Shtuar
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USDA	Departamenti për Bujqësi i SHBA-ve
ZMB	Zyra për Menaxhment dhe Buxhet
ZP	Zyrë e Përhershme

1. HYRJE

Qëllimi i këtij dokumenti, i përpiluar në kuadër të projektit “Ndihmë Tregtisë” të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës¹ është i dyfishtë: i) të vlerësojë potencialin për rritjen e eksportit në sektorin e bujqësisë, ushqimit dhe pijeve, materialeve ndërtimore, përpunimit të drurit, punimeve artizanale dhe turizmit, dhe ii) të identifikojë rregullat e qasjes në treg, rregulloret dhe procedurat për eksportin Kosovar nga sektorët e sipër përmendur në katër tregje kyçe për Kosovën – Bashkimin Evropian (BE), rajonin e Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Turqi.

Duhet theksuar se ky dokument nuk është analitik apo preskriptiv – me fjalë tjera, nuk ka për qëllim të ofrojë rekomandime se si të përmirësohen aspekte të caktuara të regjimit të politikave që kanë të bëjnë me eksportet. Ky dokument është përshkruar dhe ka për qëllim të ndihmojë eksportuesit ekzistues dhe prospektiv në përpjekjet e tyre për të eksportuar me sukses produkte nga Kosova në tregjet e jashtme.

Ky dokument duhet parë si një kontribut tjetër nga UNDP-ja në përpjekjet për promovimin e eksportit Kosovar në kontekstin e strategjisë më të gjerë për të zhvilluar konkurrencë në ekonominë e Kosovës dhe krijimin e kushteve për të inkurajuar zhvillimin e një baze ekonomike të diversifikuar, me produktivitet të lartë dhe me vlerë të shtuar.

Këta gjashtë sektorë të përmendur më lartë janë përzgjedhur në bazë të një studimi mbi potencialin ekonomik të Rajonit Jugor (Prizrenit dhe rrethinës) të kryer nga projekti “Ndihmë Tregtisë”. Studimi ka vlerësuar potencialin për fitim, gjenerim të hyrash dhe eksport të një numri të aktiviteteve ekonomike. Bazuar në ato të gjetura dhe shqyrtimin e shkëmbimeve tregtare të Kosovës me vendet tjera sipas kategorive të mallrave, ky studim e ka identifikuar BE-në, rajonin CEFTA, SHBA-të dhe Turqinë si tregjet me potencial për eksportet Kosovare. Arsyeja kryesore pse këto vende janë më të rëndësishme për Kosovën në kuptimin e potencialit për eksport lidhet me kombinimin e faktorëve në vijim: afërsia e tyre gjeografike, madhësia e tregut të tyre, pjesëmarrja e Kosovës në marrëveshjet për tregti të lirë apo instrumentet tjera të tregtisë me këto vende, lidhja politike e kulturore (duke përfshirë prezencën e diasporës), etj.

Pjesa tjetër e këtij raporti është organizuar si në vijim. Pjesa e parë e dokumentit bënë hapjen duke ofruar informata lidhur me regjimin dhe politikat aktuale të tregtisë së Kosovës, si dhe shkëmbimet tregtare me botën e jashtme. Fokusimi është në ato kategori të produkteve të cilat Kosova tashmë i eksporton më së shumti dhe në ato vende me të cilat Kosova ka marrëveshje për tregti të lirë apo lidhje të ngushta ekonomike. Pjesa e dytë ofron një pasqyrë të regjimit të importit me tregjet e identifikuara (BE, rajoni CEFTA, SHBA dhe Turqia). Kjo pjesë shpjegon rregullat dhe rregulloret kryesore që aplikohen në secilin treg – duke përfshirë dokumentet që janë të domosdoshme për importe, tarifatat dhe taksat e importit, rregulloret teknike, rregulloret mjedisore, rregullat për origjinën, etj. Pjesa e tretë fokusohet në sektorët kyç të identifikuar – bujqësinë, ushqimin e pijet, materialet ndërtimore, përpunimin e drurit, punën artizanale dhe turizmin – dhe ofron një pasqyrë të këtyre sektorëve dhe potencialin për eksport.


¹Për UNDP, të gjitha referencat për Kosovën në këtë dokument janë bërë në kontekst me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999).

2. SHKËMBIMET TREGTARE

Pas konfliktit të vitit 1999, ekonomia kosovare kishte filluar nga zeroja dhe niveli i tregtisë ndërkombëtare nuk ka qenë i favorshëm. Me një industri prodhuese gati inekzistente ku pothuajse të gjitha mallrat e konsumit importoheshin, në atë kohë Kosova “eksportonte” pothuajse vetëm para të gatshme.

Bilanci i vazhdueshëm negativ i tregtisë është një prej problemeve më serioze të Kosovës prej vitit 1999. Deficiti tregtar i Kosovës është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, duke arritur nivelin më të lartë prej 2.2 miliard euro në vitin 2012, që ishte ekuivalente me 45% të BPV-së së saj. Edhe pse eksporti është rritur çdo vit mesatarisht rreth 23% nga viti 2005 deri në vitin 2013, krahasuar me rritjen mesatare të importit prej 10% gjatë periudhës së njëjtë, dallimi është ende shumë i lartë (Figura 1). Mesatarisht, eksportet kanë mbuluar vetëm 11% të importeve në dekadën e fundit me një trend të lehtë të rritjes gjatë kësaj periudhe. Vlera totale e eksporteve kosovare gjatë kësaj periudhe nëntë vjeçare ka arritur gati shumën prej 1.9 miliard euro.


Figura 1. Shkëmbimet tregtare të Kosovës ('000 Euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Partnerët tregtarë kryesorë të Kosovës janë vendet e BE-së si dhe vendet në rajon (vendet anëtare të CEFTA). Aktualisht Kosova importon nga 130 vende të ndryshme të pesë kontinenteve. Megjithatë, siç shihet nga Figura 2 më poshtë, Kosova importon kryesisht nga BE-ja dhe vendet anëtare të CEFTA-s me një pjesë prej më shumë se 70% të mbarë importit. Sa i përket importeve, një partner tjetër i rëndësishëm për tregti është edhe Turqia. Mesatarisht 7% e gjithë importeve kosovare vijnë nga Turqia. Importet nga Zvicra dhe SHBA-të si dy partnerë strategjik janë ende të ulëta – gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, mesatarisht 3% e të gjitha importeve kanë qenë me origjinë nga këto dy vende.


Figura 2. Partnerët e Kosovës në import



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Ngjashëm me importet, eksportet kosovare janë gjithashtu të orientuara drejt vendeve të rajonit si dhe vendeve të BE-së, kryesisht për shkak të marrëveshjeve ekzistuese tregtare. Mesatarisht 80% e mallrave "made in Kosovo – prodhuar në Kosovë" eksportohen në vendet anëtare të BE-së dhe CEFTA-s. Zvicra është tregu i gjashtë më i madh i Kosovës; mesatarisht 5% e të gjitha eksporteve kosovare gjatë periudhës 2005-2013 janë destinuar për tregun e Zvicrës. Kjo ndoshta mund të i atribuohet përqendrimit të lartë të diasporës kosovare në këtë vend. Vlerësohet se gati 25% e mbarë diasporës kosovare (mbi 700 mijë) jetojnë në Zvicër². Ekziston një trend në rritje i eksportit kosovar drejt Turqisë, që ka arritur nivelin më të lartë në vitin 2012 me vlerë totale prej 11.3 milion euro apo 4% e të gjitha eksportit.

Figura 3. Eksportet kosovare sipas partnerëve tregtarë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

²Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë (2014), UNDP

3. REGJIMI TREGTAR

Kosova ka aprovuar strategji të gjërë të politikave tregtare që bazohet në promovimin e eksportit dhe zëvendësim të importit. Për të arritur këto synime, janë ndjekur disa objektiva të politikave. Ato përfshijnë integrimin e Kosovës në tregjet dhe regjimin doganor dhe të taksave doganore rajonale dhe të BE-së, që kanë për qëllim lehtësimin e prodhimit vendor dhe eksportit. Përveç kësaj, janë bërë edhe projekte për promovimin e konkurrencës së produkteve kosovare.

Taksat doganore janë relativisht të ulëta dhe të favorshme për zhvillimin e prodhimit vendor. Miratimi i normës fikse doganore prej 10% për shumicën e mallrave e bën implementimin e thjeshtë dhe të përballueshëm në kosto. Për të lehtësuar prodhimin vendor, një numër i lëndëve të para dhe mallrave kapitale që përdoren në prodhim industrial dhe bujqësor janë liruar nga taksat doganore. Kjo masë është një instrument për të rritur konkurrencën e industrive të brishta vendore. Përveç kësaj, janë futur edhe lirimet nga taksat doganore dhe nga Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për import të lëndëve të para thelbësore dhe të mirave kapitale. Në fund, ligji i ri për doganat ofron instrumente të mjaftueshme për minimizimin e kostove administrative që kanë të bëjnë me tregtimin e jashtëm.

Kodi Doganor i Kosovës ka përcaktuar disa instrumente lehtësuese të tregtisë. Ai është në përputhshmëri në të gjitha aspektet (tatimimin, procedurat dhe shkeljet) me BE-në dhe Organizatën Botërore të Doganave. Në pjesën që ka të bëjë me autoritetet doganore dhe shkeljet, ai gjithashtu është në përputhshmëri me standardet e të Drejtave Njerëzore. Sistemi doganor është i bazuar në modelin e BE-së të Administrimit Doganor modern, ku taksat, autoritetet, shkeljet, garancitë dhe procedurat me ndikim ekonomik janë të përcaktuara me ligj (Kodi Doganor), derisa Shërbimit Doganor i është dhënë detyra për të implementuar dhe zbatuar atë.

Kodi përcakton disa instrumente që lehtësojnë tregtimin andaj edhe është bazament për politikat e ardhshme të tregtisë:

- *Deponimi doganor*, ofron mundësinë e deponimit të mallrave të importuara nën kontrollin doganor pa pasur nevojë të paguhen taksat doganore derisa mallrat nuk lëshohen për shitje në tregun vendor apo ri-eksportohen në tregje tjera.
- *Lirimi nga procedimi i brendshëm*, ofron mundësinë e importimit të mallrave nga jashtë me lirim me kusht nga tarifat e taksat doganore, përpunimin e tyre dhe më pas ri-eksportimin e tyre.
- *Përpunimi nën kontrollin doganor*, ofron mundësinë e importimit të mallrave nga jashtë dhe përpunimin e tyre nën kontrollin doganor dhe më pas lëshimin e tyre në qarkullim të lirë si mallra të përpunuara duke u caktuar atyre trajtim tjetër të aprovuar nga dogana.
- Instrumente tjera të rëndësishme si *transiti*, *pranim të përkohshëm* dhe *informata detyruese*.

Kosova aktualisht përfiton nga tregtimi pa taksa doganore jo-reciprok me tregun e BE-së nën Preferencën Autonome të Tregtisë (ATP) të BE-së. Me këtë marrëveshje, restriksionet sasiore dhe cilësore mbesin në fuqi për një numër shumë të kufizuar të mallrave. Përveç kësaj, Kosova ka marrëveshje të tregtisë së lirë me shtetet e Evropës Jug-Lindore, sipas CEFTA-s, e cila u ofron eksportuesve kosovar qasje pa taksa doganore tek më shumë se 520 milion konsumatorë. Veç kësaj, përafërsisht 3,500 produkte të ndryshme kosovare janë të lejuara të futen në SHBA pa taksa doganore bazuar në Programin për Sistemin e Gjeneralizuar të Preferencave. Megjithatë, duke marrë në konsideratë distancën gjeografike ndërmjet këtyre dy vendeve, vlera e eksporteve kosovare drejt tregut të SHBA-ve mbetet simbolike. Një tjetër Marrëveshje për Tregti të Lirë që hapë treg të madh për eksportuesit kosovar është ajo me Turqinë. Këto marrëveshje tregtare do të shtjellohen më tej në pjesët në vazhdim.

3.1. Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA)

Me të nënshkruar të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) për Paktin e Stabilitet në fund të vitit 2002, Kosova ka filluar të marrë pjesë në takimet e Grupit Punues të Paktit të Stabilitetit për Liberalizim dhe Lehtësim të Tregtisë. Qëllimi kryesor i pjesëmarrjes së Kosovës në këtë iniciative ka qenë nënshkrimi i Marrëveshjeve për Tregti të Lirë (MTL) me nënshkruesit e MM-së, të kontribuojë në largimin e barrierave pa-tarifë të tregtisë (BPT) dhe të përmirësojë marrëdhëniet e saj tregtare me palët tjera pjesëmarrëse. Në mes viteve 2003 e 2007 Kosova ka negociuar dhe ka arritur MTL bilaterale me Shqipërinë, Ish Republikën Maqedonase të Jugosllavisë (IRMJ), Bosnjën dhe Hercegovinën (BH) dhe Kroacinë. Në fund të vitit 2006, Kosova i bashkëngjitet CEFTA-s së zgjeruar dhe të gjitha MTL-të bilaterale janë mbuluar me këtë marrëveshje.

CEFTA është marrëveshja më e rëndësishme për tregti për të cilën Kosova ka negociuar dhe ka nënshkruar deri më sot. Ajo hap tregtinë me tregun rajonal që përbëhet nga Shqipëria, BH-ja, IRMJ-ja, Mali i Zi, Moldavia dhe Serbia. Disa nga karakteristikat e marrëveshjes CEFTA janë:

- Mbështetë më tutje rrjetin paraprak të MTL-ve bilaterale në rajon (Kosova kishte MTL bilaterale me Shqipërinë, IRMJ-në, BH-në dhe Kroacinë).
- Përshtatet plotësisht me rregullat dhe procedurat e Organizatës Botërore për Tregti (OBT).
- Mbanë dhe gradualisht rrit shkallën e liberalizimit dhe bashkëpunimit.
- Harmonizon substancën e politikave tregtare për të rritur transparencën, rrisë parashikueshmërinë dhe eliminojë pengesat burokratike.
- Harmonizon procedurat e lidhura me Standardet Sanitare dhe Fito-Sanitare dhe Barrierat Teknike në Tregti dhe siguron implementimin e drejtë.
- Përfshinë dispozitat për çështjet e politikave moderne të tregtimit, posaçërisht në lidhje me konvergjencën e rregullave dhe rregullativave për mallrat dhe shërbimet dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me tregtinë.
- Ofron kornizën që lejon vazhdimin e bashkëpunimit dhe liberalizimin gradual, në veçanti me atë që ka të bëjë me çështje të reja si shërbimet, [dhe kornizën për të mundësuar rregulla të përbashkëta për investime.]
- Përfshinë procedura të qarta dhe efikase për zgjidhje të kontesteve dhe mekanizmin për të përmirësuar pajtueshmërinë e të gjitha palëve me marrëveshjen dhe rregullat OBT-së, duke përfshirë pajtueshmërinë e palëve që nuk janë ende anëtarë të OBT-së.
- Ofron kornizë të përshtatshme institucionale për të menaxhuar marrëveshjen dhe për të shqyrtuar implementimin efikas të saj [që mbulon për shembull rolin e Thesarit, Komitetit të Përbashkët, ekspertëve dhe organeve tjera, rolin në të ardhmen e grupit punues për tregti, etj].

Përfitimet kryesore të pritura nga pjesëmarrja e Kosovës në marrëveshjen CEFTA janë:

- Rritja e tregtisë dhe investimeve direkte, duke ulur barrierat tregtare dhe duke përmirësuar transparencën në biznes.
- Lehtësimi i administrimit të regjimeve tregtare dhe jo-tregtare, duke arritur kështu shfrytëzim më të mirë të burimeve të limituara.
- Aderim të përmirësuar nga të gjitha palët për dispozitat për liberalizim të tregtisë që janë pjesë e rregullave dhe procedurave përkatëse të OBT-së.
- Mekanizëm efikas për zgjidhjen e kontesteve tregtare ndërmjet palëve.
- Zhvillim të mëtejshëm të marrëdhënieve me BE-në dhe avancim në integrimin në sistemet ndërkombëtare të tregtisë (më pas edhe në OBT).

3.2. Preferenca Autonome për Tregti e BE-së (PAT)

Aktualisht, Kosova gëzon qasje jo reciproke pa taksa doganore në tregun e BE-së siç është përcaktuar me Regjimin për Preferenca Autonome për Tregti të BE-së. Për një gamë të vogël të mallrave, siç janë vera dhe mishi i gjedheve, mbesin në fuqi kufizimet sasiore. Edhe pse BE-ja ofron mundësi të shumta të tregut, prodhuesit kosovarë aktualisht nuk janë duke shfrytëzuar të gjitha përparësitë e kësaj marrëveshje. Duke marrë në konsideratë këtë mundësi, do të duhet të kishte më shumë prodhime vendore që i plotësojnë standardet dhe kërkesat e BE-së dhe në këtë mënyrë do të mund të konkurronin me sukses në tregun e BE-së. Kosova ka përfunduar negociatat me BE-në për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), e cila paraqet një arritje të rëndësishme në procesin e integritit Evropian të Kosovës. Përmes implementimit të marrëveshjes, BE-ja dhe Kosova gradualisht do të caktojnë zona bilaterale të tregtisë së lirë ku lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit është e garantuar nga të dyja palët. Kosova do të harmonizojë legjislacionin e saj me rregullat e BE-së sa i përket konkurrencës, prokurimit publik, të drejtave të pronës intelektuale dhe industriale dhe mbrojtjen e konsumatorit e kushtet e punës. Edhe pse përfitimet e para nga marrëveshja do të jenë të natyrës politike, arritja e MSA-së do të konsolidojë edhe më tej pozitën e Kosovës në tregun e BE-së dhe do të rrisë mundësitë për eksport dhe investime.

3.3. Marrëveshja e tregtisë së lirë me Turqinë

Në vitin 2013, Kosova arriti Marrëveshjen për Tregti të Lirë me Turqinë gjë që hapi tregun turk për mallrat industriale dhe bujqësore me origjinë nga Kosova, kryesisht si rezultat i largimit në faza të taksave doganore për shumicën e kategorive, por gjithashtu pas largimit të barrierave jo-tarifore, posaçërisht në sektorin e bujqësisë.

3.4. Sistemi i Gjeneralizuar i Preferencave të SHBA-ve (SGjP)

Që nga viti 2008, Kosova është përfshirë në Sistemin e Gjeneralizuar të Preferencave të SHBA-ve, program ky që shkurton tarifatat e SHBA-ve për shumë importe nga vendet në zhvillim, me theks të veçantë në prodhimtari të lehtë, minerale, materiale ndërtimore dhe disa prodhime bujqësore të caktuara. Në vitin 2012, SHBA-të e përtërinë SGjP-në me Kosovën, e cila mundëson që një numër i konsiderueshëm i prodhimeve kosovare të eksportohen në SHBA pa taksa të importit.

4. TREGJET POTENCIALE PËR EKSPORT

4.1. Bashkimi Evropian

4.1.1. Vështrim

BE-ja është ekonomia më e madhe në botë me BPV-në prej mbi 13 miliard euro në vitin 2013. Përveç kësaj, BE-ja është eksportuesi dhe importuesi më i madh i mallrave dhe shërbimeve, që paraqet mundësi të pafund tregtimi për eksportuesit nga Kosova që janë në gjendje të plotësojnë preferencat e konsumatorëve me produkte që përmbushin standardet dhe kërkesat e BE-së.

BE-ja është një treg i vetëm, që do të thotë se mallrat, kapitale, shërbimet dhe njerëzit mund të lëvizin lirshëm ndërmjet vendeve anëtare. Tregu i vetëm i BE-së mbështetet nga Bashkimi Doganor përmes së cilit 28 vendet anëtare krijojnë një territor të vetëm për qëllimi doganore. Kjo do të thotë që:

- Nuk paguhen taksa doganore për mallrat që lëvizin ndërmjet shteteve të BE-së;
- Të gjithë aplikojnë tarifa doganore të përbashkëta për mallrat që importohen nga vendet jashtë BE-së;
- Mallrat që janë importuar në mënyrë të ligjshme mund të qarkullojnë nëpër të gjithë BE-në pa kontrollime tjera doganore.

Tetëmbëdhjetë nga 28 shtetet anëtare të BE-së përdorin Euron si valutë të tyre. Danimarka, Suedia dhe MB-ja kanë zgjedhur që të mbesin jashtë Eurozonës, ndërsa anëtarë të pranuar rishtazi në BE duhet të përmbushin kritere të caktuara ekonomike para se të mundën të pranojnë valutën e vetme evropiane. Në Eurozonë, tregtia ndihmohet edhe përmes përdorimit të valutës së njejtë nga shumica e anëtarëve.

Fakte kyçe

- **BE-ja është ekonomia më e madhe në botë.** Edhe pse rritja parashihet të jetë e ngadaltë, BE-ja mbetet ekonomia më e madhe në botë me BPV-në për kokë banori prej 25,000 euro për 500 milion konsumatorët e saj.
- BE-ja është blloku më i madh tregtues në botë. BE-ja është tregtuesi më i madh në botë i mallrave dhe shërbimeve.
- BE-ja renditet e para si në investimet ndërkombëtare brenda kufijve ashtu edhe në ato jashtë kufijve.
- BE-ja është partneri më i madh tregtues për 80 shtete. Për krahasim, SHBA-të janë partneri më i madh tregtues për pak më shumë se 20 shtete.
- BE-ja ka 500 milion konsumatorë që kërkojnë mallra cilësore.
- BE-ja është tregu i vetëm më i madh me rregulla dhe rregullore transparente.
- BE-ja ka kornizë ligjore të sigurt të investimeve që është ndër më të hapurat në botë.
- Konkurrenca ndërmjet eksportuesve në tregun e BE-së është e fortë pasi që BE-ja është tregu më i hapur në botë për vendet në zhvillim.
- Tarifa mesatare e aplikuar për mallrat e importuara në BE është shumë e ulët. Më shumë se 70% e importeve futen në BE me zero tarifë apo tarifa të reduktuara.
- Tregjet e shërbimeve të BE-së janë shumë të hapura dhe BE-ja ka padyshim regjimin më të hapur të investimeve në botë.

4.1.2. Marrëdhëniet me Kosovën

BE-ja është partneri më i rëndësishëm i Kosovës, si në aspektin politik ashtu edhe në atë ekonomik. Aspirata e Kosovës është për t'u bashkuar në BE dhe vazhdimisht ka konfirmuar vendosmërinë e saj për bërë progres në agjendën e saj evropiane. Integrimi në BE ka qenë forca shtytëse për reforma në Kosovë. Kosova merr pjesë në Procesin e Stabilizim Asociimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor.


BE-ja, si shtetet anëtare ashtu edhe institucionet e saj, veçanërisht Komisioni Evropian, luan rol me rëndësi në rindërtimin dhe zhvillimin e Kosovës.

- 23 nga 28 shtetet anëtare të BE-së e njohin Kosovën si shtet të pavarur
- BE-ja është e pranishme në Kosovë përmes:
 - » Zyrës së BE-së në Kosovë
 - » EULEX-it
- Ambasadat e shteteve anëtare të BE-së dhe Zyrat Ndërlidhëse
- 18 shtete anëtare të BE-së mbajnë zyrë përfaqësuese në Kosovë dhe organizata të shumta joqeveritare nga shtetet anëtare të BE-së janë aktive në Kosovë.
- Kosova mbanë misione diplomatike në 13 shtete anëtare të BE-së.

Siç është cekur më herët, Kosova gëzon qasje jo-reciproke pa doganë në tregun e BE-së siç është përcaktuar në regjimin e PAT të BE-së që nga viti 2000.

Eksportet kosovare për në BE janë rritur më shumë se 5 herë, nga rreth 20 milion euro në vitin 2005 në 115 milion euro në vitin 2013. Në të njëjtën kohë, importet janë rritur më shumë se dyfish nga rreth 400 milion euro në më shumë se 1 miliard euro. Marrë në konsideratë bazën e vogël të eksportit, deficitit tregtar gjatë kësaj periudhe është rritur dhe tani qëndron në vlerën rreth 900 milion euro (shih Figurën 4). Ky deficit tronditës tregtar është pasqyrim i mungesës së konkurrencës së prodhimeve vendore të cilat e kanë të vështirë të konkurrojnë në tregun e BE-së me gjithë kushtet e favorshme për tregti që BE-ja i ka akorduar Kosovës përmes regjimit të PAT.

Figura 4. Shkëmbimet tregtare me BE-në 2005-2013 (në '000 Euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Kosova ka përfunduar negociatat me BE-në për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), e cila paraqet një arritje të rëndësishme në procesin e integritimit Evropian të Kosovës. Përmes implementimit të marrëveshjes, BE-ja dhe Kosova gradualisht do të caktojnë zona bilaterale të tregtisë së lirë ku lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit është e garantuar nga të dyja palët. Kosova do të harmonizojë legjislacionin e saj me rregullat e BE-së sa i përket konkurrencës, prokurimit publik, të drejtave të pronës intelektuale dhe industriale dhe mbrojtjen e konsumatorit e kushtet e punës.

4.1.3. Pasqyrë e tregut

4.1.3.1. Përpunimi i ushqimit

BE-ja prinë dukshëm si akter kyç në import dhe eksport të ushqimit dhe pijeve. Në vitin 2011, BE-ja eksportoiti në vlerë prej rreth 76 miliard euro dhe importoi në vlerë prej rreth 63 miliard euro prodhime ushqimore dhe pije, e cila ka rezultuar në bilancin pozitiv tregtar prej 13 miliard euro. Në vitin 2012, eksportet nga BE-ja u rritën me 13% krahasuar me vitin 2011, derisa importet mbetën pothuajse të pandryshuara. “Pemët dhe perimet” dhe “peshqit dhe krustacet” janë dy grupet më të mëdha të prodhimeve të importeve ushqimore. Pemët dhe perimet paraqesin më shumë se çerekun e importeve. Mbi gjysma e këtyre importeve përbëhen nga fruta dhe arra të freskëta apo të thara, ndërsa perimet e freskëta dhe të ngrira përbëjnë rreth një të gjashtëtën e tyre. Turqia është vendi kryesor i origjinës për frutat dhe arrat, e pasuar nga SHBA-ja dhe Afrika Jugore që kryesisht eksportojnë fruta të freskëta dhe arra për në BE, ndërsa kategoria më e madhe e Brazilit është lëngu i frutave dhe perimeve. Grupi tjetër i prodhimeve më i importuar është ai i peshqve dhe krustaceve. Gjysma e kësaj vlere përbëhet nga peshk i freskët dhe i ngrirë, ndërsa krustacet përbëjnë një çerek. Norma më e madhe e rritjes në importe në dhjetëvjeçarin e kaluar është regjistruar tek drithërat dhe përgatitjet nga drithërat. Në fushën e ushqimit dhe pijeve, Holanda, MB dhe Gjermania janë tre importuesit më të mëdhenj në BE, ndërsa eksportuesit më të mëdhenj për në BE janë Brazili, Argjentina dhe SHBA-ja.

4.1.3.2. Bujqësia

BE-ja është prodhuesi i dytë më i madh i agro-ushqimit në botë dhe prodhon një llojllojshmëri të gjerë të prodhimeve, ku përfshihen kryesisht gruri, drithërat kokërr mëdha, patatet, sheqeri, vera, mishi i gjedheve, mishi i derri, mishi i shpezëve, frutat dhe prodhimet e bulmetit. Në vendet udhëheqëse në prodhimtari të ushqimit përfshihen Franca, Italia, Spanja, Gjermania, Holanda dhe MB-ja. BE-ja përdorë Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) për të rritur prodhimtarinë, për të siguruar standard të arsyeshëm të jetesës në komunitetet bujqësore, për të stabilizuar tregjet, siguruar furnizimet dhe për të ofruar çmime të arsyeshme për konsumatorët në vendet e BE-së.

Me mesatare të kombinuar të importeve dhe eksporteve vjetore prej rreth 170 miliard euro, BE-ja është kryesues në tregtimin e prodhimeve bujqësore në botë, dhe në të vërtetë eksportuesi më i madh në botë i të gjitha mallrave dhe shërbimeve dhe tregu më i madh për më shumë se njëqind shtete. BE-ja është importuesi më i madh i prodhimeve bujqësore në botë. Në vitin 2011, vlera e importeve të prodhimeve bujqësore nga BE-ja u rrit me përafërsisht 98 miliard euro. Tregtia me prodhime bujqësore e BE-së është pothuajse në bilanc: deficitin prej 1% në tërë tregtinë është regjistruar për tri vite në periudhën ndërmjet vitit 2008 dhe 2010. BE-ja është importuesi kryesor në botë, me një gamë të gjerë të importeve: 54% të importeve janë produkte finale, 27% janë produkte të ndërmjetme dhe 19% janë artikuj të prodhimit të gjërë. Për nga origjina, Brazili prinë dukshëm si furnizuesi më i madh i BE-së për mallra bujqësore (14% nga totali), e pasuar nga SHBA-të (9%), Argjentina (7%) dhe më pas Kina (4.6%), Zvicra (4.4%) dhe Turqia (4%). *BE-ja është gjithashtu importuesi më i madh i prodhimeve bujqësore nga*

shtetet në zhvillim. Duke pasur parasysh shkallën e taksës doganore dhe qasjen pa kuota që BE-ja i ka ofruar Kosovës, tregu i BE-së paraqet mundësi të mira për eksportuesit kosovar të prodhimeve bujqësore.

4.1.3.3. Përpunimi i drurit

Prodhimtaria evropiane e mobilie paraqet mundësi të mëdha për Kosovën. Në Evropë, Gjermania është shteti me prodhimtarinë më të madhe të mobilie, që paraqet mbi 27% të tregut të gjithëmbarshtëm të BE-së, e pasuar nga Italia (22%), Franca (14%) dhe MB-ja (10%). Nga shtetet e reja të BE-së në Evropën Lindore, Polonia është prodhuesi më i madh i mobileve e pasuar nga Republika Çeke dhe Romania. Presioni i koston në prodhimtarinë e mobileve në Evropën Perëndimore është i lartë, ndërsa çmimi i drurit është faktor kritik. *Kompanitë nga BE-ja shikojnë drejt Evropës Lindore për lëndën e parë drusore me çmim më të ulët. Prodhuesit gjerman kanë tendencë të zhvendosjes në Poloni, ndërsa shumë prodhues italian kanë zgjedhur Slloveninë.* Strategjia e dytë për të zvogëluar koston është nënkontraktimi i prodhimit të komponentëve gjysmë të përfunduar apo të përfunduar të mobileve. Në këtë rast kostoja e transportit luan rol kyç, marrë në konsideratë afërsinë gjeografike të Kosovës me tregjet e BE-së. Në të dy rastet mundësitë e Kosovës për eksport në BE janë të mira. Një fushë e posaçme në të cilën bizneset kosovare do të mund të krijojnë tregje të vogla të dedikuara për prodhime të caktuara, është ajo e nënkontraktimit të pjesëve përbërëse të mobileve apo prodhimet gjysmë të përfunduara.

Pjesët përbërëse të mobilie do të duhej të zhvilloheshin në bashkëpunim të ngushtë me prodhuesit e mobilie në Evropë. Përveç kësaj, Evropa ka potencialin të bëhet treg i rëndësishëm për eksportet kosovare nga druri si shkallët, dyshemetë, dyert dhe kornizat.

4.1.3.4. Materialet ndërtimore

Sektori i ndërtimtarisë gjeneron 10% të BPV-së së BE-së dhe ofron 20 milion vende pune. Franca dhe MB kanë sektorët më të gjerë të ndërtimtarisë në BE, ku Franca paraqet 17% të tregut të BE-së, ndërsa MB 16%.

Industria e ndërtimit në BE është në vitin e trembëdhjetë të rritjes së vazhdueshme dhe të pandërprerë. Sipas ekspertëve më të njohur të tregut, kërkesa e vazhdueshme e lartë në sektorin e ndërtimit për banim si dhe në sektorin e inxhinierisë civile, do të çojë në norma të rritjes prej 3% në të rezultatin total të ndërtimtarisë në vendet e BE-së. Politikat e BE-së për ndërtim kanë për synim një qasje të integruar, që mbulon qëndrueshmërinë, në aspektin e efikasitetit në energji e burime dhe çështjeve që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë. Ekziston një treg i madh që duhet mbuluar, duke përfshirë ndërtesat e sapo ndërtuara dhe renovimin e ndërtesave ekzistuese.

Duke pasur parasysh sektorin dinamik dhe në rritje të ndërtimtarisë dhe afërsinë gjeografike, BE-ja paraqet mundësi të mira për kompanitë kosovare që të rrisin fushëveprimin e aktiviteteve të tyre duke u futur në tregun e ndërtimeve, në segmentin e materialeve ndërtimore, të BE-së.

4.1.4. Procedurat e Përgjithshme të Importit të BE-së

BE-ja ka rregullore dhe procedura shumë komplekse për importin, gjë që reflekton në shumëllojshmërinë e politikave të të gjitha shteteve anëtare. Burimi më i mirë i informatave lidhur me regjimin dhe rregulloret e importit të BE-së është linja ndihmëse për eksport që mund të gjendet këtu: <http://exporthelp.europa.eu/thdapp/index.htm>. Ky burim përmban informata të detajuara dhe gjithëpërfshirëse lidhur me një gamë të gjerë të aspekteve që kanë të bëjnë me procesin e eksportit në tregun e BE-së. Pjesa në vazhdim përmban informata të përzgjedhura që konsiderohen si më thelbësoret për eksportuesit.

Kodi Doganor i BE-së

Kodi Doganor i BE-së përmbledhë të gjitha rregullat që mbulojnë çështjet doganore në tregtinë me vendet që nuk janë anëtare të BE-së. Këto rregulla sigurojnë që praktikat doganore në të gjitha shtetet e BE-së të jenë uniforme dhe transparente.

Regjistrimi si operator ekonomik (numri RIOE)

Numri i Regjistrimit dhe Identifikimit të Operatorit Ekonomik (RIOE) është identifikues unik, i caktuar nga autoriteti Doganor në shtetet e BE-së për të gjithë operatorët ekonomik (edhe kompanitë edhe individët) që angazhohen në aktivitete që mbulohen nga legjislacioni i BE-së për doganat. Eksportuesit e themeluar jashtë BE-së do t'u jepet RIOE herën e parë që paraqesin tek autoritetet:

- Deklaratë doganore
- Deklaratë përmbledhëse në hyrje (ENS)
- Deklaratë përmbledhëse në dalje (EXS)

Operatorët përdorin këtë numër në të gjitha komunikimet me cilindo autoritet doganor të BE-së ku kërkohet një identifikues me bazë në BE, për shembull në deklaratat doganore (<http://exporthelp.europa.eu>).

Deklarata përmbledhëse në hyrje (ENS)

ENS-ja përmban kargo informata paraprake lidhur me ngarkesën që po hyn në BE. Ajo duhet të paraqitet tek zyra e parë doganore në hyrje në BE nga bartësi i mallrave (nga bartësi i mallrave, edhe pse në disa raste mund të bëhet nga importuesi-marrësi i ngarkesës, apo përfaqësuesi i bartësit apo importuesit) – edhe nëse mallrat nuk importohen nga BE-ja. Afati i fundit për paraqitjen e ENS-së varet nga lloji i transportit me të cilin barten mallrat:

- Ngarkesë në kontejner përmes detit: së paku 24 orë para se të fillojë ngarkimi në portin e huaj
- Ngarkesë e madhe në anije përmes detit: së paku 4 orë para arritjes
- Transport i shkurtër në det: së paku 2 orë para arritjes
- Fluturim i shkurtër me ngarkesë (më pak se 4 orë): së paku në kohën e nisjes së aeroplanit
- Fluturim i gjatë me ngarkesë (4 orë e më shumë): së paku 4 orë para arritjes në aeroportin e parë në territorin doganor të BE-së
- Trafiku rrugor: së paku një orë para arritjes.

ENS-ja kërkon informata që gjenden në dokumentet që vijnë nga eksportuesi (deklaratën doganore të mallrave, faturat komerciale, etj.). Eksportuesit duhet të sigurohen që këto dokumente të arrijnë tek pala përgjegjëse për paraqitjen e deklaratës në kohë.

Dokumentet për zhdoganim

Dokumentet e nevojshme për zhdoganim janë:

- Fatura komerciale
- Deklarata për vlerën doganore
- Dokumentet e ngarkesës së mallrave
- Sigurimi i ngarkesës së mallrave
- Lista e paketimit.

Trajtimet e aprovuara doganore

Kur mallrat arrijnë në zyrën doganore në hyrje të BE-së, ato vendosen për magazinim të përkohshëm nën mbikëqyrjen e doganës (jo më gjatë se 45 ditë në rastin e mallrave të transportuara përmes detit, apo 20 ditë në rastet tjera) derisa atyre t'u caktohet një nga trajtimet apo përdorimet e aprovuara doganore në vijim:

1. *Lirim për qarkullim të lirë* – Mallrat lirohen për konsum në momentin kur të gjitha kërkesat për import janë përmbushur:
 - Janë paguar të gjitha taksat doganore, TVSH-ja dhe akciza
 - Janë paraqitur të gjitha autorizimet dhe certifikatat (p.sh. për kuotat, kërkesat shëndetësore, etj.).
2. *Procedura e transitit* – Kur mallrat zhvendosen ndërmjet zyrave doganore në shtete të ndryshme të BE-së, formalitetet e zhdoganimit mund të transferohen tek zyra doganore e destinuar.
3. *Magazinimi doganor* – Mallrat e importuara mund të deponohen në objekte të destinuara posaçërisht për këtë çështje, ndërsa taksat doganore, taksat dhe formalitetet tjera pezullohen derisa mallrave të u caktohet ndonjë trajtim doganor i aprovuar.
4. *Përpunimi i brendshëm* – Mallrat mund të importohen në BE, pa qenë subjekt i taksave doganore, taksave dhe formaliteteve tjera, për t'u përpunuar nën kontroll doganor e më pas për t'u ri-eksportuar jashtë BE-së. Nëse produktet përfundimtare nuk eksportohen në fund, ato më pas i nënshtrohen taksave doganore dhe formaliteteve tjera.
5. *Importimi i përkohshëm* – Mallrat mund të futen në BE pa pagesë të taksave doganore, me kusht që janë të destinuara për ri-eksportim pa qenë subjekt i ndonjë ndryshimi. Periudha maksimale për importim të përkohshëm është 2 vite.
6. *Hyrja në zonë të lirë apo magazinë* – Zonat e lira janë zona të veçanta brenda territorit doganor të BE-së ku mallrat mund të futen pa pagesë të taksave doganore, TVSH-së dhe akcizës, dhe pa formalitete tjera të importit deri sa të u caktohet ndonjë trajtim tjetër i aprovuar doganor apo të ri-eksportohen. Sipas kësaj procedure, mallrat mund të jenë edhe subjekt i operimeve të thjeshta si përpunimi dhe ripaketimi.

Deklarimi doganor – Dokument i vetëm administrativ (DVA)

Mallrat vendosen nën trajtim të aprovuar doganor apo përdorin Dokumentin e vetëm administrativ (DVA). DVA-ja mund të prezantohet tek autoritetet doganore nga eksportuesi apo përfaqësuesi i eksportuesit, ose në mënyrë elektronike (secili shtet i BE-së ka sistemin e vet) apo përmes dorëzimit të drejtpërdrejt në lokalet e zyrës doganore.

DVA-ja mbulon vënien e çfarëdo mallrash në procedurën doganore (eksport, import, transit ku nuk përdoret ende sistemi i kompjuterizuar për transit (NCTS), depo, import të përkohshëm, përpunim të brendshëm apo të jashtëm, etj.) çfarëdo qoftë mjeti i përdorur i transportit. DVA-ja ka për qëllim të sigurojë që kërkesat nacionale administrative të jenë të hapura, të racionalizojë dhe të zvogëlojë dokumentet administrative, të zvogëlojë sasinë e informatave të kërkuara dhe të standardizojë e të harmonizojë të dhënat.

Vlera për qëllimet doganore

Shumica e taksave doganore dhe TVSH-së shprehen si përqindje e vlerës së mallrave që importohen. Autoritetet doganore përcaktojnë vlerën e mallit për qëllime doganore bazuar në vlerën komerciale në momentin e hyrjes në BE: çmimi i blerjes plus kostoja për dërgesë deri në momentin kur mallrat futen në territorin doganor. Kjo vlerë nuk duhet të jetë gjithmonë çmimi i cekur në kontratë të shitjes dhe mund të jetë subjekt i përshtatjeve specifike.

4.1.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës

Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH është taksë e harmonizuar brenda BE-së dhe përmban strukturë të përbashkët, bazë uniforme të vlerësimit dhe normat minimale të përcaktuara nga shtetet e BE-së. Kjo taksë vihet në importin e mallrave dhe zakonisht ngarkohet për pagesë gjatë procedurave të zhdoganimit në mënyrë që të lejohet për qarkullim. Sidoqoftë, kur mallrat eksportohen në një shtet të BE-së, por janë të destinuara për konsum në një shtet tjetër të BE-së, ato mund të vendosen në aranzhimin e TVSH-së së pezulluar, përmes së cilit TVSH-ja ngarkohet në shtetin e BE-së për të cilin janë destinuar mallrat dhe jo në shtetin e hyrjes. Pagesat e TVSH-së për import trajtohen në mënyrën e njëjtë si taksat doganore. Personat e tatimueshëm duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë tek doganat Dokumentin e Vetëm Administrativ, i cili duhet të përfshijë vlerën e mallrave, vendin e origjinës, marrësin e ngarkesës, destinacionin, çmimin, peshën, etj.

Aranzhimet pezulluese dhe Zonat e Lira

Mallrat e importuara mund të caktohen nën një nga aranzhimet doganore të cekura më poshtë. TVSH-ja nuk do të ngarkohet derisa mallrat nuk largohen për përdorim shtëpiak.

- Mallrat e vendosura në depo të përkohshme;
- Mallrat nën *lirim për përpunim të brendshëm* (sistemi i pezullimit të taksës doganore);
- Mallrat e vendosura në magazinim doganor apo zona të lira;
- Importim të përkohshëm;
- Procedurat e transitit;
- Zonat e Lira në të cilat mallrat janë pa TVSH, pa taksa dhe ngarkesa doganore.

Shuma e taksueshme

Shuma e taksueshme është shuma totale që paguhet apo arkëtohet për furnizime. Shuma e taksueshme është çmimi që faturohet, duke përfshirë taksat, taksat doganore, taksat dhe ngarkesat e vëna, duke përjashtuar TVSH-në dhe pagesat e rastit si komisioni, paketimi, transporti dhe kostot për sigurim të ngarkuara nga furnizuesi për blerësin apo konsumatorin. Transaksionet e taksueshme janë subjekt i normave dhe rregulloreve të aprovuara nga shteti i BE-së për të cilin ofrohen mallrat apo shërbimet. Secili shtet i BE-së mund të rregullojë normat e veta, por ato nuk mund të jenë më pak se 15%. Shtetet gjithashtu aplikojnë norma të reduktuara, por jo më pak se 12% ("norma e parkimit") për disa mallra dhe shërbime.

Akciza

Shtetet e BE-së aplikojnë akcizë për vajrat minerale, duhanin, alkoolin dhe pijet alkoolike. Normat e caktuara nga BE-ja janë norma minimale. Shtetet anëtare të BE-së mund të caktojnë norma taksash që nuk mund të jenë më të vogla se niveli minimal i tatimit i përcaktuar me Direktiva të BE-së. Produktet e taksueshëm janë **subjekt i akcizës në momentin e prodhimit** (kudo në BE) apo **në momentin e importimit** (nga vendet jashtë BE-së). Sidoqoftë, **akciza paguhet vetëm në momentin e lirit për konsum**. Nëse produkti importohet nga shteti i BE-së, por transportohet dhe jepet për furnizim në një shtet tjetër të BE-së, akciza duhet të paguhet në shtetin e BE-së ku produktet eventualisht do të konsumohen apo do të përdoren. Akciza e paguar për pijet alkoolike mund të kthehet prapa, në kushte të caktuara dhe në raste specifike, si në rastin kur mallrat përfundimisht eksportohen jashtë vendeve të BE-së.

Tarifat dhe kuotat

Sipas PAT, Kosova mund të eksportojë në BE deri në dy milion litra verë në vit, pa taksë doganore dhe në baza të principit "kush arrin i pari shërbehet i pari". Nëse eksportuesit kosovarë eksportojnë më shumë se dy milion litra verë në BE brenda një viti, atëherë Kosova mund të ketë qasje në kuotën e përbashkët për Ballkanin Perëndimor, e cila është tre milion litra. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë kuota individuale për eksportin e verës. Sipas kësaj marrëveshje edhe mishi i gjedheve të reja është subjekt i kuotave tarifore.

Rregullat e origjinës për Kosovën

Ekzistojnë dy lloje të ndryshme të Rregullave të Origjinës: preferenciale dhe jo-preferenciale. Rregullat e Origjinës përdoren për të përcaktuar nëse produkti i eksportuar nga Kosova mund të konsiderohet si i lidhur mjaftueshëm me Kosovën dhe në këtë mënyrë të ketë origjinë në këtë vend për qëllime të marrjes nga BE-ja preferencën tarifore të caktuar për Kosovën.

Përveç rregullës specifike për origjinën të atribuar për produktin, prodhuesi duhet të verifikojë që operimet që janë kryer në Kosovë i tejkalojnë operimet minimale të listuara në një grup të caktuar të rregullave të origjinës lidhur me Kosovën (d.m.th. paketimi, prerja e thjeshtë, montimi i thjeshtë, përzjerja e thjeshtë, etj.). Nëse pjesa e prodhimit e kryer në Kosovë është një nga ato të listuarat dhe asgjë tjetër nuk është prodhuar atje (d.m.th. asnjë material nuk është prodhuar apo transformuar), atëherë produkti nuk mund të konsiderohet se ka origjinë nga Kosova edhe pse rregulla e origjinës e atribuar për produktin është përmbushur.

PAT-i përcakton rregullat në vijim për eksportet e Kosovës për BE:

- *Toleranca* është fikse në vlerën 10% të çmimit të shitjes në vend të produktit për të gjitha produktet, përveç për tekstil dhe rroba, për të cilat aplikohet tolerancë specifike.
- *Grumbullimi* – Aplikohet grumbullimi bilateral, që do të thotë se materiale me origjinë nga BE-ja mund të përdoren si materiale me origjinë nga Kosova.
- *Transporti direkt* – Dëshmia e transportit direkt duhet të sillet tek autoritetet doganore të shtetit importues.
- *Rikthimi i pagesës së doganës* – Rikthimi i pagesës së doganës është i autorizuar.

Dëshmia e origjinës për Kosovë

Sipas rregullave të origjinës që aplikohen në Kosovë, për të përfituar nga normat preferenciale doganore, prodhimet me origjinë nga Kosova duhet të shoqërohen me njëren nga të mëposhtmet:

- Certifikatën e qarkullimit EUR1 të lëshuar nga Doganat e Kosovës
- Deklaratë faturën nga eksportuesi.

Për ngarkesat me produkte me origjinë nga Kosova me vlerë 6,000 euro ose më pak, secili eksportues mund të mbushë deklaratën. Dëshmia e origjinës mbetet valide për 4 muaj.

4.1.6 . Kërkesat teknike dhe mjedisore

4.1.6.1. Kërkesat teknike

Mallrat e eksportuara në BE duhet të përmbushin kushtet teknike për mbrojtjen e konsumatorëve. Kërkesat kryesore kanë të bëjnë me sigurinë, standardizimin teknik, paketimin dhe etiketimin.

Siguria e prodhimeve

Prodhuesit dhe distributorët duhet që:

- Të furnizojnë prodhime që janë në pajtim me kërkesat e përgjithshme të sigurisë;
- Të informojnë konsumatorët lidhur me rreziqet që mund t'u kanosen nga produkti dhe masat paraprake që ata duhet të ndërmarrin;
- Të lajmërojnë autoritetet përkatëse kombëtare nëse zbulojnë se produkti është i rrezikshëm dhe të bashkëpunojnë me ata në veprimet e ndërmarra për mbrojtjen e konsumatorëve.

Standardizimi teknik

BE-ja inkurajon shtetet anëtare që të miratojnë standardet e harmonizuara teknike, të cilat janë përcaktuar nga këto tri organe:

- Komiteti Evropian për Standardizim (CEN)
- Komiteti Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC)
- Instituti Evropian për Standarde të Telekomunikimit (ETSI).

Procedurat për vlerësimin e përshtatshmërisë së produkteve me kërkesat thelbësore (*vlerësimi i përshtatshmërisë*) kryhen nga prodhuesit apo palët e treta. Organet e lajmëruara në secilin shtet të BE-së janë përgjegjëse për vlerësimin e përshtatshmërisë kur kërkohet pala e tretë.

Shënjimi "CE" tregon që produkti përshtatet me të gjitha kërkesat thelbësore të aplikueshme dhe ka kaluar procedurën përkatëse të vlerësimit të përshtatshmërisë. Autoritetet kombëtare në shtetet e BE-së janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për t'u siguruar që produktet përmbushin kërkesat për të u bërë pjesë e tregut të BE-së. Mbikëqyrja mund të përmbajë kontrollim dokumentesh dhe/apo inspektime fizike. Prodhuesit kosovarë të cilët duan të shesin produktet e tyre në BE mund të emërojnë një përfaqësues të autorizuar të caktuar në BE për të vepruar në emër të tyre. Ata janë përgjegjës për dizajnimin dhe prodhimin e produkteve që përshtaten me të gjitha kërkesat e aplikueshme dhe për kryerjen e procedurës së kërkuar të vlerësimit të përshtatshmërisë.

Ambalazhimi

Ambalazhimi që tregtohet në BE duhet të përmbushë kërkesat ambientale dhe ato shëndetësore. Në veçanti, ambalazhet nga druri (këllëfët, pakot, arkat, etj.) duhet të kalojnë një prej trajtimeve të aprovuara dhe të bartin markën përkatëse.

Etiketimi

Eksportet duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së për etiketimin, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, sigurinë e tyre dhe interesat dhe të ofrojë informata lidhur me produktin

– përmbajtjen, përbërjen, përdorimin e sigurt dhe masat paraprake të veçanta, etj. Ecolabel-a (Etiketa eko) dhe “Logoja me lule” e BE-së mund t’i jepet produkteve që ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit dhe që u ofrojnë konsumatorëve udhëzime lidhur me ndikimin mjedisor. Eksportuesit mund të aplikojnë për Ecolabel-ë tek autoritetet përkatëse në shtetin e BE-së ku produkti do të plasohet në treg.

4.1.6.2. Kërkesat mjedisore

Mallrat që eksportohen në BE duhet të përmbushin standardet mjedisore të BE-së për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mjedisit. Kërkesat kryesore aplikohen për materiet kimike, substancat që varfërojnë ozonin, gazrat serë të fluoruara, speciet e rrezikuara dhe mbeturinat.

Materiet kimike

Eksportet e disa materieve kimike të rrezikshme janë subjekt i kontrollit për materie të rrezikshme kimike dhe pesticide në BE. Gjithashtu, politikat e BE-së kanë për qëllim eliminimin apo minimizimin e përdorimit të ndotësve të përhershëm organik (POP). Sistemi për regjistrim, vlerësim, autorizim dhe ndalim të materieve kimike (REACH) cakton kërkesat që duhen përmbushur për eksport të materieve kimike dhe produkteve që përmbajnë materie kimike. REACH përcakton ndalesat për përdorimin e substancave të rrezikshme apo substancave që mund të lirohen nga këto artikuj (p.sh. pajisjet për zyrë dhe shkollë, tekstili dhe komponentet elektronike). Disa grupe produktesh, si përbërësit e ushqimit apo produktet farmaceutike, janë të liruara nga REACH. Para se të mund të plasohen në tregun e BE-së, materiet kimike duhen klasifikuar, etiketuar dhe ambalazhuar.

Produktet për mbrojtje të bimëve dhe biocidet

Në BE, produktet për mbrojtjen e bimëve duhet të autorizohen para se të mund të plasohen në treg, dhe e njëjta gjë vlen për shumicën e komponentëve përbërës. Biocidet (d.m.th. dezinfektuesit, konservuesit, pesticidet jo-bujqësore, prodhimet kundër ndotësve detar, etj.) duhet të përmbushin kërkesa specifike. Nëse dëshironi të eksportoni ngjyra për ruajtjen e drurit apo produkte kundër rritjes së ndotësve për në BE, duhet të siguroheni që produktet tuaja të lejohen në treg sipas legjislacionit të BE-së për biocidet. Kërkesat kryesore përfshijnë një listë të substancave të lejuara dhe autorizimin e produktit. Ju lutem të keni parasysh që në praktikë, kërkesat për plasimin në treg të produkteve biocide nuk janë ende të harmonizuara plotësisht në të gjitha vendet e BE-së.

Speciet e rrezikuara

Tregtimi i ekzemplarëve të disa kafshëve, bimëve (të rrezikuara) të listuara apo produkteve që përmbajnë material nga këto specie (p.sh. artikuj nga lëkura, punime artizanale, bizhuteri, lule, bimë, mobilie dhe antikitet) është i ndaluar apo i kufizuar. Për ekzemplarë të specieve tjera, importi lejohet në disa rrethana të caktuara, por vetëm nëse transporti shoqërohet me dokumentacionin zyrtar: lejet për (ri-) eksport, lejet për import apo lajmërimet për import. Ekzemplarët e specieve të rrezikuara (dhe pjesët apo produktet me prejardhje nga ato) që hyjnë në BE duhet të shoqërohen me lejet dhe certifikatat përkatëse.

Mbeturinat

Politikat e BE-së kërkojnë që të gjitha mbeturinat që futen në BE duhet të autorizohen paraprakisht dhe të njoftohen autoritetet. I gjithë ambalazhimi i plasuar në tregun e BE-së duhet të përmbushë kërkesat bazike sa i përket përmbajtjes dhe mundësisë së kthimit në gjendjen e mëparshme. Këto kërkesa kanë për synim parandalimin e prodhimit të mbeturinave të ambalazhimit, të promovojnë ripërdorimin e

ambalazhit (riciklimin apo forma tjera të kthimit në përdorim të mbeturinave nga ambalazhi), dhe në këtë mënyrë të zvogëlojë hedhjen përfundimtare të mbeturinave të tilla. Në veçanti, ambalazhi duhet të jetë me vlerë dhe peshë minimale, duhet të përmbajë sasi minimale të substancave të rrezikshme (posaçërisht metaleve të rënda), të jetë i përshtatshëm për ripërdorim, kthim në gjendje të mëparshme dhe riciklim dhe të etiketohet për të treguar përbërjen e saj (për të lehtësuar grumbullimin, ripërdorimin dhe kthimin në gjendjen e mëparshme).

4.1.7. Kërkesat e sektorit

4.1.7.1. Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Kërkesat e përgjithshme

Legjislacioni i BE-së për ushqimin përcakton parimet në vijim:

- Nuk është i lejuar tregtimi i produktit nëse ai është i rrezikshëm, d.m.th. nëse paraqet rrezik për shëndetin apo nëse nuk është i përshtatshëm për konsum nga njerëzit dhe kafshët.
- Në të gjitha fazat e zinxhirit agro-ushqimor, operatorët biznesorë duhet të sigurohen që të gjitha produktet ushqimore për njerëz dhe kafshë të përshtaten me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.
- Për të gjitha produktet ushqimore për njerëz, për kafshë apo kafshët që janë të destinuara për konsum nga njerëzit dhe çdo substancë që i shtohet ushqimit, duhet të mundësohet gjurmueshmëria për të gjitha fazat e prodhimit, transformimit dhe shpërndarjes.
- Nëse operatori dyshon që ushqimi për njerëz apo kafshë i importuar, prodhuar, transformuar apo shpërndarë paraqet rrezik për shëndetin e njeriut apo të kafshëve, ai/ajo duhet ta tërheqë atë menjëherë nga tregu dhe të njoftojë autoritetet kompetente dhe përdoruesit.

Niveli maksimal i mbetjeve (NMM) për pesticide

Me mijëra kombinime të nivelit maksimal të mbetjeve (NMM) për pesticide/artikuj janë përcaktuar në nivel të Komunitetit. Aty ku nuk janë përcaktuar NMM të Komuniteti, secili Shtet Anëtar ka të drejtë që të përcaktojë kufizimet maksimale nëse konsiderojnë që këto produkte paraqesin rrezik.

Rregullat e tregtimit

Standardet e tregtimit janë norma që shërbejnë si instrument ligjor dhe që përcaktojnë kriteret e përbashkëta për klasifikimin e frutave dhe perimeve me klasa të ndryshme komerciale në BE.

Shtesat e ushqimit

Shtesat e ushqimit definojnë si “çdo substancë që normalisht si e vetme nuk përdoret si ushqim dhe normalisht nuk përdoret si përbërës karakteristik i ushqimit pavarësisht se a ka apo jo vlera ushqyese”. Shtesat e ushqimit i shtohen qëllimisht ushqimit për arsye teknologjike gjatë prodhimit, përpunimit, përgatitjes, trajtimit, ambalazhimit, transportit apo deponimit. Direktiva 89/107/CE përcakton të gjitha shtesat që mund të përdoren në prodhimin e ushqimit dhe përcakton kategoritë e shtesave që mund të përdoren në prodhimin apo përgatitjen e produkteve ushqimore. Ajo gjithashtu përcakton kërkesat për etiketim të shtesave të ushqimit.

Kontaminuesit

Kontaminuesit janë substanca që nuk i janë shtuar qëllimisht ushqimit dhe janë prezente si rezultat i ndonjëres prej shumë fazave të prodhimit, përpunimit, përgatitjes, trajtimit, ambalazhimit, transportit, magazinimit apo kontaminimit mjedisor. BE-ja ka masa për minimizimin e kontaminuesve në ushqim përmes ndalesës së shitjes së produkteve që përmbajnë kontaminues në sasi të papranueshme dhe posaçërisht në nivelin toksikologjik. Kërkohej që kontaminuesit të mbahen në nivelin më të ulët të arsyeshëm duke përdorur praktikën e duhura gjatë të gjitha fazave të prodhimit, transformimit, përgatitjes, trajtimit, kondicionimit, ambalazhimit, transportit dhe magazinimit. Gjithashtu është bërë lista e Komunitetit për limite të tolerancës, limitet e detektimit analitik, marrjen e mostrave për referim dhe metodat analitike.

Produktet organike

Rregullorja e Këshillit EEC 2092/1991 përcakton parakushtet për prodhimin organik të produkteve bujqësore dhe indikacionet. Kjo aplikohet tek produktet që bartin apo do të bartin indikacionet që i referohen metodave të prodhimit organik. Sipas kësaj rregulloreje, produkti konsiderohet organik nëse bartë indikacionet që i referohen metodave të prodhimit organik, ku në etiketë, reklamë apo dokumente komerciale, produkti apo përbërësit e tij përshkruhen në terme që i sugjerojnë blerësit se produkti apo përbërësit e tij janë bërë në pajtueshmëri me rregullat e prodhimit.

Ushqimet e reja dhe përbërësit e ri ushqimor

Produktet apo përbërësit që nuk janë përdorur shumë për konsum njerëzor brenda KE-së duhet të jenë të autorizuar para se të mund të plasohen në treg. Për kategoritë e ushqimit dhe përbërësit që konsiderohen të rinj, nga eksportuesit kërkohej që të kërkojnë leje për eksport.

Etiketimi

Direktiva EC/13/2000 përcakton kërkesat për etiketimin të caktuar nga shtetet anëtare të BE-së. Kjo direktivë kërkon etiketimin të përgjithshëm për të gjitha produktet. Përveç kësaj, BE-ja ka caktuar rregullore specifike varësisht nga lloji i produktit apo produkti.

- **Etiketimi i përgjithshëm** – Informatat në etiketë duhet të paraqiten në gjuhët e shtetit anëtar në të cilin produkti do të shitet. Legjislacioni përfshinë mundësinë e përfshirjes së më shumë gjuhëve në mënyrë që të mundësohet tregtimi i produktit në shumë shtete. Sa i përket njësive matëse, përdorimi i sistemit metrik është obligativ.
- **Deklarimi shëndetësor** – Të gjitha deklaratimet që i caktojnë ushqimit karakteristika në lidhje me parandalimin apo trajtimin e sëmundjeve janë të ndaluara me normat aktuale të BE-së për etiketimin. Për shkak të këtij detyrimi, disa prej shteteve anëtare kanë implementuar legjislacion vetanak.
- **Etiketimi për vetitë ushqyese në prodhimet ushqimore** – Direktiva e Këshillit 90/496/EEC për etiketimin e vlerave ushqyese për prodhimet ushqimore, e amendamentuar me Direktivën e Komisionit 2003/120/EC, përcakton "etiketimin për vlerat ushqyese" si çdo informatë që paraqitet në etiketë dhe që ka të bëjë me vlerën për energjinë dhe lëndët ushqyese në vijim: proteinat, karbohidratet, yndyrën, fibrat, natriumin, vitaminat dhe mineralet e listuara në Shtojcën e Direktivës së Këshillit 90/496/EEC.
- **Kërkesat tjera për etiketimin** – Përveç normave për etiketimin të përgjithshëm, deklaratimet shëndetësore dhe përmbajtjen e lëndëve ushqyese, BE-ja ka përcaktuar një seri të kërkesave shtesë që aplikohen për lloje specifike të produkteve.

4.1.7.2. Kërkesat për eksport për përpunim të ushqimit dhe bujqësi

EKSPORTUESIT E PRODUKTEVE TË FRESKËTA	EKSPORTUESIT E PRODUKTEVE TË PËRPUNUARA
Eksportuesit e produkteve të freskëta bujqësore duhet t'u përmbahen normave në vijim:	Eksportuesit e produkteve të përpunuara duhet t'u përmbahen normave në vijim:
Garantojnë që produktet janë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat për siguri të ushqimit.	Garantojnë nivelin e sigurisë së ushqimit duke implementuar procedurat e standardit HACCP
Aplikojnë sisteme dhe procedura që mundësojnë gjurmueshmërinë.	Aplikojnë sisteme dhe procedura që mundësojnë gjurmueshmërinë e përbërësve dhe produkteve ushqimore.
Sigurojnë që produktet i përmbushin të gjitha kërkesat fitosanitare të BE-së.	U përmbahen të gjitha kërkesave për etiketim.
Sigurohen që produktet janë në përputhshmëri me nivelin maksimal të lejuar të mbetjeve të pesticideve në ushqim.	U përmbahen direktivave të përgjithshme në lidhje me materialin dhe objektet që mund të vijnë në kontakt me ushqimin.
U përmbahen normave të tregtimit.	U përmbahen normativave për shtesat e ushqimit.
Sigurohen që i gjithë ambalazhi prej druri është në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare për Masat Fitosanitare Nr. 15.	U përmbahen normativave për kontaminuesit e ushqimit.
Identifikon taksat që duhet paguar për produktin gjatë importimit.	Sigurohen që i gjithë ambalazhi prej druri është në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare për Masat Fitosanitare Nr. 15.
Identifikon ekzistencën e kuotave të importit për në BE që mund të ndikojnë në importin e produktit të tyre.	U përmbahen kërkesave për produkte organike nëse produktet do të shiten nën këtë emërtim.
Regjistrojnë markën e tyre të tregtimit, në rast kur është në interes që të shitet produkti me emrin/brendin e tyre.	Identifikon taksat që duhet paguar për produktin gjatë importimit.
U përmbahen kërkesave për produkte organike nëse produktet do të shiten nën këtë emërtim.	Identifikon ekzistencën e kuotave të importit për në BE që mund të ndikojnë në importin e produktit të tyre.
	Regjistrojnë markën e tyre të tregtimit, në rast kur është në interes që të shitet produkti me brendin e tyre.

4.1.8. Përpunimi i drurit

Shtetet anëtare të BE-së kanë masa për materialin e ambalazhit nga druri i plotë të përdorur për importimin e të gjitha llojeve të objekteve nga të gjitha shtetet. Dispozitat përkatëse të Direktivës për Shëndetin e Bimëve të BE-së bazohen në udhëzimet e Standardeve Ndërkombëtare të FAO-s për Masat Fitosanitare për rregullimin e trungjeve, drurëve të prerë (në sharrë dhe të copëtuar) dhe materialet për ambalazhim nga druri, në tregtimin ndërkombëtar. Materiali i drurit në ambalazh që është subjekt i këtyre masave përfshinë këllëfët ambalazhues, këllëfët, kutitë, arkat, fuçitë dhe ambalazhimin e ngashëm, paletat, paletat në formë të kutisë, apo dërrasat për ngarkim dhe paletat e lidhura. Materiali i drurit për ambalazhim që nuk hyn faktikisht në përdorim, por i importuar si ngarkesë duhet të përmbushë të njëjtat rregulla që aplikohen për drurin e prerë nga e njëjta gjini apo specie.

Eksportuesit e produkteve që përmbajnë dru, letër apo fibra druri në BE duhet të jenë në dijeni për Rregulloren e re të BE-së për Drurin. Ngjashëm si iniciativat në SHBA e Australi, BE-ja tani aplikon instrumente ligjore për të ndaluar prerjen ilegale të drunjve që është kontribuesi kyç në ndryshimin klimatik dhe që mund të ndikojë seriozisht tek komunitetet lokale. Në fuqi nga marsi i vitit 2013,

rregullorja kërkon që bizneset të kenë sistem që në mënyrë efikase parandalon hyrjen në BE të produkteve nga druri ilegal.

Detajet e Rregullores së BE-së për Drunjtë mbeten për t'u përcaktuar. Sidoqoftë, disa kërkesa kyçe janë të qarta. Bizneset eksportuese duhet:

- Të kenë sistem hetimor që bën vlerësimin dhe minimizon rrezikun e hyrjes në zinxhirin furnizues të drunjve të prerë ilegalisht
- Të kenë qasje në informatat adekuate për furnizuesit dhe produktet e tyre
- Të kryejnë vlerësim të rrezikut për të përcaktuar rrezikun e hyrjes së drunjve të prerë ilegalisht në zinxhirin e tyre furnizues
- Të ndërmarrin masat e duhura për të zvogëluar rrezikun e identifikuar.

Produktet e mbuluara nga Rregullorja e BE-së për Drunjtë janë:

- Drunjtë e prerë në sharrë
- Drunjtë e copëtuar
- Kompensata
- Iverpllaka
- Produktet e prodhuara nga druri
- Ambalazhi
- Kartoni dhe letra.

Ekzistojnë standarde kombëtare për cilësinë e mobilieve, të cilat nuk duhet neglizhuar. Për shembull, standardet e qëndrueshmërisë janë caktuar varësisht nga rezistenca e produkteve – rezistenca sipërfaqësore ndaj nxehtësisë së thatë, lëngjeve të ftohta dhe lëvizjeve kontraktuese.

Materialet nga druri për ambalazhim duhet të trajtohen dhe të shënjohen sipas Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve të Organizatës për Ushqim dhe Bujqësi dhe Standardeve Ndërkombëtare për Masa Fitosanitare (ISPM) 15 “Udhëzimet për rregullimin e ambalazhimit nga druri në tregtinë ndërkombëtare”. Sipas ISPM 15 trajtimi ose mund të jetë me nxehtësi (HT) apo me tymosje me metil bromid (MB). Druri i trajtuar duhet të shënjohet dhe kjo shenjë duhet të përfshijë kodin dyshifror ISO të shtetit, kodin që identifikon prodhuesin e ambalazhit nga druri, si dhe kodin e trajtimit.

Dërgesat nga shtetet në zhvillim në përgjithësi kanë për të kaluar distanca të gjata për të arritur në destinacionin e tyre; prandaj, është shumë e rëndësishme që t'u kushtohet shumë vëmendje ambalazhimit të fortë dhe rezistent ndaj ujit. Artikujt për mobilim mund të dëmtohen lehtë gjatë transportit nga lagështia apo trajtimi jo i duhur, prandaj ato duhet të ambalazhohen me kujdes dhe sigurt.

4.1.9. Materialet ndërtimore

Spektori evropian i ndërtimit është subjekt i kërkesave dhe standardeve të ndryshme rregullatore kombëtare dhe evropiane lidhur me konsumin e energjisë, rrezikun dhe ndikimin mjedisor, shëndetin dhe sigurinë, cilësinë e produkteve, etj. Këto kërkesa dhe standarde janë të kushtueshme për kompanitë në këtë sektor në aspektin e administrimit.

Rregullorja për Produktet Ndërtimore (RRPN) mbulon shtatë kërkesa bazike në lidhje me standardet e produkteve për punë ndërtimore, si në vijim:

- Rezistenca mekanike dhe stabiliteti
- Siguria në rast të zjarrit
- Higjiena, shëndeti dhe mjedisi
- Siguria dhe qasja në përdorim
- Mbrojtja nga zhurma
- Kursimi i energjisë dhe ruajtja e nxehtësisë
- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Produktet që janë në pajtueshmëri me legjislacionin evropian janë të lira për qarkullim në treg. Shenja CE është deklarata që tregon se produkti është në përputhje me të gjitha dispozitat e aplikueshme dhe që janë përfunduar procedurat e duhura për vlerësim të përputhshmërisë.

Metodat e vlerësimit janë specifikuar në standardet e harmonizuara evropiane për produktet. Ato duhet të aplikohen nga prodhuesit kur deklarojnë performancën e produkteve dhe nga autoritetet kombëtare kur specifikojnë kërkesat. Etiketimi dhe klasat e prezantuara në standarde u ndihmojnë përdoruesve të zgjedhin produktet që u përshtaten më së miri për qëllimin e tyre në punët ndërtimore. Për produktet ndërtimore që nuk mbulohen fare apo nuk mbulohen tërësisht nga standardet e harmonizuara, lëshohen vlerësime teknike evropiane. Ato përfshijnë performancën që duhet deklaruar dhe të gjitha detajet teknike të domosdoshme për verifikim të pandryshueshmërisë së performancës.

Produktet që përdoren në sektorin e ndërtimtarisë e që kanë të bëjnë me energjinë, si dritaret, nxehtësit dhe sistemet e ventilimit, ndërlidhen me një pjesë të madhe të konsumit të energjisë në BE. Direktiva për Eko-dizajn ofron një kornizë koherente të kërkesave për të marrë në konsideratë të gjitha ndikimet mjedisore të produktit. Në këtë mënyrë, masat Eko-dizajn përmirësojnë cilësinë e produkteve dhe mbrojtjen e mjedisit dhe lehtësojnë qarkullimin e lirë të mallrave. Ecolabel-a e BE-së ndihmon në identifikimin e produkteve dhe shërbimeve që kanë ndikim të zvogëluar mjedisor gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor, nga nxjerrja e lëndës së parë deri në prodhimin, përdorimin dhe hedhjen. Produktet e cilësisë së lartë që janë “më të gjelbra”, më miqësore për mjedisin, e që janë në dispozicion në mbarë botën janë të listuara në katalogun Ecolabel. Rregullorja për Regjistrim, Vlerësim, Autorizim dhe Kufizim të materieve kimike (REACH) është e rëndësishme për produktet e ndërtimit që përdorin substancat e ripërdorura si metalet, zhavorret e ripërdorura dhe xhamin. Objektivat kryesore të rregullores janë siguri i nivelit të lartë të mbrojtjes së shëndetit njerëzor dhe mjedisit nga rreziqet që mund të kanosen nga materiet kimike, qarkullimi i lirë i substancave në tregun e brendshëm dhe avancimi i konkurrueshmërisë dhe inovacionit.

4.2. Shtetet në CEFTA

4.2.1. Shqipëria

4.2.1.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike

Shqipëria ka marrë statusin e vendit kandidat për BE më 24 qershor 2014. Aplikimi i saj për anëtarësim në BE më 28 prill 2009 ishte një moment i rëndësishëm historik për vendin i cili 20 vjet më parë kishte dalë nga regjimi komunist si një prej vendeve më të varfra, më të izoluar, më represive dhe më të panjohura në Evropë. Përveç kësaj, tranzicioni i Shqipërisë në demokraci dhe ekonomi të tregut kishte filluar në rrethana shumë sfiduese gjatë periudhës së jostabilitetit ekstrem në Ballkanin Perëndimor. Arritja e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim me BE-në në vitin 2006 ka treguar se Shqipëria ka vullnetin të shkojë përpara në procesin e integritit dhe prej atëherë është arritur progres në shumë fronte.

Qytetarëve të Shqipërisë gjithashtu iu dha mundësia për të udhëtuar pa viza në Zonën Shengen në fund të vitit 2010. Sidoqoftë, pengesa të jashtëzakonshme ende gjenden në rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit të plotë në BE. Atje shihen disa probleme të brendshme të mëdha që mund të ngadalësojnë procesin e modernizimit. Korrupsioni ende mbetet sfidë e madhe dhe është duke dëmtuar potencialin ekonomik të këtij vendi. Megjithatë, para krizës financiare globale, Shqipëria ishte një prej ekonomive me rritjen më të shpejtë në Evropë, me një rritje reale mesatare vjetore prej 6%, të shoqëruar me zvogëlim të shpejtë varfërisë. Sidoqoftë, pas vitit 2008, norma e rritjes mesatare vjetore u përgjysmua dhe u shfaqën disbalancat në sektorët publik dhe ata të jashtëm. Ritmi i rritjes gjithashtu u pasqyrua në varfërinë dhe papunësinë: ndërmjet viteve 2002 dhe 2008, varfëria në vend u përgjysmua (në rreth 12.4%), por në vitin 2012 u rrit prapë në 14.3%. Papunësia u rrit nga 12.5% në vitin 2008 në 16.9% në vitin 2013, ku papunësia tek të rinjtë arriti 26.9%.³

Kthimi në normat e rritjes mbi 3% në vitin 2011 u zvogëlua në 2012 dhe 2013, si reflektim i përkeqësimit të situatës në Eurozonë dhe situatës në sektorin e energjisë. Rritja e BPV-së reale u zhyt në pikë të ulët prej -2.3% në çerekun e tretë të vitit 2013. Edhe pse pritet një përmirësim i gjendjes, rritja pritet të mbetet nën potencialin e vendit për një periudhë afatmesme.

4.2.1.2. Marrëdhëniet me Kosovën


Shqipëria është një prej partnerëve më të mëdhenj tregtarë, posaçërisht kur flitet për eksportet. Këmbimet tregtare ndërmjet këtyre dy vendeve janë rritur në mënyrë të vazhdueshme prej kur Kosova i është bashkëngjitur CEFTA-s.

Përveç CEFTA-s, Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar edhe marrëveshje tjera bilaterale për lehtësim të tregtimit në mënyrë që të shfuqizojnë barrierat jo-tregtare dhe të rrisin shkëmbimin tregtar ndërmjet tyre. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, 42% të gjithë eksportit të Kosovës drejt vendeve të CEFTA-s ishin eksportuar për në Shqipëri gjatë tri viteve të fundit, ndërsa 14% e të gjitha importeve nga shtetet anëtare të CEFTA-s gjatë të njëjtës periudhë kanë ardhur nga Shqipëria.⁴

³Banka Botërore <http://www.worldbank.org/en/country/albania>

⁴Agjencia e Statistikave të Kosovës – Statistikat për Tregti të Jashtme 2011 - 2013

Figura 5. Shkëmbimet tregtare me Shqipërinë 2005-2013 (në '000 Euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Gjatë periudhës 2011–2013, eksportet kosovare në Shqipëri arritën vlerën gati 120 milion euro apo 40% të të gjitha eksporteve të saj. Vetëm në 2013 Kosova eksportoi 43.8 milion euro apo përafërsisht 40% të të gjithë vlerës së eksportit për në Shqipëri. Mallrat më të eksportuara në vitin 2013 (SITC 8-shifrore) përfshijnë skrapin me 40% të eksporteve në vitin 2013, mielli nga gruri me 17%, hekuri apo çeliku dhe çeliku pa përzjerje me rreth 8% dhe patatet, uji dhe pijet me total prej 9% të eksporteve të vitit të kaluar.⁵

Ngjashëm, importet nga Shqipëria kanë pak a shumë të njëjtën strukturë. Gati 65% e të gjithë importeve të vitit 2013 ishin skrap metali dhe çimento, në vlerë prej 71.5 milion euro. Pjesa tjetër e importeve më të shumta përfshijnë bitumin nga nafta, tulla për ndërtim, perime të freskëta, etj.

Mesatarisht, 38% e importeve nga Shqipëria u mbuluan nga eksportet gjatë tri viteve të fundit, duke mbajtur kështu deficitin tregtar me Shqipërinë në mes 60 dhe 70 milion euro.

4.2.1.3. Pasqyrë e tregut

Përpunimi i ushqimit

Industria e ushqimit në Shqipëri ka arritur zhvillim të jashtëzakonshëm dhe të qëndrueshëm në vitet e fundit dhe tani është një degë e rëndësishme e ekonomisë, edhe pse ende nuk përbën pjesë thelbësore të ekonomisë.

Në vitin 2009, industria e ushqimit dhe pijeve gjeneroi afërsisht 223 milion euro, e cila paraqet rreth 20% të rezultatit të prodhimit apo 1.1% të BPV. Ka qenë një sektor me rritje të shpejtë, me një mesatare rreth 24.8% në vit, duke filluar nga viti 2000. Me gjithë rritjen e konsiderueshme të qarkullimit me 6.6 herë në vitin 2009 krahasuar me vitin 2000, sektori ka përjetuar një rënie me 10% krahasuar me vitin 2008. Në vitin 2009 industria e ushqimit dhe pijeve përbëhej nga 2,547 ndërmarrje (33.6% e të gjitha ndërmarrjeve prodhuese), 78% e të cilave operojnë në industrinë e bukës dhe miellit; 11% në sektorin

⁵SITC qëndron për Klasifikimi Standard i Tregtisë Ndërkombëtare i cili është klasifikim statistikor i mallrave që futen në tregti të jashtme.

e bulmetit, 6% në sektorin e pijeve dhe 5% në industrinë e përpunimit të mishit, peshkut, frutave dhe perimeve. Shumica e këtyre ndërmarrjeve janë në pronësi private, në madhësi të vogël apo të mesme dhe ndodhen në kryeqytet, Tiranë. Në vitin 2009, industria e ushqimit dhe pijeve punësonte afërsisht 7 mijë njerëz (apo 14% të fuqisë punëtore në prodhimtari) dhe produktiviteti i fuqisë punëtore është në rritje e sipër. Niveli i punësimit dhe numri i ndërmarrjeve në këtë sektor është rritur me 1.7 dhe 2.1 herë ndërmjet vitit 2000 dhe 2010 përkatësisht. Zhvillimi i sektorëve të ndryshëm dallon dhe investimet në kapitalin e paluajtshëm janë jostabile nga viti në vit. Përpunimi i prodhimeve të bulmetit dhe mishit kanë pasur investime të mëdha për të siguruar përputhshmëri me standardet.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e Shqipërisë,⁶ industria e agro-përpunimit mbulon 24.4% të prodhimit të përgjithshëm të vlerësuar (çmimet e vitit 2006) nga bujqësia dhe agro-industria. Rritjet më të mëdha ishin në ndërmarrjet për prodhimin e frutave dhe perimeve të konservuara, vajrave të rafinuara, prodhimeve të bulmetit, bukës, ëmbëlsirave, biskotave dhe verës. Vetëm një pjesë e vogël e lëndës së parë bujqësore u shitet agro-përpunuesve, nga të cilët shumica preferojnë të përdorin lëndë të parë të importuar të cilësisë më të mirë nga zinxhirë furnizues të besueshëm dhe me vëllime të mjaftueshme të produkteve. Kjo përfshinë vajin bimor për mbushje në shishe, rrushin për prodhim vere dhe mishin e perimet për konservim.

Bujqësia

Shqipëria ka deficit strukturor në të gjitha mallrat bujqësore kryesore si drithërat, frutat, farat për vajra, shpendët, mishi dhe sheqeri. Këto sektore janë zakonisht të organizuara përmes sistemeve të fermave familjare dhe në disa raste kërkojnë përpunim të gjerë. Shpenzimet totale të konsumatorëve për ushqim dhe pije janë më shumë se gjysma e shpenzimeve totale. Nga viti 2005, prodhimi i ushqimit organik u zvogëlua nga 0.11% në 0.05% të gjithë tokës bujqësore pavarësisht nga fakti se prodhimet organike janë bërë mallra më të popullarizuara dhe më të shtrenjta në shtetet në zhvillim.

Sidoqoftë, sektori bujqësor i Shqipërisë vazhdon të ballafaqohet me një numër sfidash, si madhësia e vogël e fermave dhe fragmentimi i tokës, infrastruktura e varfër, kufizimet e tregut, qasja e kufizuar në kredi e grante dhe institucione joadekuate rurale.

Produktiviteti i ulët, i kombinuar me infrastrukturë të dobët të transportit të brendshëm, mungesa e kontrollit të cilësisë për produktet që hyjnë dhe dalin, kanalet e tregtimit të pazhvilluara sa duhet (për shkak të mungesës së njohurive për tregtinë dhe informatave të pakta për tregun) dhe industria e përpunimit të ushqimit e pazhvilluar sa duhet, sjell në situatën që bujqësia e Shqipërisë mos të jetë aspak konkurruese. Megjithatë, bujqësia mbetet njëri prej sektoreve më të mëdha dhe më të rëndësishme në Shqipëri. Bujqësia është burimi kryesor i punësimit dhe të hyrave – posaçërisht në zonat rurale të vendit – dhe paraqet rreth 20% të BPV-së, ndërkaj përfshinë rreth gjysmën e të gjithë punësimit.

Përpunimi i drurit

Gjatë periudhës komuniste, përpunimi i drurit ishte një prej industrive më të suksesshme në Shqipëri. Sot kjo industri si edhe shumë të tjera, ballafaqohet me shumë probleme dhe varet nga faktorë të ndryshëm të cilët ndikojnë në indikatorët teknik dhe ekonomik të kësaj industrie në shumë mënyra të ndryshme.

Industria e përpunimit të drurit në Shqipëri përbëhet nga dhjetëra kompani të mëdha dhe qindra ndërmarrje të vogla dhe mesme, të shpërndara në të gjithë vendin. Gati 70% të këtyre kompanive merren me prodhimin e mobilieve, 18% e tyre merren me prerjen e drurëve, ndërsa pjesa tjetër merren me prodhimin e dyerve, dritareve dhe produkteve tjera.

⁶Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve e Shqipërisë, Fakte e Numra për Bujqësinë e Shqipërisë (2011)

Prodhimi i mobilie bazohet kryesisht në përdorimin e paneleve nga druri dhe iverplakave me densitet të mesëm.⁷

Materialet ndërtimore

Gjatë periudhës 1990-2000, industria e ndërtimit në Shqipëri ishte sektori biznesor më profitabil. Industria vlerësohej të kontribuonte me deri në 16% në BPV-në totale të vendit në vitin 2000.⁸ Kjo situatë ka vazhduar edhe gjatë dekadës së fundit, ku aktivitetet në sektorin ndërtimor të Shqipërisë kanë dëshmuar të jenë një prej burimeve kryesore të rritjes ekonomike, me 13-14% të BPV-së së saj.

Sidoqoftë, kostoja e importimit të materialeve ndërtimore, kryesisht strukturave të çelikut, i ka penguar aktivitetet ndërtimore në Shqipëri, shtet në majë të ndryshimit ekonomik pozitiv. Vakumet në industrinë vendore të çelikut e kanë bërë më të vështirë përmirësimin e infrastrukturës së transportit. Zhvillimet e reja komerciale dhe rezidenciale janë kufizuar. Në vitet e fundit, situata po ndryshon pasi që furnizuesi vendor kryesues i kombit, “Konstruksione Metalike”, ka rritur kapacitetet prodhuese dhe ka avancuar mundësitë teknologjike me ndihmën e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC). Kompania Konstruksione Metalike është prodhuesi i vetëm vendor që mund të konkurrojë me produkte të importuara, me mundësinë e prerjes, saldimit, ngjyrosjes dhe lustrimit.⁹ Prodhimi i çimentos është gjithashtu një segment i rëndësishëm në industrinë e ndërtimit. Kapacitetet e përgjithshme të prodhimit të çimentos janë duke u rritur vazhdimisht për shkak të investimeve të fundit në të gjitha fabrikat e mëdha të çimentos në Shqipëri.

4.2.1.4. Procedurat e përgjithshme të importit

Secili produkt i importuar duhet të bartë përshkrimin e produktit në gjuhën shqipe për artikujt ushqimor dhe në gjuhën greke, italiane apo angleze për artikujt jo-ushqimor. Është e detyrueshme të përshkruhen karakteristikat sanitare të ushqimit dhe produkteve mjekësore. Drejtorati Shqiptar i Akreditimit është institucioni përgjegjës për dhënien dhe verifikimin e certifikatave. Vlen të përmendet se qysh nga viti 1990, Shqipëria ka ndjekur rregullat e BE-së dhe OBT-së.

Dokumentacioni që duhet prezantuar përfshinë: certifikatën e cilësisë, certifikatën e analizave, certifikatën e origjinës dhe faturën e blerjes apo kontratën e blerjes.

Me të kaluar përmes Doganës, duhet mbushur deklaratën për mallrat. Agjenti doganor kontrollon mallrat dhe kalkulon taksën doganore.

Regjimi Doganor i Shqipërisë

Vendosja në regjimin e qarkullimit të lirë. Mallrat e vendosura në qarkullim të lirë, me nivel të reduktimit apo zero taksë doganore, për shkak të përdorimit të tyre të veçantë/të posaçëm, do të mbesin nën mbikëqyrjen doganore. Kjo mbikëqyrje duhet të përfundojë kur kushtet për nivel të reduktimit apo normë zero të taksës doganore pushojnë së ekzistuari, kur mallrat eksportohen apo shkatërrohen, apo kur mallrat përdoren për qëllime tjera nga ato për të cilat është aplikuar niveli i reduktimit apo norma zero e taksës doganore, me kusht që paguhen detyrimet përkatëse.

Regjimi i lejes së përkohshme lejon në territorin doganor të Shqipërisë, lirim të pjesërishtë apo total nga taksat doganore të importit dhe pa qenë subjekt i masave të politikave komerciale, për mallrat jo shqiptare të destinuar për rieksporim pa qenë pjesë e ndonjë ndryshimi, përveç zhvlerësimit për shkak të përdorimit të tyre.

⁷Çaushi dhe Marku (2013)

⁸Shqipëria - Ndërtimi i Studimit të sektorit të ndërtimtarisë dhe zhvillimi i gazsjellësit (Building Construction Sector Study And Pipeline Development) (2002)

⁹IFC-ja dhe materialet ndërtimore: Ndhima në zgjerimin e infrastrukturës (2008)

Regjimi i përpunimit të brendshëm i referohet procedurës doganore ku mallrat e importuara në Shqipëri, apo ato me origjinë nga Shqipëria, prodhohen apo përpunohen dhe më pas rieksporthen nga Shqipëria në formë të produktit kompensues. Regjimet e përpunimit të brendshëm u mundësojnë prodhuesve të importojnë material për lëndë të parë apo produkte gjysmë të përpunuara, të liruar plotësisht apo pjesërisht nga taksa doganore, dhe të prodhojnë/përpunojnë dhe të riekspertojnë produktet e përfunduara kompensuese. Produkti origjinal i importuar mund apo mund të mos jetë i dallueshëm nga produkti i përfunduar.

Regjimi i përpunimit të jashtëm aplikohet për mallrat shqiptare të eksportuara përkohësisht nga vendi për t'u përpunuar jashtë vendit dhe për t'u importuar në formë të produktit kompensues në territorin e Shqipërisë. Produktet kompensuese të riimportuara do të lirohen për qarkullim të lirë të liruar plotësisht apo pjesërisht nga taksa doganore.

Regjimi i magazinimit mundëson magazinimin në magazinë të doganës për:

- Mallrat jo-shqiptare që nuk janë subjekt i taksave doganore,
- Mallrat shqiptare, kur dispozitat në fuqi, në rast të magazinimit të tyre në doganë, kërkojnë aplikimin e masave në lidhje me eksportin e këtyre mallrave.

Magazina doganore mund të jetë publike apo private:

- Magazinat publike përdoren për të magazinuar mallra nga cilido person i interesuar;
- Magazinat private përdoren për të magazinuar mallra vetëm nga operatorët e magazinës.

Regjimi i transitit i referohet qarkullimit të mallrave nga një pikë doganore në një tjetër në territorin e Shqipërisë për:

- Mallrat jo-shqiptare që nuk janë subjekt i taksave doganore dhe taksave të importit,
- Mallrat shqiptare që janë subjekt i procedurave të eksportit.

Ky regjim gjithashtu mund të aplikohet në qarkullimin e mallrave tek një territor tjetër në rastet:

- E marrëveshjes së nënshkruar ndërkombëtare,
- Kur shoqërohet me dokumentin e transportit të lëshuar në territorin e Shqipërisë.

Regjimi i përpunimit të mallrave nën kontrollin doganor mundëson importin e mallrave jo-shqiptare të liruar nga taksat doganore; përdorimin e tyre në veprime që shkaktojnë ndryshimin e natyrës së tyre dhe më pas vendosjen në qarkullim të lirë të produkteve të marra si rezultat i këtyre veprimeve, me të paguar taksat përkatëse të importit.

Pranimi i përkohshëm aplikohet për mallrat që nuk do të lirohen për qarkullim të lirë menjëherë dhe mbahen përkohësisht në magazinë derisa të caktohen në ndonjë regjim tjetër doganor. Magazinat janë hapësira që janë aprovuar nga Autoritetet Doganore. Koha e magazinimit në këto zona nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë për mallrat nga transporti rrugor dhe hekurudhor dhe jo më shumë se 10 ditë për mallrat nga transporti detar.

4.2.1.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës

Shqipëria është anëtar i OBT-së që nga shtatori i vitit 2000. Duke iu bashkëngjitur OBT-së, Shqipëria është dashur që të harmonizojë legjislacionin e saj për tregti me rregullat ndërkombëtare dhe ato të OBT-së.

Tarifat doganore aplikohen në Nomenklaturën e Kombinuar të Klasifikimit të Mallrave. Ky klasifikim është në përputhshmëri me Nomenklaturën e Kombinuar të Klasifikimit të Mallrave të BE-së. Sistemi tarifor është shumë i thjeshtë. Sistemi tarifor më i favorizuar nacional i aplikueshëm është: 0%, 2%, 5%, 6%, 10% dhe 15%. Shqipëria vë taksat doganore në vlerën k.s.t (kosto, sigurim dhe transport) të importeve. Importet në Shqipëri janë subjekt i taksës mbi vlerën e shtuar (TVSH) prej 20%, e cila vlerësohet sipas vlerës k.s.t (kosto, sigurim dhe transport) të ngarkesës së importuar plus taksa doganore e aplikueshme.

Sipas MTL-ve, Shqipëria aplikon tarifa preferenciale të importit për palët nga CEFTA, shtetet anëtare të BE-së dhe Turqinë. Në rast të produkteve industriale (kapitujt 25-97 të Klasifikimit të Nomenklaturës së Mallrave) tarifa është 0%, ndërsa për produktet bujqësore ato janë siç janë përcaktuar në marrëveshjet përkatëse.

4.2.1.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore

Standardet

Shqipëria, në një shkallë të gjerë, ka aprovuar regjimet standarde të zhvilluara në vendet tjera perëndimore. Aplikimi i standardeve shqiptare është kryesisht vullnetarë përveç nëse është cekur ndryshe në mënyrë specifike në ligj. Drejtorati i Përgjithshëm për Standardizim – DPS është përgjegjës për zhvillimin dhe administrimin e standardeve shqiptare. Rreguloret e aprovuara teknike publikohen në Gazetën Zyrtare.

Organi për vlerësimin e përshtatshmërisë është Drejtorati i Përgjithshëm për Metrologji (DPM), ndërkaq Drejtorati Shqiptar për Akreditim (DSHA) është organi i vetëm nacional për të vlerësuar, në harmoni me standardet e dakorduara ndërkombëtarisht.^{10 11}

Rregullat e origjinës

Për mallrat nga shtete të caktuara aplikohet origjina preferenciale dhe jo-preferenciale. Origjina preferenciale ofrohet për mallrat me origjinë nga ato vende që kanë përmbushur kriteret të caktuara për të përfituar nga trajtimi i tarifës preferenciale. Preferencat tarifore përfshijnë: zero taksë doganore, tarifë zero apo tarifë të reduktuar brenda kuotave. Trajtimi me tarifë preferenciale i jepet të gjitha vendeve anëtare të CEFTA-s.¹² Kriteret për përcaktim të origjinës kërkojnë që mallrat të jenë të marra plotësisht apo të përpunuara mjaftueshëm, përtej operimeve minimale.

Mallra të marra plotësisht konsiderohen produktet minerale, frutat dhe perimet, kafshët e gjalla, etj.

Mallrat që nuk janë të marra plotësisht konsiderohen si të përpunuara mjaftueshëm nëse plotësohen disa kriteret të caktuara për mallra jo-origjinuese. Rregullat specifike përcaktohen në secilin dokument të marrëveshjes së tregtisë i cili zakonisht specifikon sasinë e përpunimit të mallrave jo-origjinuese në mënyrë që të fitohet origjina.

Dokumentet që dëshmojnë origjinën e mallrave janë:

- EUR1, EUR1 (CEFTA), EUR-MED
- Deklarata e origjinës, Deklarata Faturë (CEFTA)
- Certifikata e origjinës Formulari A
- Certifikata e origjinës.

¹⁰Uebfaqja e DPM-së <http://www.dpm.gov.al>

¹¹Uebfaqja e DPA-së <http://www.dpa.gov.al>

¹²Lista e tarifave preferenciale në Shqipëri mund të gjendet në linkun http://www.dogana.gov.al/sites/default/files/origjina/Tarifa_Preferenciale_2014.pdf

Etiketimi

Etiketat duhet të përmbajnë informatat që përputhen me standardet ndërkombëtare. Etiketat duhet të shtypen në gjuhën të cilën shumica e shqiptarëve e kuptojnë, si shqip, italisht apo anglisht.

Ndalesat dhe kufizimet

Importi, eksporti dhe transporti i materialeve radioaktive dhe materialeve bërthamore është subjekt i rregullave shumë të rrepta. Doganat monitorojnë se a janë importet, eksportet dhe transporti në pajtim me këto rregulla. Kjo lidhet kryesisht me kontrollimin e licencave për import, eksport apo transit të lëshuar nga Komisioni për Mbrojtje nga Rrezatimi.¹³

4.2.1.7. Kërkesat e sektorit

Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Rregullorja për siguri të ushqimit – Shqipëria është anëtar i Komisionit Codex Alimentarius dhe anëtar korrespondent i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO).

Ligji i ri për Ushqimin (2008) përcakton kushtet për prodhim, përpunim, konservim, shpërndarje, kontrollim dhe tregtim të produkteve ushqimore që përdoren nga konsumatorët. Shqipëria ka bërë progres në harmonizimin e legjislacionit të vet, politikave dhe kapaciteteve me standardet evropiane në shumicën e fushave, por ende nuk ka arritur të bëjë këtë në kontrollin bujqësor dhe veteriner/fitosanitar.

Kontrolli i cilësisë - Në vitin 2009, u themelua Autoriteti Kombëtar për Ushqim për të ngritur standardet e prodhimit në nivel të atyre të BE-së. Rregulloret veterinerë dhe fitosanitare përcaktojnë se kontrollet sanitare janë të imponueshme dhe monitorohen nga Minsitria e Bujqësisë (MB). Për ushqimin dhe agro-produktet e importuara, licenca duhet marrë nga drejtorati për cilësi të ushqimit dhe inspektim pranë MB-së. Sipas instrumentit për Asistencë para aderimit (IPA) në BE, Shqipëria përkrahet financiarisht për implementimin e standardeve për siguri të ushqimit si GMP, HACCP apo ISO. ALBINVEST, organ qeveritar, luan rol të rëndësishëm dhe ka programin me vlerë 5 milion euro për të ofruar grante deri në 50% të kostos për ndërmarrjet që janë të gatshme për të implementuar sisteme të tilla.

Për produktet bujqësore me origjinë nga BE-ja dhe Turqia janë të aplikueshme kuotat për tarifë.¹⁴ Duke qenë se kuotat e tilla nuk aplikohen për produktet me origjinë nga Kosova, kjo mund t'i vendosë firmat kosovare në një përparësi relative krahasuar me këto shtete.

Industria e përpunimit të drurit

Importet e disa specieve të rrezikuara të kafshëve dhe bimëve (apo pjesëve apo produkteve të prodhuara nga to) në shtetet e zhvilluara janë subjekt i përputhshmërisë me masat rregulluese për botën e egër. Masa të tilla janë të aplikueshme edhe në shtetet e BE-së. Sidoqoftë, Shqipëria nuk vë ndonjë masë të ngjashme për produktet e përpunimit të drurit. Përveç kësaj, Shqipëria nuk imponon rregulloret ISPM15 për materialet për ambalazh nga druri.

¹³Uebfaqja e doganave të Shqipërisë www.dogana.gov.al

¹⁴Lista e plotë e produkteve gjendet në

http://www.dogana.gov.al/sites/default/files/origjina/Tariff_quota_agricultural_products.pdf

4.2.2. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

4.2.2.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM) është një shtet me të hyra në nivelin e sipërm të mesatares që ka bërë hapa të mëdhenj në reformimin e ekonomisë gjatë dekadës së fundit. Ky shtet ka bërë arritje zhvillimore të konsiderueshme, por ende nevojiten më shumë përpjekje në disa fusha për të gjeneruar rritje ekonomike që do të rriste punësimin dhe përmirësonte standardin jetësor për të gjithë.

Nga 2.3% në vitin 2011, në vitin 2012 BPV reale në IRJM ka rënë në 1.8% dhe është rritur në 2.7% në vitin 2013 në krah të ndërtimit dhe eksportit. Sipas Bankës Botërore, rritja e BPV-së reale në IRJM vlerësohet të arrijë në 3.3% në vitin 2014.¹⁵

Borxhi i Qeverisë qendrore dhe sektorit publik në krahasim me BPV-në ka mbetur në nivel të moderuar prej 35.8% të BPV-së për Qeverinë Qendrore dhe 43.2% për sektorin publik në vitin 2013. Derisa borxhi i qeverisë qendrore parashihet të mbetet i pandryshueshëm, borxhi në sektorin publik parashihet të ketë rritje të shpejtë për të arritur në 49% në vitin 2016 pasi që Ndërmarrjet në Pronë të Qeverisë do të kenë një pjesë të konsiderueshme të këtij borxhi.

Qeveria ka publikuar kornizën fiskale afatmesme në shtator të vitit 2013 e cila parasheh rënie të deficitit qeveritar në një afat të mesëm nga 4.1% në vitin 2013 në 3.5% në vitin 2014, 3.2% në vitin 2015 dhe 2.6% në vitin 2016. Në vitin 2013 IRJM edhe njëherë u rendit si reformuesit më të mëdhenj në mbarë botën sipas raportit të të bërit biznes (Doing Business) dhe aderimi në BE vazhdon të jetë forca shtytëse për reforma në pothuajse çdo fushë të qeverisjes. Autoritetet janë duke harmonizuar legjislacionin nacional me *acquis communautaire* të BE-së dhe kanë bërë arritje të veçanta në prokurim, politikat e transportit, unionin doganor, taksat dhe statistikën.

Në përgjithësi legjislacioni është duke i harmonizuar politikat shtetërore me ato të BE-së, por është thelbësore të punohet më tutje për avancimin e kapaciteteve administrative për implementim dhe zbatim të legjislacionit.

IRJM-ja ka MTL me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Kosovën, Moldavinë, Rumaninë, Serbinë, Malin e Zi, Slloveninë, Turqinë dhe Ukrainën. Për të inkurajuar tregtinë, taksat doganore janë përcaktuar në nivelin minimal prej 1 deri në 2 përqind. Në shkurt të vitit 2001, IRJM-ja nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në. Një komponentë kritike e MSA-së është marrëveshja për tregti preferenciale, e cila mundëson që produktet të futen në BE nga IRJM-ja pa taksa doganore. Marrëveshja gjithashtu mundëson zbritje graduale (10 deri në 12 vjet) të taksave doganore për produktet nga BE-ja. Vendi ka gjithashtu marrëveshje me Shoqatën Evropiane për Tregti të Lirë (EFTA).

4.2.2.2. Marrëdhëniet me Kosovën

Kosova dhe IRJM-ja kanë nënshkruar Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë në vitin 2005 për të lehtësuar tregtimin.¹⁶ Që të dyja vendet kanë kontribuar për një marrëdhënie intensive të tregtimit të jashtëm me njëra tjetrën. Shifrat nga 2009 tregojnë se IRJM-ja eksporton pak më shumë në Serbi se sa në Kosovë apo vendet tjera fqinje, rreth 246 milion euro në Serbi dhe 219 milion euro në Kosovë. Nga viti 2010, Kosova është destinacioni kryesor për eksportet nga IRJM-ja krahasuar me vendet tjera në rajon si Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Mali i Zi.

Bazuar në të dhënat nga Zyra Statistikore Shtetërore e IRJM-së, viti 2013 shënon vlerën më të ulët të eksporteve për Kosovë (rreth 208 milion euro), ndërsa vlera më e madhe është raportuar në vitin 2011 (rreth 396 milion euro). Sa i përket partnerëve eksportues, Kosova është e katërta në listë (pas Gjermanisë, Bullgarisë dhe Italisë), ndërsa si partner për importe, Kosova mbetet në fund të listës së


¹⁵Informatat në dispozicion në linkun në vazhdim, f.7:

http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/GEP/GEP2015a/pdfs/GEP2015a_chapter2_regionaloutlook_ECA.pdf

¹⁶IRJM-ja është deri më tani i vetmi shtet që ka marrëveshje bilaterale me Kosovën për të njohur Policat për Detyrime Plus të Palës së Tretë për Makina (një formë e thjeshtësuar e aranzhimit të kartës së gjelbër) e cila e ka ndihmuar popullatën e Kosovës që të zgjerojë zonën e lëvizjes së lirë me makina të motorizuara, duke marrë në konsideratë që deri tani Kosova mbetet jashtë Byrosë së Kartave të Gjelbra në Bruksel.

burimeve nga të cilat mund të importohet.

Figura 6. Shkëmbimet tregtare me IRJM-në 2005-2013 (në '000 Euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Në anën tjetër, eksporti kosovar për në IRJM asnjëherë nuk ka kaluar 26 milion euro. Eksportet kanë arritur vlerën maksimale prej 25.8 milion euro në vitin 2011, ndërsa ka pasur vlerën më të ulët prej 6.7 milion euro në vitin 2009, gjë që tregon deficitin e madh tregtar ndërmjet këtyre dy shteteve.¹⁷

4.2.2.3. Pasqyrë e tregut

Përpunimi i ushqimit

Pavarësisht nga mungesa e të dhënave për publikun lidhur me vlerat nominale për prodhimin e produkteve ushqimore dhe pijeve, bazuar në Librin Vjetor të Statistikave të IRJM-së për vitin 2014,¹⁸ prodhimi i ushqimit dhe pijeve është rritur në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2010.

Krahasuar me 2010, prodhimi i ushqimit është rritur me 5%, 22% dhe 20% në vitet 2011, 2012 dhe 2013 përkatësisht. Një trend i ndryshëm nga ky shihet tek pijet ku prodhimi ka rënë me 14% dhe 6% në vitin 2011 dhe 2012 dhe vetëm në vitin 2013 është rritur me 1% krahasuar me vitin 2010.

Sa i përket mundësive për bizneset kosovare, kjo mund të interpretohet si shenjë se sa i përket prodhimtarisë së ushqimit, mund të ketë ndonjë marzhë për eksplorim, por tregu tregon shenja të ngopjes, ndërsa për pijet, me siguri se ka ndonjë treg më të vogël të specifikuar i cili duhet identifikuar.

Bujqësia

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm në ekonominë e IRJM-së. Vlera e shtuar bruto e prodhimit primar bujqësor ishte 8.9% e BPV-së për vitin 2008, duke arritur një normë të rritjes prej 7.1% krahasuar me vitin paraprak. Prodhimi i produkteve të freskëta dhe cilësore bujqësore të përpunuara është bazë e mirë për zhvillimin e sektorit të përpunimit të ushqimit, si dhe për ndërtimin e objekteve për prodhimin e ushqimeve. Kjo industri ka reputacion të mirë për produkte të cilësisë së lartë dhe qasje të shkëlqyeshme në tregjet rajonale e më gjerë. Produktet kryesore janë: frutat, perimet, vera, djathi i deles dhe i dhisë. Pjesa e industrisë së përpunimit të ushqimit është 6% e BPV-së, që ngërthen rreth

¹⁷Të dhënat për shkëmbim mallrash të IRJM-së sipas grupeve ekonomike të shteteve, në dispozicion këtu:

http://makstat.stat.gov.mk/pxweb2007bazi/Dialog/varval.asp?ma=02Nt_mk_2013_12_ZemjiEkgr_2013_ang&ti=Commodity+exchange+of+the+Republic+of+Macedonia+by+economic+groups+of+the+countries+for+the+period+01%2D12%2E+2013+preliminary+data&path=../Database/Statistics%20by%20subject/Foreign%20Trade/Commodity%20exchange%20trade%20by%20countries/&lang=1

¹⁸Libri Vjetor i Statistikave të IRJM-së. Në dispozicion këtu: http://www.stat.gov.mk/PrikaziPublikacija_1_en.aspx?rbr=485

12,000 punëtorë dhe kontribuon me 11% në punësimin total në sektorin e prodhimit të bimeve.

Sipas raportit “FYRoM in Figures” – IRJM-ja në shifra,¹⁹ prodhimtaria e bimëve në periudhën ndërmjet viteve 2003 dhe 2013 karakterizohet me rënie në nën-sektorin e drithërave, ndërsa është vërejtur ngritje në numrin e pemëve fruta-mbajtëse si pemët e mollës.

Përpunimi i drurit

Situata në lidhje me të dhënat për publik sa i përket përpunimit të drurit është e ngjashme me sektorin e përpunimit të ushqimit. E vetmja gjë që mund të nxirret nga Libri Vjetor i Statistikave të IRJM-së është që industria qëndron larg prej arritjes së nivelit të prodhimit që kishte në vitin 2010. Krahësuar me vitin 2010, viti 2011 ka mbetur prapa me 15%, viti 2012 me 14% dhe viti 2013 me 36%. Ky ngushtim i sektorit në aspektin e nivelit të prodhimit mund të jetë indikator që tregu është ngopur.

Kjo do të thotë që ndërmarrjet për përpunim të drurit nga Kosova ndoshta do të duhej të kërkonin tregje tjera për mallrat dhe shërbimet e tyre, e jo ato në IRJM.

Materialet ndërtimore

Ndërtimtaria ka qenë një kontribuues i madh në BPV-në e IRJM-së. Bazuar në raportin e sipër përmendur “IRJM-ja në shifra”, vlerat e punëve ndërtimore në IRJM siç është raportuar për vitet 2003, 2008 dhe 2013 tregojnë një rritje marramendëse (23% rritje për periudhën e parë dhe 143% për periodën e fundit) që në vlera nominale do të thotë që nga afërsisht 97 milion euro të investuara në vitin 2003, kjo shifër arriti vlerën 290 milion në vitin 2013. Fusha kryesore ekonomike me më së shumti investime ka qenë infrastruktura e transportit dhe fusha e dytë ishte ndërtimet e blloqeve banesore. Duke qenë se Kosova ka disa kapacitete që plotësojnë kërkesat nga këto dy aspekte specifike, ndoshta do të ishte përfituese për ndërmarrësit kosovar që të drejtohen kah kompanitë për infrastrukturë transporti dhe ato për ndërtim apartamentesh si partnerë potencial për eksport.

4.2.2.4.Procedurat e përgjithshme të importit²⁰

Vlerësimi doganor

Baza kryesore për vlerësimin doganor është lista zyrtare që mbahet nga Drejtorati Doganor. Secili artikull vlerësohet me çmimin e vet “të përshtatshëm” dhe taksat vihen bazuar në çmimin e tregut të përcaktuar nga qeveria, pavarësisht nga çmimi faktual i paguar. Vlera e taksueshme për doganë vlerësohet sipas CIF. Taksat doganore, taksat, dhe ngarkesat tjera siç janë paraqitur në pjesën e radhës duhen paguar për të zhdoganuar produktin përmes doganës së IRJM-së.

Dokumentacioni për import

Ofruesit e shërbimeve nuk janë subjekt i rregulloreve doganore, por transaksionet e tregtisë së jashtme janë subjekt i taksës për dokumentacion prej 1%. Certifikata e origjinës, fatura tregtare, fatura për ngarkim dhe deklarata e eksportit të transportuesit të mallrave janë të domosdoshme për të gjitha produktet e importuara.

Licencat për import

Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për lëshimin e licencave të importit. Vendimi ndanë artikujt në disa kategori me qëllim të licencimit. Derisa marrja e licencës për shumicën e produkteve është

¹⁹Maqedonia në shifra (2014). Në dispozicion prej: http://www.stat.gov.mk/Publikacii/MakBrojki2014_en.pdf

²⁰Më shumë informata gjenden tek: <http://countrycodes.boomja.com/index.php?ITEM=10720>

formalitet, për disa mallra, si produktet farmaceutike dhe pajisjet ushtarake, licencat është më vështirë të merren. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për lëshimin e licencave të importit për pajisjet mjekësore. Komisioni për Importe të Produkteve Farmaceutike i Ministrisë së Shëndetësisë është përgjegjëse për dhënien e licencave për produktet farmaceutike.

Hyrja e përkohshme

Produktet mund të eksportohen në IRJM përkohësisht. Rregullat për importet e përkohshme janë paraqitur në Rregulloren për Aplikimin e Ligjit të ri për Doganat (Gazeta Zyrtare Nr. 21/1998). Në përgjithësi, kompania duhet të postojë një garanci me të hyrë mallrat; kjo garanci kthehet kur mallrat lëshojnë vendin.

Disa produkte të importuara përkohësisht janë të lira nga taksat doganore: materialet e papërpunuara që përpunohen në IRJM dhe riekportohen; pajisjet infrastrukturore të prodhuara nga kontraktues të jashtëm; dhe pajisjet për zyra për firmat e huaja.

4.2.2.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës

Taksat doganore

Taksat doganore varen nga mallrat që eksportohen. Përgjithësisht, taksat doganore aplikohen tek gati të gjitha produktet që eksportohen në IRJM. Tarifat sillen prej 0 deri në 60%; vlera mesatare është 10%. Vlera më e ulët doganore prej 0% aplikohet për produktet si materialet për industrinë e tekstilit. Artikujt ushqimor, si frutat apo perimet, drithërat dhe pijet, kanë një normë më të madhe prej 60%. Edhe duhani futet në këtë kategori. Taksa doganore vlerësohet në bazë të CIF-së së mallrave.

Taksat e importit

Ekziston një taksë importi për kafën, cigaret, karburantin dhe pijet alkoolike.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH-ja është taksë e shitjes e tipit Evropian që aplikohet në të gjitha fazat e prodhimit të mallrave, duke përfshirë transaksionet e eksport/importit. TVSH-ja për IRJM-në është 18%, me 5% në shumicën e produkteve ushqimore me pakicë dhe pajisjet e prodhimit. TVSH-ja gjithashtu vlerësohet në bazë të CIF-së plus shuma e paguar për taksat.

Akciza, taksat për konsum dhe artikuj luks

Përveç shtesave për tarifën doganore, ekziston një akcizë për mallrat e luksit, duke përfshirë alkoolin, makinat, kafën, duhanin dhe vajrat minerale. Ekziston një legjislacion i veçantë për automobilat ku kërkohet aplikimi i një akcize prej 7.5% pavarësisht nga kapaciteti i motorit të makinës.

Kuotat

Në IRJM, aplikohen kuotat në mallra si duhani, vera dhe frutat e ndryshme; në total janë 130 produkte që janë subjekt i sistemit të kuotave. Kuotat u alokohen importuesve përmes tenderëve publik. Automobilat më të vjetër se gjashtë vjet nuk mund të importohen.

Kërkesat për etiketim dhe shenjim

Etiketat duhet të përmbajnë informatat në vijim: cilësinë, përmbajtësit, sasinë, mënyrën e ruajtjes, transportit, përdorimit, mirëmbajtjes, vendin e origjinës dhe afatin e përdorimit. Të gjitha informatat e sipër përmendura duhet të jenë në gjuhën maqedonase.

Rregullat e origjinës

Të gjitha mallrat e eksportuara në IRJM duhet të përmbushin elementet e aplikueshme si: Toleranca, Kumulimi, Transporti Direkt, Kthimi i Taksës Doganore, Kushtet e Aniëve, dhe Rregullat Specifike për Produkte.²¹

4.2.2.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore

Ligjet dhe rregulloret

Legjislacioni i IRJM-së parasheh caktimin dhe aplikimin e procedurave adekuate dhe të besueshme sa i përket kërkesave për sigurinë e përgjithshme të produkteve, mënyrën e përshkrimit të kërkesave teknike si dhe parimet e njohjes reciproke për përputhshmëri me dokumentet e jashtme dhe shënjimin.

Legjislacioni kyç përfshin ligjet në vijim: Ligjin për Sigurinë e Produkteve, Ligjin për Metrologji, Ligjin për Kontrollin e Artikujve nga Metalet e Çmuara dhe Ligjin për Akreditimin.

Standardi i kërkesave teknike

Kjo rregullore parasheh disa kërkesa për produkte specifike, të cilat mund t'i referohen:

- Kërkesave minimale thelbësore të cilat duhen të përmbushen nga produktet;
- Procedurave, mënyrës dhe kushteve për vlerësim të produkteve në përputhshmëri me kërkesat e përshkruara;
- Kushteve që duhet të përmbushen nga autoritetet që marrin pjesë në procedurën e vlerësimit të përputhshmërisë;
- Tipit të dokumenteve shoqëruese kur produktet lirohen në treg apo në qarkullim;
- Obligimeve dhe mënyrave të shënjitimit të produkteve;
- Referencave për standardet dhe specifikimet tjera teknike;
- Formatit dhe përmbajtjes së dokumentacionit teknik, si dhe mënyrës dhe periudhës së mbajtjes së të dhënave; dhe
- Klauzolën mbrojtëse dhe procedurën raportuese.

Përshkrimi i procedurave

Rregulloret teknike janë miratuar nga Ministri i Ekonomisë apo ministri i autorizuar me ligj si autoriteti kompetent për çështjet lidhur me prodhimin, tregun dhe lirin e produkteve të caktuara apo grupin e produkteve në qarkullim të lirë. Gjatë importimit të produktit që është subjekt i kësaj rregulloreje, importuesi duhet të sigurojë që produkti është në përputhshmëri me kërkesat teknike të përcaktuara.

Vlerësimi i përputhshmërisë me kërkesat teknike mund të bëhet nga subjektet e autorizuar ligjore. Ministri i Ekonomisë lëshon një autorizim të tillë, bazuar në kriteret për akreditim në pajtueshmëri me Ligjin për Akreditim. Subjektet e autorizuar kanë autoritetin për të lëshuar certifikata përputhshmërie pas aplikimit me shkrim nga personat e interesuar juridik apo fizik.

²¹Më shumë informata gjenden në:

http://exporthelp.europa.eu/thdapp/display.htm?page=cd%2fcd_RulesOfOriginMacedonia.html&docType=main&languageId=en

IRJM-ja pranon dokumentet e jashtme të përshtatshmërisë dhe shënjin e lëshuar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara dhe të aprovuara nga IRJM-ja.

Autoritetet kontrolluese monitoruese

Monitorimi dhe kontrolli për zbatimin e dispozitave nga Ligji për Sigurinë e Produkteve bëhet nga Inspektorati Shtetëror i Tregut, Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor, si dhe disa autoritete tjera zyrtare inspektuese.

Monitorimi dhe kontrolli i autoriteteve të akredituara për vlerësim bëhet nga Instituti për Akreditim i IRJM-së (IARM). IARM-ja vendosë lidhur me mënyrën dhe procedurën e akreditimit për arritjen e kompetencave të autoriteteve për vlerësim të përputhshmërisë, si dhe për kontrollin për përputhshmërinë me kërkesat e akreditimit.

Byroja e Metrologjisë është një autoritet pranë Ministrisë së Ekonomisë përgjegjëse për implementimin e Ligjit për Metrologjinë dhe Ligjit për Kontroll të Artikujve nga Metalet e Çmuara. Byroja e Metrologjisë inspekton përputhshmërinë me standardet e metrologjisë nga makinat dhe llojet tjera të mallrave dhe lëshon lejet për eksport/import për këto lloj mallrash.

4.2.2.7. Kërkesat e sektorit

Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Siguria e ushqimit në IRJM është e rregulluar me dy ligje:

1. Ligji për Sigurinë e Ushqimit për produktet ushqimore dhe produktet që janë në kontakt me produktet ushqimore (2002); i ndryshuar me
 - a. Amandamentimin e Ligjit për Sigurinë e Ushqimit, Produkteve dhe Materialeve në kontakt me produktet ushqimore (2007); dhe
2. Ligjin për Sigurinë e Ushqimit Nr. 157/10 (2010).

Qëllimi i ligjit për sigurinë e ushqimit (2010) është që të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve sa i përket artikujve ushqimor.

Ky ligj dhe amandamentimet e tij 53/2011 dhe 1/2012, janë korniza legjislative nacionale për sigurinë e ushqimit dhe ofrojnë bazën e përgjithshme ligjore për rregullat për higjienën e ushqimit, rregullat specifike për produktet me origjinë shtazore, rregullat për kontroll dhe rregullat specifike për kontroll të produkteve me origjinë shtazore. Së bashku ato përbëjnë bazën ligjore për implementimin e kategorizimit apo ristrukturimit të personave juridik – operatorëve të biznesit që merren me ushqim me origjinë shtazore sipas kriterëve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian.

Autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e implementimit të ligjeve janë:

- Ministria e Shëndetësisë – Drejtorati për Ushqim;
- Ministria e Bujqësisë – Agjencia për Ushqim dhe Veterinari; dhe
- Laboratorët – Fakulteti i Mjekësisë Veterinere (Shkup), Laboratorët e Institutit për Shëndet Publik (me rrjetin e 10 laboratorëve rajonal); Laboratorët Shtetëror për Fitosanitari.

Agjencia për Ushqim dhe Veterinari është e autorizuar për të kryer kontrole zyrtare të ushqimit për njerëz dhe kafshë. Për të pasur mundësinë e eksportimit të artikujve ushqimor, qofshin ato me origjinë shtazore apo jo, duhet marrë një miratim nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari.

Etiketimi dhe ambalazhimi – Nenet 29 dhe 30 të Ligjit 157/10 përcaktojnë që ushqimi për njerëz dhe/ose kafshë duhet të jetë i ambalazhuar si duhet dhe etiketat duhet të theksojnë qartazi përmbajtjen e ushqimit. Ky ligj në mënyrë eksplicite ndalon ndonjë insinuatë në etiketim se përmbajtja (ushqimi) mund të shërojë sëmundje.

Materialet ndërtimore

Sektori i ndërtimtarisë së IRJM-së është i rregulluar me Ligjin Hapësinor dhe Urban i cili ka pasur një numër amandamentimesh siç është përcaktuar me numrat e ligjit: 51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11, 144/12 dhe 55/13. Ky ligj kufizon përfshirjen e kompanive të jashtme ndërtimore në aktivitetet e ndërtimit duke e bërë të detyrueshme regjistrimin e subjektit juridik brenda shtetit, të cilat më pas bëhen kompani vendore pavarësisht faktit se themeluesi është i huaj.

Sipas ligjit për materiale ndërtimore (Nr. 39/06, 86/08, 47/11 dhe 136/11), kërkesat në vijim duhet të përmbushen nga materialet ndërtimore: të ofrojë stabilitet mekanik, të ofrojë siguri ndaj zjarrit, të ofrojë higjienë dhe mbrojtje të shëndetit për mjedisin, të jetë i sigurt për operim, të ofrojë izolim akustik dhe të kursejë energjinë në aspektin e ruajtjes së temperaturës.

Ky ligj nuk rregullon materialet që duhen përdorur dhe ndoshta kjo është një mundësi për bizneset kosovare që janë të përfshira në prodhimin e materialeve ndërtimore.

4.2.3. Mali i Zi

4.2.3.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike

Mali i Zi është një vend i vogël me një ekonomi që varet nga turizmi, shërbimet e ndërlidhura dhe përpunimi i metaleve. Mungesa e diversifikimit ekonomik dhe varësia nga financimet e jashtme cenojnë kolaps serioz të prodhimit dhe BPV-së gjatë recesioneve, siç ishte rasti i vitit 2009.

Ekonomia e Malit të Zi është duke u transformuar ngadalë në sistem të tregut, por sektori shtetëror mbetet i madh dhe nevojiten ndryshime tjera institucionale. Ndërmarrjet jo-profitabile në pronësi të shtetit, posaçërisht “Fabrika e Aluminit Podgorica”, eksportuesi më i madh në vend, varen shumë nga financat publike.

Mali i Zi e ka mbajtur bankën e vet qendrore, ka pranuar Markën Gjermane dhe më pas ka kaluar në Euro – e jo dinarin Jugosllav – si valutë zyrtare, ka mbledhur tarifatat doganore dhe ka menaxhuar buxhetin e saj.

Shpërbërja e vitit 2006 e bashkimit të çlirët politik ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi ka çuar në anëtarësi të ndarë në shumë institucione financiare ndërkombëtare, si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Në janar të 2007, Mali i Zi iu bashkua Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (IMF). Mali i Zi u bë anëtar i 156-të i Organizatës Botërore të Tregtisë në dhjetor 2011. KE i dha statusin e vendit kandidat Malit të Zi në seancën e dhjetorit 2010. Mali i Zi filloi negociatat për anëtarësim në KE në qershor 2012, pasi që kishte përmbyllur të gjitha kushtet e përcaktuara nga KE që kishin kërkuar nga Mali i Zi për të ndërmarrë hapat për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.


Papunësia dhe pabarazitë në zhvillimet rajonale, posaçërisht në veri, mbetin problemet kyçe politike dhe ekonomike. Kriza financiare globale kishte ndikim të madh negativ në ekonomi, për shkak të mungesës kreditore, rënies në sektorin e pasurisë së patundshme dhe rënies në eksportet e aluminit. Qeveria e Malit të Zi rriti taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH) nga 17% në vitin 2012 në 19% në vitin 2013 dhe rriti normën e taksave në të hyra nga 9% në 15% për ata që marrin të hyra mbi 480 euro në muaj. Në vitin 2013, edhe qeveria bëri shkurtime duke ngrirë pensionet dhe duke kufizuar rritjet e pagave për ndërmarrjet publike dhe deputetët e parlamentit.

4.2.3.2. Marrëdhëniet me Kosovën

Kosova dhe Mali i Zi kanë kultivuar marrëdhënie të mira. Kjo mbështetet me shifrat e tregtisë ku eksportet kosovare për Mal të Zi tregojnë rritje të vazhdueshme gjatë periudhës 2005-2013. Veç kësaj, Kosova ka arritur një bilanc pozitiv tregtar me Malin e Zi në fund të vitit 2011 dhe ka rritur vakumin pozitiv për dy vite me radhë. Eksportet malaziasë për Kosovë ishin rreth 10 milion euro në vitin 2012 dhe janë rritur në rreth 11.3 milion euro në vitin 2013, ndërsa eksportet kosovare për Mal të Zi për të njëjtën periudhë, mbetin 17 milion euro në vitin 2013, kështu duke gjeneruar bilanc pozitiv tregtar.

Një fakt tjetër që vlen të përmendet, posaçërisht kur kihet parasysh që turizmi është kontribuesi kryesor në BPV-në e Malit të Zi, është që nuk ka llogaritje të shifrave të qarkullimit për turizmin për Kosovën.

Figura 7. Shkëmbimi tregtar me Malin e Zi 2005-2013 (në '000 Euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

4.2.3.3. Pasqyrë e tregut

Përpunimi i ushqimit

Bazuar në Librin Statistikor Vjetor të Malit të Zi për vitin 2013, prodhimi i ushqimit dhe pijeve ka pësuar rënie të vazhdueshme nga viti 2010.²²

Prodhimi i ushqimit ka rënë vazhdimisht: me 10% ndërmjet viteve 2009 e 2010; 5% ndërmjet viteve 2010 e 2011; dhe pak më pak se 1% ndërmjet viteve 2011 e 2012. Sa i përket pijeve, situata duket të jetë pak më e qëndrueshme me indikatorë të trendit në rritje të lehtë për periudhën (2010-2013), pasi që konsumi në vitin 2011 ka qenë më i lartë (në vlerën 20 milion euro) krahasuar me 2010 (në vlerën 18 milion euro), duke u rritur prapë në vitin 2012 (në vlerën 21 milion euro), para se të pësojë rënie të lehtë në vitin 2013 krahasuar me 2012 (në vlerën 20 milion euro).

Bujqësia

Duke marrë në konsideratë konfiguracionin gjeografik të natyrës së Malit të Zi, mund të thuhet që nuk ka përparësi krahasuese që ky shtet i gëzon në aspektin e bujqësisë. Vlera e shtuar bruto e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë primare ka qenë 7.9% e BPV-së në vitin 2011 dhe 7.4% në vitin 2012 (por është e sigurt të supozohet se ky është më shumë kontribut i peshkatarisë dhe pylltarisë sesa i bujqësisë).

Shitjet e produkteve bujqësore (duke përfshirë peshkun) për vitet 2010, 2011 dhe 2012 janë afërsisht 6.5 milion euro në vit, ndërsa blerja e artikujve të njëjtë për këtë periudhë është rreth 9 milion euro, 16 milion euro dhe 19 milion euro, respektivisht.²³

Këto shifra tregojnë se ka një mundësi për fermerët kosovarë për të eksportuar në tregjet malaziasë të cilat, marrë në konsideratë afërsinë e tyre marrin rëndësi më të madhe.

²²Në dispozicion në linkun: http://www.monstat.org/eng/publikacije_page.php?id=103

²³Në dispozicion në linkun: http://www.monstat.org/eng/publikacije_page.php?id=1159

Përpunimi i drurit

Situata me të dhënat në dispozicion për publikun sa i përket përpunimit të drurit është e ngjashme me sektorin e ushqimit dhe pijeve. E vetmja gjë që mund të nxirret nga Libri Statistikor Vjetor i Malit të Zi është që kjo industri ka pasur disa paqëndrueshmëri në prodhim gjatë periudhës 2008-2012. Ajo në fakt gjatë gjithë periudhës ka pësuar rënie, përveç rritjeve të shpejta në 2010 dhe 2011 kur u rrit (4.5% në 2010 krahasuar me vitin 2009, dhe 34.6 % në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010). Në vitin 2012, kjo industri është tkurrur me 35.4% krahasuar me vitin 2011.

Kjo do të thotë që ndërmarrjet kosovare për përpunim të drurit duhet të kërkojnë tregje tjera për plasimin e mallrave dhe shërbimeve të tyre, e jo tregun e Malit të Zi.

Materialet ndërtimore

Sektori i ndërtimtarisë në Mal të Zi është tkurrur vazhdimisht nga viti 2008. Vlera e punëve ndërtimore të përfunduara në vitin 2008 ishte rreth 412 milion euro, ndërsa në vitin 2012 arriti vlerën prej 257 milion euro. Këto shifra mund të interpretohen si indikatorë të ngopjes së tregut të ndërtimit në Mal të Zi, prandaj ndërmarrësit kosovar ndoshta mund të gjejnë tregje të vogla specifike, ndërsa përveç kësaj duket se ka një fushë shumë të ngushtë për eksport të materialeve dhe shërbimeve ndërtimore në Mal të Zi.

4.2.3.4. Procedurat e përgjithshme të importit

Mallrat e importuara nga jashtë, për të cilat nuk ka lirim nga pagesa e taksave doganore për import, zhdoganohen me procedurë të rregullt doganore. Pala në procedurë doganore nuk është e domosdoshme të jetë pjesëmarrëse drejtpërdrejt, andaj mund të autorizojnë ndonjë përfaqësues apo agjent doganor i cili do të përfaqësojë palën tek autoritetet doganore.

Pikat ndër-kufitare mund të dërgojnë mallrat me deklaratë transiti tek zyrat doganore brenda në vend ku duhet të kryhen procedurat e rregullta doganore. Dokumentet në vijim duhet të dorëzohen tek zyra doganore ku mallrat janë duke u zhdoganuar: deklarata doganore për import; fatura dhe dokumentet tjera tregtare; dokumentet e transportit; certifikata e lëshuar nga autoriteti kompetent, apo aprovimi (licenca) për import, nëse është e përcaktuar për disa lloje të mallrave.

Deklarata e importit – Mallrat që importohen duhet të shoqërohen me deklaratë importi. Deklaratat doganore duhet të dorëzohen: në të shkruar; transfer elektronik të dhënash (atëherë kur ekzistojnë kushtet teknike dhe kur përdorimi i mjeteve të tilla është i autorizuar nga shërbimi doganor); apo fizikisht.

Dokumenti i vetëm Administrativ (DVA) është formular i rregulluar që përdoret si deklaratë doganore me shkrim. Ajo duhet të jetë e nënshkruar dhe duhet të përmbajë të gjitha informatat e nevojshme për aplikimin e rregulloreve që rregullojnë importin e mallrave. Përgjithësisht, kjo plotësohet nga personi i autorizuar për përfaqësim duke futur të dhënat për: blerësin e mallrave, regjimin e importit, vendin e origjinës së mallrave dhe vendin e pagesës, datën e transferimit të mallrave nëpër kufi, mjetet e transportit, çmimin, peshën bruto dhe neto në kilogram, etj.

Deklaratat doganore mund të dorëzohen vetëm nga personi i autorizuar i cili është në gjendje të sjellë mallrat për inspektim apo të sigurojë kontrollim të mallrave nga autoriteti doganor kompetent, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme për qëllime të implementimit të rregullave që rregullojnë procesin për të cilin janë deklaruar mallrat. Personi që aplikon për deklaratë doganore duhet të ketë qëndrim apo banim në Mal të Zi.

Zyra doganore, me qëllim të kontrollimit të deklarave doganore që pranon, mundet:

- Të ekzaminojë dokumentet e përfshira në deklaraten doganore dhe dokumentet e bashkëngjitura deklarates;
- Të kërkojë nga personi që aplikon për deklarate doganore që të dorëzojë dokumente shtesë me qëllim të verifikimit të saktësisë së të dhënave në deklarate;
- Të ekzaminojë mallrat dhe të merr mostra për analiza të mallrave apo për ekzaminime të mëtutjeshme.

Transporti i mallrave deri në vendin e inspektimit apo marrjes së mostrave si dhe manovrimi i nevojshëm i mallrave gjatë inspektimit apo marrjes së mostrave kryhet nga personi që aplikon për deklarate doganore apo kryhet nën përgjegjësinë e tij/saj. Kostot që dalin nga kjo barten nga personi që aplikon për deklarate.

4.2.3.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës

Taksat doganore

Taksat doganore varen nga mallrat që eksportohen. Përgjithësisht, taksat doganore aplikohen gati tek të gjitha produktet që eksportohen në Mal të Zi. Tarifat sillen prej 0 deri në 30%, por mund të ketë edhe shtesa në bazë të €/kg, e cila do të rrisë taksat doganore fillestare edhe pse këto zakonisht janë të mbuluara.²⁴ Taksa më e ulët doganore prej 0% aplikohet tek produktet si materialet për industrinë e tekstilit. Artikujt ushqimor, si pemët e perimet, drithërat dhe pijet, kërkojnë një normë më të lartë prej 60%. Edhe duhani përfshihet në këtë kategori. Taksa doganore vlerësohet në bazë të CIF-it (kostoja e mallrave, sigurimi, transporti) të mallit.

Norma e detyrimeve të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) për produktet bujqësore është 14.79% dhe 4.44% për produktet industriale. Norma mesatare e aplikuar për kombin më të favorizuar (KMF) ishte 5.79% në vitin 2013, ndërsa për produktet bujqësore kjo ishte 14.09% dhe për produktet industriale 3.35%.

Taksa e importit

Ekziston taksë e importit për cigare, pije alkoolike dhe makina e pjesë makinash. Akciza për cigare në Mal të Zi ka një komponentë specifike të akcizës, e përcaktuar si një shumë për 1,000 copë dhe akcizë ad valorem (sipas vlerës), e përcaktuar si përqindje e çmimit me pakicë të kategorisë së cigareve me çmimin më të njohur. Sa i përket taksimit minimal të cigareve, legjislacioni malazias për akcizë kërkon që taksa e akcizës të jetë së paku 110% e akcizës totale (specifike dhe ad valorem) të cigareve me çmimin më të njohur. Normat e akcizës doganore në alkool dhe pije alkoolike janë si në vijim: për birrat: 5 euro për përmbajtjen e alkoolit sipas vëllimit për një hektolitër (hl) birra; për verat: 0 euro për hl verë; për vera të gazuara: 35 euro për hl; për pije të pa gazuara të fermentuara: 0 euro për hl, për pije të gazuara të fermentuara: 35 euro për hl, për pije alkoolike të ndërmjetme.²⁵ Makinat janë subjekt i taksës prej €10/ccm3 deri €50/ccm3 varësisht nga madhësia. Shuma për t'u paguar varet nga vlera, modeli, viti, centimetrat kub dhe aksesoret.²⁶

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH-ja për Mal të Zi është 19%, me normë të reduktuar prej 7% në disa prej artikujve bazik ushqimor (buka, uji për pije), libra dhe gazeta dhe disa artikuj të tjerë.²⁷ TVSH-ja vlerësohet në bazë të CIF-it plus shuma e paguar në taksa doganore. Ekziston një normë paushall e fermerëve prej 5% dhe ekziston

²⁴ Si shembull vaji i ullirit Lampant ka këtë strukturë 30% + 1€/kg, maksimumi 51%.

²⁵ Në dispozicion në linkun: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/montenegro/screening_reports/screening_report_montenegro_ch16.pdf

²⁶ Importimi i pronës personale. Në dispozicion në linkun: <http://webportal.atlasintl.com/Customs%20Docs/montenegro.pdf>

²⁷ Për një listë të detajuar të artikujve: <http://www.kpmg.com/Global/en/IssuesAndInsights/ArticlesPublications/vat-gst-essentials/Pages/montenegro.aspx#1>

një listë e artikujve të liruar nga TVSH-ja (p.sh. shërbimet zyrtare postare, arsimi, shëndetësia dhe mirëqenia, etj.).

Kërkesat për etiketim dhe shenjim

Duke pasur parasysh që Mali i Zi është në proces të bashkimit me BE-në, kërkesat për etiketim dhe shenjim, si shumica e ligjeve dhe rregulloreve në vend janë në harmoni apo janë duke u harmonizuar me ligjet dhe rregulloret e BE-së. Për shembull, kërkesat për etiketim dhe shenjim të produkteve ushqimore janë definuar me rregullore EC 178/2002 të KE-së.

Rregullat e origjinës

Të gjitha mallrat që eksportohen në Mal të Zi duhet të përmbushin elementet e aplikueshme të: Tolerancës, Kumulimit, Transportit Direkt, Kthimit të Taksës Doganore, Kushtet e Anijeve, dhe Rregullat Specifike për Produkte.²⁸

4.2.3.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore

Ligjet dhe rregulloret

Ligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësimin e Përputhshmërisë, Ligji për Standardizimin, Ligji për Metrologji, Ligji për Akreditim dhe Ligji për Siguri të Përgjithshme të Produkteve dhe aktet nënligjore të miratuara në bazën e tyre përbëjnë bazën ligjore për miratimin dhe implementimin e legjislacionit teknik. Legjislacioni i tillë i vendosë të gjitha parimet evropiane në kuptimin horizontal, ndërsa legjislacioni vertikal që aplikohet tek disa grupe të produkteve duhet të harmonizohet gradualisht brenda ministrive kompetente.

Standardi i kërkesave teknike

Në pajtim me Nenin 30 të Ligjit për Tregti të Jashtme, përputhshmëria me rregulloret teknike që aplikohen në Mal të Zi mund të përshkruhet si kërkesë për import të mallrave. Rregullorja teknike në këtë aspekt përcakton kriteret e kërkuara për tregtimin e mallrave në mënyrë që të mbrohet siguria, jeta, shëndeti dhe siguria e njerëzve, bimët dhe kafshët dhe mbrojtja e mjedisit.

Rregulloret teknike aplikohen pavarësisht nga origjina e mallrave dhe mund të përfshijnë së paku një nga elementet e mëposhtme:

- Kërkesat teknike që duhet të përmbushen nga produktet që plasohen në treg;
- Kërkesat për siguri të produktit në përdorim;
- Kontrollat e rregullta dhe të jashtëzakonshme të produktit në përdorim;
- Kërkesat për ambalazhim dhe etiketim;
- Detyrimet e furnizuesve të produkteve në treg;
- Procedurat për vlerësim të përputhshmërisë;
- Kërkesat që duhet përmbushur nga organi për vlerësim të përputhshmërisë;
- Certifikatat e përputhshmërisë dhe dokumentacioni teknik i nevojshëm për të dëshmuar përputhshmërinë e produktit që duhet të vihet në dispozicion të organeve kompetente (udhëzimet, të dhënat, etj.);
- Shenja dhe mënyra e shënjitimit të produktit.

²⁸Më shumë informata në linkun: http://ec.europa.eu/taxation_customs/customs/customs_duties/rules_origin/article_784_en.htm#albania

Përshkrimi i procedurave

Produktet mund të shpërndahen apo plasohen në treg për përdorim vetëm nëse, në pajtueshmëri me kërkesat teknike të përshkruara, përputhshmëria e tyre është vlerësuar sipas procedurës së caktuar, dhe nëse janë shënjuar sipas rregulloreve.

Nëse organi për vlerësim zbulon se produkti i plotëson rregulloret teknike, atëherë lëshon licencën e përputhshmërisë për kërkesat e paracaktuara teknike. Dokumentet që konfirmojnë përputhshmërinë e produkteve sipas kërkesave të paracaktuara teknike janë si në vijim: certifikata, raporti për testimin e produktit dhe deklarata e përputhshmërisë. Certifikata dhe raporti për testimin e produktit lëshohen nga organi për vlerësim të përputhshmërisë. Deklarata e përputhshmërisë ofrohet nga prodhuesi apo furnizuesi i produktit që konfirmon të mëposhtmet:

- Prodhuesi apo furnizuesi i produktit kryen kontrollin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me sigurinë e produktit;
- Produkti ka të gjithë dokumentacionin e duhur lidhur me testimin që padyshim garanton përputhshmërinë e produktit me kërkesat teknike; dhe
- Prodhuesi apo furnizuesi pranojnë detyrimet për sigurinë e produktit.

Rregullorja teknike specifikon që produktet për të cilat furnizuesi, para tregtimit apo përdorimit, obligohet të veprojë si në vijim:

- Të ofrojë aplikimin e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë;
- Të lëshojë apo të ofrojë dokumentin e duhur të përputhshmërisë;
- Të zhvillojë dhe të ofrojë mbajtje të dokumentacionit teknik përbrenda fushëveprimit të paracaktuar, formularin dhe kufizimet kohore;
- Të ofrojë etiketimin e produktit me shenjat e paracaktuara të përputhshmërisë.

Para tregtimit apo përdorimit të produktit i cili është në përputhje me rregulloret teknike, ai etiketohet me shenjat e përputhshmërisë si në vijim:

- Shënjimin 'CE';
- Shënjimin 'E' për homologimin e pjesëve të makinave;
- Shënjimin tjetër në pajtueshmëri me rregulloret teknike.

Autoritetet kontrolluese dhe monitoruese

Mali i Zi nuk kryen kontrolle inspektimi në kufi. Autoriteti doganor do të shtyjë lëshimin e produktit në qarkullim për tri ditë dhe informon autoritetin kompetent inspektues lidhur me vendimin. Lëshimi shtyhet nëse autoriteti doganor gjatë procedurës doganore përcakton se disa produkte, apo një grup/seri e produkteve, kanë karakteristika të cilat ngritin dyshimin se paraqesin rrezik serioz për shëndetin dhe për sigurinë e konsumatorëve, apo që produktet nuk përputhen me dokumentet e paracaktuara apo që ato nuk janë shënjuar si duhet.

Sa i përket mbikëqyrjes së tregut, varësisht nga vlerësimi i rrezikut, inspektorët e tregut marrin mostra nga produktet dhe i dërgojnë ato për testim tek organet për vlerësim të përputhshmërisë. Inspektorët gjithashtu mund të kërkojnë largimin e etiketave jo të rregullta nga produktet, të ndalojnë apo të kufizojnë plasimin në treg, apo të urdhërojnë tërheqjen nga tregu të produkteve të papërputhshme dhe të ndërmarrin masa tjera.

Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese përcaktohet se produkti përputhet me rregulloret teknike, por prapë mund të rrezikojnë interesin publik, posaçërisht sigurinë e jetës, shëndetit njerëzor, të kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronave, organi kompetent inspektues duhet të ndërmarrë masa për të tërhequr ato produkte nga tregu apo të ndalojë a kufizojë shpërndarjen e tyre në treg.

4.2.3.7. Kërkesat e sektorit

Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Kërkesa ligjore – Ligji kryesor për rregullimin e sigurisë së ushqimit në Mal të Zi është Ligji për Siguri të Ushqimit Nr. 40/11 i aprovuar në vitin 2011. Siç edhe kuptohet nga emri i ligjit, ky ligj rregullon bazën dhe parimet për sigurimin e nivelit të lartë të mbrojtjes së jetës njerëzore dhe shëndetit e interesave të konsumatorëve si dhe kërkesat për prodhim dhe qarkullim të ushqimit të sigurt për njerëz e kafshë.

Në përcaktimin se a është ushqimi i sigurt, siç parashihet në nenin 23 të ligjit, duhet marrë në konsideratë të mëposhtmet:

- Përmbytjen e kërkesave të paracaktuara në secilën fazë të prodhimit dhe qarkullimit dhe kërkesave për manovrim, ruajtje dhe ekspozim të ushqimit para shitjes tek konsumatori, si dhe kërkesave për përgatitje dhe konsum të ushqimit në pajtueshmëri me përdorimin e destinuar;
- Informatat e ofruara për konsumatorin, duke përfshirë informatat në etiketë dhe përputhshmërinë me specifikimin e prodhuesit, apo informata tjera që përgjithësisht janë në dispozicion për konsumatorin, lidhur me parandalimin e efekteve të dëmshme në shëndetin njerëzor nga një kategori e veçantë e ushqimit.

Autoritetet përgjegjëse për të siguruar zbatimin e ligjit janë:

- Ministria përgjegjëse për çështje bujqësore (këtu e në vijim e referuar si: Ministria e Bujqësisë);
- Ministria përgjegjëse për çështje të shëndetit (këtu e në vijim e referuar si: Ministria e Shëndetësisë);
- Autoriteti shtetëror administrativ përgjegjës për çështje veterinerë;
- Autoriteti shtetëror administrativ përgjegjës për çështje fitosanitare.

Etiketimi dhe shënjimi – Ushqimi për njerëz apo kafshë duhet të etiketohet dhe shënjohej gjatë prodhimit dhe qarkullimit. Të dhënat në deklarata dhe shenja duhet të korrespondojnë me të dhënat e specifikuar në specifikimin e prodhuesit dhe kërkesat e paracaktuara në këtë ligj dhe rregulloret e lëshuara në bazë të këtij ligji.

Deklarata dhe shenja duhet të përmbajnë të dhëna që mundësojnë gjurmueshmërinë e ushqimit për njerëz dhe kafshë, materialeve të papërpunuara, materialeve dhe substanca që janë përfshirë në ushqim për njerëz apo kafshë, kafshët për prodhim të ushqimit dhe produktet përfundimtare, në të gjitha fazat e prodhimit dhe qarkullimit. Deklarata nuk duhet të përmbajë të dhëna që i japin karakteristika mjekësore ushqimit për njerëz apo kafshë.

Deklarata apo të dhënat e prezantuara në deklarata për ushqim për njerëz apo kafshë që plasohen në qarkullim duhet të jenë të shkruara në gjuhën zyrtare të Malit të Zi.

Kërkesat e detajuara për përmbajtjen, llojin e të dhënave dhe mënyrën e prezantimit në deklarata, si dhe mënyrën e etiketimit të ushqimit me origjinë bimë në nivelin primar të prodhimit, ushqimit me origjinë shtazore, ushqimin me përbërje të përzier për njerëz dhe kafshë duhet të paracaktohen në rregulloret të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, apo në rastin e ushqimit me origjinë bimë pas

prodhimit primar, ushqimit me përbërje të përzier dhe ushqimit tjetër në rregullore të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

Përpunimi i drurit

Mali i Zi ka filluar të implementojë Standardet Ndërkombëtare për Masat Fitosanitare Nr. 15 (ISPM 15) nga viti 2010. Përshkrimi i shenjës për materialin ambalazhues prej druri (MAD) është paracaktuar në "Librin e rregulloreve për Masat Fitosanitare për Materialin Ambalazhues nga Druri në Tregti Ndërkombëtar".²⁹ Shenja zyrtare duhet të përmbajë: IPPC – simbolin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtje të Bimëve; ME- ISO kodin e shtetit; numrin unik me tri shifra të caktuar nga Administrata Fitosanitare për subjektin tregtar, subjektin juridik apo ndërmarrësin e futur në Regjistër; shkurtësën e procedurës së aplikuar për trajtimin e materialit prej druri për ambalazhim (HT). Shenja së cilës i jemi referuar në paragrafin 1 të këtij neni ka formë drejtkëndëshi, duhet të jetë e lexueshme, e qëndrueshme-pandryshueshme dhe e pa-transferueshme, e vendosur në vend ku shihet, kur është e mundshme, në dy anë të kundërta dhe mund të jetë me ngjyrë të kuqe apo të portokalltë.

Materialet ndërtimore

Materialet ndërtimore në Mal të Zi drejtohen me Ligjin për Zhvillimin Hapësinor dhe për Ndërtimin e Strukturave. Objektivi i ligjit është rregullimi i ndërtimit të strukturave i cili duhet të krijojë kushtet që strukturat të ndërtohen në pajtueshmëri me ligjin dhe rregulloret tjera, standardet, normativat teknike dhe normat e cilësisë në fushën e ndërtimit të strukturave.

Sipas raportit të ekzaminimit të KE,³⁰ Mali i Zi ka për qëllim të harmonizojë legjislacionin e vet me Rregulloren për Produktet Ndërtimore (KE) Nr. 305/2011. Ministria për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Turizëm e Malit të Zi është ministria kompetente. Ministria ka përgatitur legjislacionin e nevojshëm për të harmonizuar sektorin me Rregulloren për Produktet Ndërtimore Nr. 305/2011.

Mali i Zi parasheh që legjislacioni implementues do të aprovohet një vit pas futjes në fuqi të këtij legjislacioni. Implementimi do të kryhet nga Administrata për Çështje Inspektuese, në bashkëpunim me organin koordinues për mbikëqyrje të tregut. Mali i Zi aktualisht nuk ka plane që të caktojë organe për vlerësim të përputhshmërisë për këtë fushë.

²⁹ Libri me rregulla mund të merret në linkun në vijim::

<https://www.ippc.int/countries/montenegro/isp15/implementation-isp15-montenegro>

³⁰Në dispozicion në linkun: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/montenegro/screening_reports/20131002_screening_report_montenegro_ch01.pdf

4.2.4. Serbia

4.2.4.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike

Serbia ka kaluar nëpër një periudhë të ndryshimeve dramatike gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit. Ndikimi i krizës financiare globale dhe një numër i zgjedhjeve të mbajtura i kanë ngadalësuar reformat strukturore të domosdoshme në vend. Sidoqoftë, trendet e fundit tregojnë lëvizje drejt një përgjegjësie më të madhe fiskale dhe riaranzhim për çështjet kritike si reformën e ndërmarrjeve në pronësi të shtetit, reformën e sektorit financiar dhe efikasitetin e sektorit publik.

Serbia ka filluar bisedimet për anëtarësim në BE në janar të vitit 2014, pas arritjes së progresit në reformat politike dhe ekonomike.

Serbia ka ndjekur këto reforma duke u përpjekur që të rimëkëmbet nga ndikimi i krizës financiare ndërkombëtare e cila çoi në ngritje të menjëhershme të varfërisë në 50% dhe ngritje të ngjashme të papunësinë në vend. Si në shumë vende, sfida në Serbi mbetet përkthimi i rimëkëmbjes së dobët ekonomike në vende pune dhe zvogëlim të varfërisë në mjedis të ngushtë fiskal. Si rezultat, Serbia duhet të bëhet më konkurruese dhe të rrisë produktivitetin.³¹

Sipas të dhënave nga Banka Botërore, rritja në Serbi për vitin 2013 ishte 2.6% dhe pritet të bie deri në vetëm 1% në vitin 2014, duke reflektuar ndikimin e masave fiskale, hyrje më të ulëta të investimeve si dhe situatën e brishtë në sektorët financiar vendorë dhe ndërkombëtarë. Norma më të fuqishme të ngritjes prej 2-3% parashihihen gjatë një periudhe afatmesme.

Eksportet kryesore të Serbisë janë makinat dhe produktet tjera në sektorin automobilistik. Eksportet automobilistike janë bërë sektori më i rëndësishëm pas investimeve të konsiderueshme të prodhuesit italian të automobilave, FIAT. Gati 90% e të gjitha eksporteve serbe shkojnë në Evropë – 55% në BE dhe rreth 33% në vendet anëtare të CEFTA-s. Eksportet e shërbimeve gjithashtu janë duke u rritur për ka rëndësia, duke arritur 10% të BPV-së në 2013.

Ekonomia varet nga prodhimtaria dhe eksportet, duke u shtyrë shumë nga investimet e jashtme. Pas vazhimit të anëtarësisë në FMN në dhjetor të vitit 2000, Serbia vazhdoi të riintegrohet në komunitetin ndërkombëtar duke iu ribashkuar Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD). Serbia ka bërë progres në liberalizimin e tregut dhe privatizim, por shumë ndërmarrje të mëdha – duke përfshirë kompanitë energjetike, telekomunikimet, gazin natyral, avio-kompaninë kombëtare, dhe të tjera – mbesin në duart e shtetit.


Serbia ka Marrëveshje për Tregti të Lirë me BE-në (sipas MSA-së), Federatën Ruse, Turqinë, vendet anëtare të EFTA, vendet anëtare të CEFTA, Bjellorusinë dhe Kazakistanin.

4.2.4.2. Marrëdhëniet me Kosovën

Shkëmbimet tregtare ndërmjet Serbisë dhe Kosovës janë vazhdimisht në rritje, posaçërisht pas vitit 2007 kur Kosova u bë anëtare e CEFTA-s. Nga të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s, Serbia është eksportuesi më i madh pas IRJM-së. Gjatë tri viteve të fundit, importet nga Serbia përbënin 36% të gjithë importit nga vendet e CEFTA-s apo 11% të gjitha importeve të Kosovës, duke arritur shumën totale prej afërsisht 820 milion euro mallra të importuara. Situata është ndryshe kur bëhet fjalë për eksportet nga Kosova. Gjatë periudhës së njëjtë, eksportet kosovare në tregjet serbe ishin në vlerën e përafërt prej 36 milion euro.

³¹Banka Botërore <http://www.worldbank.org/en/country/serbia/overview>

Figura 8. Shkëmbimi tregtar me Serbinë 2005-2013 (në '000 Euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Produktet kryesore të importuara nga Kosova përfshijnë: pijet, produktet për gatim pastash, gruri, mielli, materialet ndërtimore, etj. Në anën tjetër, eksportet kosovare kryesisht përfshijnë materialet ndërtimore (vetëm çimento) dhe skrap metalesh.

Vlen të ceket që në vitin 2012, krahasuar me 2011, eksportet nga Kosova për në Serbi u dyfishuan (nga 7 milion euro në 14 milion euro). Vlera e mallrave të eksportuara u rrit pak në vitin 2013. Për shkak të afërsisë gjeografike si dhe marrëveshjes ekzistuese për tregti të lirë, shkëmbimet tregtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë priten të përparojnë edhe më tutje.

4.2.4.3. Pasqyrë e tregut

Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Industria e përpunimit të ushqimit është zhvilluar dhe ka treguar rritje të fuqishme gjatë viteve të tranzicionit. Një trend në industrinë e ushqimit është zgjerimi i konglomerateve, të cilat janë aktive në shumë sektorë. Ushqimi i prodhuar në Serbi është prezent në mbarë botën.³²

Nga 1 janari 2014, sipas MSA-së, tarifat për shumicën e importeve të produkteve bujqësore dhe ushqimore nga BE-ja në tregun serb ishin reduktuar nga përafërsisht 23% deri në 0%. Vetëm disa produkte strategjike bujqësore dhe ushqimore do të vazhdojnë të kenë taksë doganore (me vlerë mesatare përafërsisht 3.2%).

Bujqësia është ende një prej industrive më të rëndësishme në ekonominë e Serbisë. Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë e Serbisë, kjo industri punëson 10% të mbarë fuqisë punëtore dhe përbën 21% të BPV-së së Serbisë. Përveç kësaj, produktet bujqësore përbëjnë 26% të të gjithë eksportit të Serbisë. Nga 5.2 milion hektar të tokës bujqësore, 85% është në pronësi private dhe 15% i përket kooperativave bujqësore apo qeverisë. Sipas qeverisë së Serbisë, 83% të tokës bujqësore është tokë e punueshme.

Rendimentet e të korrurave paraqesin 57% të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, ndërsa kultivimi i gjedheve paraqet 33%. Vreshtat dhe pemishtet paraqesin 5% dhe 4%, respektivisht, të prodhimit të përgjithshëm bujqësor.

³²Zhvillimi Agro-Industrial i Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore – Përmbledhje për shtetin – Serbia, FAO, 2012

Afërsisht 60% të produkteve të korra përbëhen nga drithërat dhe vetëm 18% nga perimet. Gruri është drithi më i rëndësishëm me rendiment që sillet ndërmjet 2 dhe 2.5 milion ton për vit, dhe zonë kultivimi prej më shumë se 650,000 hektarëve tokë me rendiment mesatar prej 3.5 ton/hektarë. Misri është drithi i dytë më i kultivuar me afërsisht 2 milion ton në vit dhe rendiment prej 4.5 ton/hektar. Panxhar sheqeri me një prodhimtari prej 35 ton/hektar është një e mbjellë tjetër e rëndësishme. Zonat për kultivimin e lulediellit shtrihen në mbi 170,000 hektarë tokë, me rendiment prej 300,000 ton/vit dhe 1.7 ton/hektar.

Rendimente të konsiderueshme vijnë gjithashtu nga sektori i frutave, posaçërisht mollët dhe kumbullat, edhe pse kohëve të fundit ka pasur rënie edhe në konsumin vendor edhe në eksporte. Vreshtaria është e shpërndarë në të gjithë vendin me një prodhim mesatar prej 380,000 ton rrush për tavolinë dhe rrush për verë. Kultivimi i fasules mbulon një sipërfaqe prej 50,000 hektarë tokë, me rendiment 1.1 ton/hektar me prodhim total prej 60,000 ton për vit. Kultivimi i patates mbulon një zonë prej përafërsisht 100,000 hektarë me prodhim prej 800,000 ton/vit.

Eksporti i produkteve bujqësore dominohet nga frutat, drithërat, pijet me sheqer, produktet nga pemët dhe perimet, produktet nga drithërat, produkte të ndryshme frutore dhe perime.

Përpunimi i drurit

Pylltaria dhe industria e përpunimit të drurit tradicionalisht përbëjnë pjesë të rëndësishme në ekonominë e Serbisë. Serbia ka një zonë të tërë me pyje prej 2.25 milion hektarë apo 29% e gjithë territorit, që e rendit Serbinë si tokë mesatarisht pyjore. Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve është 363 milion m³, ndërsa rritja vjetore është 9 milion m³. Bazuar në pronësi, 53% e pyjeve është në pronë të shtetit, ndërsa pjesa tjetër është në pronësi private.

Sipas Odës Ekonomike dhe Industriale të Serbisë, më shumë se 2,000 kompani janë aktualisht të angazhuara në këtë industri, duke punësuar më shumë se 20 mijë punëtorë.

Industria e përpunimit të drurit është e orientuar kah eksporti dhe vazhdimisht regjistron teprica në tregtinë e jashtme. Eksportet totale në vitin 2012 ishin përafërsisht në vlerën prej 348 milion euro, ndërsa importi arriti vlerën 273 milion euro. Produktet e fazës primare të përpunimit paraqesin 50% të eksporteve dhe mobilitet 50%.

Materialet ndërtimore

Tregu në zhvillim i patundshmërive, së bashku me marrëveshjet e tregtisë së lirë, kryesisht me Federatën Ruse, ka shtyrë zhvillimin dinamik të industrisë vendore të ndërtimit. Mundësia e eksportit të materialeve ndërtimore nga Serbia në tregun rus pa taksa doganore, e bën shtetin atraktiv për shumë investitorë të huaj. Kjo mundësi tashmë është pranuar nga kompanitë prijëse shumëkombëshe ndërtuese dhe prodhuesit të cilët i kanë hapur fabrikat e tyre në Serbi për të eksportuar në unionin doganor të Rusisë, Bjellorusisë dhe Kazakistanit. Gjatë dekadës së fundit, më shumë se 25 kompani globale kanë investuar përafërsisht 900 milion euro në industrinë serbe të ndërtimit, duke zvogëluar konsiderueshëm nivelin e papunësisë. Austria është origjina e më shumë se 40% të këtyre investimeve, e pasuar nga Gjermania, Franca dhe Greqia. Meqenëse industria e ndërtimitarisë ishte ndikuar negativisht nga kriza botërore, në vitin 2010, Qeveria e Serbisë përgatiti disa stimulime për investime në mënyrë që të kontribuojë në rimëkëmbjen e sektorit. Si rezultat i kësaj, industria e ndërtimit në Serbi në vitin 2011 regjistroi rritje prej 17%.

4.2.4.4. Procedurat e përgjithshme të importit

Mallrat jo-vendore mund të importohen në territorin doganor të Serbisë përmes pikave kufitare në kohën kur ato janë të hapura për qarkullim.

Qarkullimi i mallrave të cilat janë subjekt i kontrolleve fitosanitare, veterinare apo kontrolle tjera të paracaktuara lejohet vetëm nëpërmjet kalimeve kufitare, të cilat në pajtueshmëri me rregullat e duhura, janë të destinuara për hyrje dhe dalje të mallrave të tilla.³³

Mallrat e sjella përmes importit në territorin doganor të Serbisë janë, nga momenti i hyrjes së tyre, subjekt i mbikëqyrjes doganore dhe mund të jenë subjekt i kontrolleve doganore nga Autoriteti Doganor.

Mallrat duhet të mbesin nën mbikëqyrje doganore për sa kohë që është e nevojshme për të përcaktuar statusin e tyre doganor.

Në transportin rrugor, mallrat paraqiten tek autoritetet doganore kufitare menjëherë pasi të jenë futur në territorin doganor. Personi që është duke i sjellë mallrat në territorin doganor të Serbisë, apo personi përgjegjës për bartjen e mallrave, kërkohet që të deklarojë mallrat dhe t'i bartë ato përmes rrugës së specifikuar nga Autoritetet Doganore dhe në pajtueshmëri me udhëzimet e saj tek:

- Zyra doganore apo cilido vend tjetër e aprovuar nga Autoriteti Doganor; apo
- Zona e lirë, nëse mallrat duhet të sillen drejtpërdrejt në zonë të lirë: përmes ujit apo ajrit, apo përmes tokës pa kaluar nëpër ndonjë tjetër pjesë të territorit doganor ku zona e lirë prek tokën kufitare ndërmjet Serbisë dhe vendit të tretë.

Të gjitha mallrat e destinuara të hyjnë në procedurë doganore duhet të jenë të mbuluara me deklaratë për atë procedurë doganore. Mallrat vendore të deklaruara për procedurë eksporti, përpunim të jashtëm, transit apo magazinim doganor duhet të jenë subjekt i mbikëqyrjes doganore nga momenti i pranimit të deklarates deri në momentin e largimit nga territori doganor, apo shkatërrimit, apo deklarata shfuqizohet.

Deklarata duhet të bëhet:

- Me shkrim;
- Në mënyrë elektronike, nëse është teknikisht e mundshme dhe nëse është subjekt i autorizimit nga Drejtori i Administratës Doganore; apo
- Fizikisht apo përmes ndonjë veprimi tjetër ku bartësi i mallrave shprehë dëshirën e tij për të vendosur mallrat në procedurë doganore, kur mundësia e tillë ofrohet sipas rregullores në fuqi.

Deklaratat doganore me shkrim duhen bërë përmes formularit që i korrespondon ekzemplarit zyrtar të caktuar për atë qëllim, d.m.th. në një dokument të vetëm administrativ i cili parashtrohet nga deklaruesi.³⁴

4.2.4.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës

Serbia zyrtarisht i ka pezulluar të gjitha barrierat për import dhe eksport. Megjithatë, disa taksa ende aplikohen. Barrierat jo-tarifore në formë të kuotave të importit janë caktuar me qëllim të mbrojtjes së industrive vendore. Qeveria ka miratuar Rregulloren për Harmonizim të Nomenklaturës Tarifore Doganore për 2014. Tarifat doganore aplikohen në këtë nomenklaturë dhe janë të harmonizuara me

³³ Administrata Doganore e Serbisë, 2014. Uebfaqja e Administratës Doganore.
<http://www.upravacarina.rs/en/BusinessCommunity/CustomsProcedures/Pages/default.aspx> [E qasur më 31 gusht 2014]

³⁴ Deklarues doganor është cilido person që bën deklaram doganor ose në emër të vetin ose në emër të një personi tjetër

nomenklaturën e BE-së. Taksat doganore sillen prej 1% deri në 30%, varësisht prej mallrave si dhe origjinës së tyre për shkak të marrëveshjeve ekzistuese tregtare. Lista e plotë e mallrave dhjetë shifrore dhe taksa doganore përkatëse janë publikuar në uebfaqen e Administratës Doganore të Serbisë.³⁵

Serbia është më mbrojtëse e mallrave të veta bujqësore sesa atyre jo-bujqësore. Origjina e mallrave është një prej instrumenteve doganore që ndikojnë në trajtimin doganor të mallrave të importuara. Origjina preferenciale sjell trajtimin preferencial të mallrave që importohen, e cila rezulton në reduktim apo eliminim të taksave doganore të importit.

Dëshmitë e origjinës

Sipas rregullave të origjinës që aplikohen në Serbi, në mënyrë që të përfitohet nga normat preferenciale të taksës doganore, për origjinën e produkteve duhet poseduar cilëndo nga të mëposhtmet:

- Certifikatën e qarkullimit "EUR1" – të lëshuar nga Autoriteti Doganor Serb. Eksportuesi i cili aplikon për certifikatë duhet të jetë i përgatitur për të dorëzuar dokumentet që dëshmojnë statusin e origjinës së produktit në fjalë;
- Deklaratë Faturë nga eksportuesi.

4.2.4.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore

Standardet

Instituti për Standardizim i Serbisë njihet nga Ligji për Standardizim si i vetmi organ nacional për standarde në Serbi. Ky institut është përgjegjës për zhvillimin dhe miratimin e standardeve (të cilat konsiderohen vullnetare sipas ligjit). Disa standarde me aplikim të detyrueshëm që janë miratuar para vitit 1996 janë bërë vullnetarë në vitin 2009 apo janë konvertuar në rastet kur ka qenë e përshtatshme, në rregullore teknike. Ekziston korniza specifike legjislative për standardizim vullnetarë dhe ajo është plotësisht funksionale.

Certifikimi i produktit

Në Serbi, produkti mund të plasohet në treg vetëm nëse:

- Përputhet me kërkesat teknike të paracaktuara,
- Përputhshmëria është vlerësuar sipas procedurës së paracaktuar;
- Është shënjuar në pajtueshmëri me rregulloret; dhe
- Është i shoqëruar me dokumentet e paracaktuara të përputhshmërisë dhe dokumentacionin tjetër të paracaktuar.

Etiketimi

Libri me rregulla "Deklarimi dhe Etiketimi i Ushqimit të Ambalazhuar" rregullon kërkesat për etiketim për ushqim të ambalazhuar të destinuar për konsumatorin apo për ushqim publik për konsum në Serbi. Sipas kësaj rregulloreje, etiketa duhet të jetë e pranishme si në ushqimin e ambalazhuar për shitje me pakicë dhe atë me shumicë dhe duhet të paraqesë të dhënat në vijim: afatin e përdorimit, llojin dhe përmbajtjen e shtesave të ushqimit, llojin dhe përmbajtjen e vitaminave, mineraleve dhe përmbajtjeve tjera të shtuara për të pasuruar vlerat ushqyese të produktit. Për të gjithë artikujt ushqimore kërkohet që të kenë etiketën në gjuhën serbe.

³⁵[http://www.carina.rs/en/Zakoni%20engleski/Regulation%20CT2014%20107%20119%202013%20%2064%2073%202014%20\(2\).pdf](http://www.carina.rs/en/Zakoni%20engleski/Regulation%20CT2014%20107%20119%202013%20%2064%2073%202014%20(2).pdf)

Rregullat mjedisore

Ligji për “Mbrotjen e mjedisit” përcakton kërkesat për import e eksport për të gjitha mallrat dhe/ose materialet e importuara të cilat mund të shkaktojnë rrezik për shëndetin njerëzor dhe mjedisin në përgjithësi.

Serbia ka miratuar Ligjin për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht (OMG) i cili kufizon prodhimin, importet dhe rritjen komerciale të drithërave OMG në Serbi. Ligji rregullon vetëm kushtet bazike për përdorimin e OMG-ve në sisteme të mbyllura dhe lirim të qëllimshëm në mjedis.

4.2.4.7. Kërkesat e sektorit

Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Rregullorja për siguri të ushqimit – Ligji për Siguri të Ushqimit është një prej ligjeve kryesore për bujqësinë në Serbi. Ai drejton të gjitha aspektet e prodhimit, qarkullimit, kontrollit dhe konsumit të ushqimit, kushtet e përgjithshme për të siguruar siguri të ushqimit për njerëz dhe kafshë, të drejtat dhe përgjegjësitë e personave që merren me biznes të ushqimit për njerëz e kafshë, sistemin e lajmërimit të hershëm, higjienën dhe cilësinë e ushqimit. Qëllimi i ligjit është të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së jetës së njerëzve e shëndetit të konsumatorëve dhe interesave të tyre duke siguruar funksionim efikas të tregtisë së ushqimit.

Kontrolli i cilësisë – Ministria e Bujqësisë inspekton cilësinë e ushqimit deri në momentin kur ushqimi shpërndahet në dyqane me pakicë. Kontrollat vizuale të produkteve (gati gjithçka që konsiderohet të jetë ushqim) dhe kontrollat shtesë për siguri bëhen duke përdorur testimin laboratorik të përbërësve bazik. Kontrollimet vizuale përfshijnë identifikimin e produktit (origjinën, llojin, sasinë), për të gjetur se a janë përmbushur kërkesat për etiketim dhe ambalazhim, dhe kontrollimin për deklaratat e domosdoshme që përmbajnë emrin dhe adresën e importuesit, dukjen e përgjithshme të produktit, shijen, praninë e mbetjeve, ngjyrën, strukturën, kontrollimin se a janë përmbushur kërkesat për transportimin. Kontrollimi i cilësisë së produkteve të importuara mund të bëhet pas përfundimit të procedurës së importit dhe para shpërndarjes së mallrave në treg. Inspektimi mund të bëhet edhe pas shpërndarjes së mallrave në dyqane për shitje me pakicë.

Përpunimi i drurit

Serbia vepron në pajtueshmëri me ISPM15 për importimin e materialit ambalazhues prej druri. ISPM15 është Standardi Ndërkombëtar për Masa Fitosanitare, publikimi numër 15 – Rregullorja për materialin ambalazhues prej druri (MAD) në tregtinë ndërkombëtare.

Ky standard shpjegon masat fitosanitare që zvogëlojnë rrezikun e shfaqjes dhe përhapjes së dëmtuesve karantin që lidhen me qarkullimin në tregtinë ndërkombëtare të materialit ambalazhues prej druri të prodhuar nga druri i papërpunuar. Materiali ambalazhues prej druri që mbulohet nga ky standard përfshinë pjesët nga druri për mbështetje të kargos, por përjashton ambalazhin nga druri të prodhuar nga druri i përpunuar në atë mënyrë që nuk përmban dëmtues.

Materialet ndërtimore

Libri me Rregulla për “Kontrollin e radioaktivitetit të mallrave gjatë importit, eksportit dhe kalimit transit” rregullon metodat dhe procedurat për kontrollin e radioaktivitetit gjatë importit, eksportit dhe kalimit transit të materialeve ndërtimore në Serbi. Për materialet ndërtimore kërkohen matjet e nivelit të dozës.³⁶ Sipas nenit 10 të Librit me rregulla të sipërpërmendur, për materialet ndërtimore kërkohet gjithashtu identifikimi i radionuklidëve duke përdorur spektro-metrinë gama.

³⁶Shkalla e dozës është doza e absorbuar në njësi kohe dhe tregon sasinë e dozës radioaktive.

4.2.5. Bosnja dhe Hercegovina

4.2.5.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike

Bosnja dhe Hercegovina tash është shtet kandidat potencial për BE që po lëvizë drejt harmonizimit me kriteret *acquis* të BE-së. Ndërmjet viteve 1998 dhe 2008, vendi ka përjetuar zhvillim të fuqishëm, ku BPV-ja është rritur për dy të tretat në terma real ndërsa varfëria ka rënë prej afro 20% në rreth 14%.³⁷ Reforma bankare është përshpejtuar në vitin 2011 pasi që të gjitha zyrat për pagesa të epokës komuniste ishin mbyllur; aktualisht bankat e huaja, kryesisht nga Evropa perëndimore, e kontrollojnë shumicën e sektorit bankar.

Pavarësisht kësaj performance të fuqishme ekonomike, shfaqja e krizës financiare globale në fundin e vitit 2008 është duke përcjellë një ndikim negativ të vazhdueshëm në ekonominë e vendit. Ekonomia u rimëkëmb në vitin 2011 – duke u rritur për 1% pas recesionit të thellë të vitit 2009 që shkaktoi tkurrjen e BPV-së për 2.9% - para kthimit në recesion në vitin 2012.

Forcimi i financave publike, përmirësimi i ambientit të biznesit në vend dhe avancimi i reformës në institucione dhe tregun e punës janë disa nga fushat ku Bosnja dhe Hercegovina do të mund të bënte progres të dukshëm në nxitjen e krijimit të vendeve të punës dhe zhvillimit afat mesëm.

Gjatë katër viteve të fundit, Bosnja dhe Hercegovina ka qenë një “vend i përzier” – duke shfrytëzuar burime nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) si edhe nga Fondi Global për Ambientin.

Konvertibilna Marka – monedha kombëtare e futur në vitin 1998 – është e lidhur financiarisht me euron, dhe besimi në monedhën dhe sektorin bankar është rritur. Sektori privat i Bosnjës dhe Hercegovinës është duke u zhvilluar ndërsa investimet e huaja ngadalë po rriten, mirëpo shpenzimet e qeverisë mbesin të larta për shkak të zyrave të tepërta qeveritare në nivelin shtetëror, të subjektit dhe atë komunal.

Procesi i privatizimit ka qenë i ngadaltë, posaçërisht në Federatën ku ndarja politike në mes të partive politike të bazuara sipas përkatësisë etnike e bënë arritjen e marrëveshje për politikat ekonomike më të vështirë. Deficiti aktual tregtar dhe shkalla e lartë e papunësisë mbeten dy prej problemeve më serioze makroekonomike. Bosnja dhe Hercegovina u bë anëtar i plotë i CEFTA-s në shtator të vitit 2007. Nevojitet progres i konsiderueshëm në implementimin e reformave strukturore në rast se vendi dëshiron të arrijë zhvillim më të shpejtë ekonomik se sa është parashikuar aktualisht.


4.2.5.2. Marrëdhëniet me Kosovën

Shkëmbimet tregtare në mes të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kosovës janë duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme. Eksportet e Kosovës drejt tregut boshnjak u dyfishuan në vitin 2013 krahasuar më një vit më parë. Në vitin 2013, eksportet e Kosovës në Bosnjë dhe Hercegovinë arritën vlerën 2.8 milion euro, në krahasim me vlerën prej 83.5 milion euro të importeve (shih Figurën 9).

³⁷ Banka Botërore, 2014. Uebfaqja e Bankës Botërore

<http://www.worldbank.org/en/country/bosniaandherzegovina/overview> [qasur më 3 shtator 2014]

Figura 9. Shkëmbimi tregtar me Bosnjën dhe Hercegovinën 2005-2013 (në '000 Euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Mallrat kryesore kosovare të eksportuara në tregun boshnjak përfshijnë gomën dhe pijet. Në anën tjetër, Kosova importon nga Bosnja dhe Hercegovina kryesisht mish, qumësht dhe prodhime tjera të bulmetit, bitum naftë, medikamente, etj.

4.2.5.3. Pasqyrë e tregut

Përpunimi i ushqimit

Industria e ushqimit është sektor me rëndësi për ekonominë e Bosnjës dhe Hercegovinës, si për të siguruar ushqimin për vendin ashtu edhe për parandalimin e rritjes së mëtejme të deficitit tregtar. Industria e përpunimit të ushqimit ka shfrytëzuar vetëm 10% të kapacitetit të vet. Aktualisht industria e përpunimit të ushqimit në këtë vend ngërthen kompanitë e angazhuara në prodhim dhe përpunim të ushqimit dhe pijeve për konsum njerëzor, duke përfshirë mishin, qumështin, pemët, perimet, sheqerin, vajin dhe duhanin, si dhe ushqimet e përgatitura për kafshë dhe shpezë. Të gjitha kapacitetet prodhuese të përmendura më parë janë ende të kufizuara dhe nuk mund t'i përmbushin madje as nevojat e konsumit vendor. Për këtë arsye ka ende hapësirë për zhvillim të mëtejshëm dhe zgjerim të nën-sektorëve për përpunimin e ushqimit, marrë parasysh shtimin dhe zhvillimin e prodhimit primar.

Industria e ushqimit dhe pijeve në Bosnjë dhe Hercegovinë përbën pjesën më të madhe të ekonomisë, 2.7 % të BPV-së. Në vitin 2009 industria e ushqimit dhe pijeve gjeneroi 21 milion euro ose rreth 23.6 % vlerës së përgjithshme të shtuar nga industritë prodhuese, me rritje vjetore prej 13.2 %. Industria e ushqimit dhe pijeve punëson pothuajse 15,000 njerëz (ose përafërsisht 16 % të forcës së përgjithshme punëtore nga industria e prodhimit). Prej vitit 2006 punësimi në këtë sektor është rritur me një mesatare vjetore prej 1.7 %. Aktualisht ekzistojnë rreth 1,200 ndërmarrje të cilat operojnë në industrinë e ushqimit dhe pijeve (ose rreth 6 % të të gjitha ndërmarrjeve prodhuese), shumica e të cilave janë ndërmarrje private të mesme ose të vogla.

Bujqësia

Struktura ekzistuese e bujqësisë në Bosnjë dhe Hercegovinë karakterizohet me ferma të madhësisë së vogël, ndërsa privatizimi i kompanive të mëdha shtetërore konsiderohet si një mundësi për zhvillimin

e mëtutjeshëm të bujqësisë. Dominojnë fushat që janë të mbuluara përherë me barë, që përbëjnë mbi 50% të të gjithë tokës bujqësore të vendit, toka e punueshme zë përafërsisht 45% dhe të lashtat e përhershme përafërsisht 5 %.³⁸

Burimet e dobëta financiare që nevojiten për modernizimin e të gjitha segmenteve të prodhimit bujqësor (zëvendësimi i teknologjive dhe pajisjeve të vjetra; avancimi i strukturës ekzistuese të sektorit të bujqësisë, etj.) paraqesin njërin prej kufizimeve kryesore për zhvillim më të hovshëm të këtij sektori. Bosnja dhe Hercegovina ka traditë të gjatë në grumbullimin e barishteve mjekësore dhe aromatike dhe bletaria përbën rreth 1 % të prodhimit të përgjithshëm bujqësor. Pjesëmarrja e rritjes së bagëtive në prodhimin e përgjithshëm bujqësor llogaritet të jetë 50 %. Rritja e peshkut tashmë është e zhvilluar, posaçërisht trofta dhe krapit. Llojet më të rëndësishme të peshkut në akuakulturën e Bosnjës dhe Hercegovinës janë: salmoni, cyprinidi, llojet detare dhe molusqet.

Përpunimi i drurit

Pyjet e Bosnjës dhe Hercegovinës ofrojnë bazë burimesh të besueshme (vëllim, lloje, cilësi) të ndërlidhura me furnizim të industrisë për përpunim të drurit me lëndë të parë të cilësisë shumë të lartë (ah, lis, frashër, pishë, bredh, si dhe dru arë, mollë, qershi, etj.). Veçanërisht “ahu boshnjak” është i famshëm në tërë botën për shkak të cilësisë së lartë. Pothuajse 80 % e pyjeve të vendit janë pronë shtetërore. Sipas Agjencisë për Promovimin e Investimeve të Huaja të Bosnjës dhe Hercegovinës, industria e drurit të Bosnjës dhe Hercegovinës është shumë e njohur për cilësinë e prodhimeve vijuese:

- Të gjitha llojet e orendive (drurit të butë dhe drurit të fortë, paneleve të drurit, drurit solid, shtretërve, dyshekëve, jastëkëve, etj.);
- Konstruksionet e drurit, zdrukthëtaria dhe prodhimet e mobilierisë (prodhues dritarësh, dyersh dhe dollapësh);
- Prodhime nga inxhinieria (trupa veglash, dorëza);
- Shtëpi të parafabrikuara;
- Panele parketi;
- Kompensata, rimeso, iverplaka, drunj të prerë, panele druri të prera sipas dimensioneve dhe kërkesave;
- Kontejnerë druri, ambalazhim dhe kuti nga druri;
- Paleta, dërrasa për ngarkim, trupa të veglave dhe dorëza;
- Prodhime dekorative dhe zbukurime.

Prodhimet që eksportohen më së shumti janë ulëset dhe pjesët e drurit, mobilie për dhoma të ditës, dhoma të fjetjes dhe orendi tjera të drurit. Prodhimet pyjore (kryesisht lëndë druri) në përgjithësi eksportohen në: Itali, Slloveni, Serbi, Kroaci, Austri, Gjermani dhe Egjipt.

Materialet ndërtimore

Bosnja dhe Hercegovina është e pasur me burime natyrore siç janë pyjet, guri, zhavorri, rëra, argjila dhe metalet xeherore. Kjo ofron mbështetje adekuate për një mori prodhuesish të materialit ndërtimor që gjenden përreth qendrave të populluara. Aktualisht shumica e materialeve për ndërtim gjenden pa vështirësi në vend.

Gurëthyesit dhe minierat janë burimi parësor i aktiviteteve për shumicën e industrisë së materialit ndërtimor. Rezervat e rërës, zhavorrit dhe argjilës ofrojnë materiale të gatshme për përdorim, derisa gurëthyesit ofrojnë gurë, gips dhe gëlqere. Industria e minierave ofron boksit për prodhimin e aluminit dhe xehe hekuri për prodhime hekuri apo çeliku.

³⁸ Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara, “Zhvillimi i Agro-industrisë në Evropën lindore dhe Azinë qendrore shkurt – Bosnja dhe Hercegovina”.

Prodhuesit e çimentos në Bosnjë dhe Hercegovinë varen nga sektori i gurëthyesve. Aktualisht tregu i tyre është industria lokale ku nuk kanë konkurrencë prej importit, pasi që transporti i çimentos nga jashtë është shumë i shtrenjtë. Edhe pse kërkesa vendore pritet të rritet më rritjen e ndërtimeve, prodhuesit vendor synojnë shtrirjen e tregut të çimentos në shtetet fqinje.

Plastika – Në Bosnjë dhe Hercegovinë prodhohen panelet izoluese të stiroporit që kryesisht eksportohen në Serbi.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë prodhohen edhe kulme nga bitumi rezistente ndaj ujit dhe materiale izoluese kundër lagështisë dhe shtresa për dysheme nga polietileni.

4.2.5.4. Procedurat e përgjithshme të importit

Regjimi doganor

Dokumenti i unifikuar doganor është formular standard doganor për aplikim që përdoret për procedura të importit dhe eksportit. Dogana i pranon vetëm formularët të shtypur në letër, versionet e shkarkuara nuk mund të përdoren për paraqitjen e hyrjes.

Ligji për Doganat parasheh që mallrat që eksportohen në Bosnjë dhe Hercegovinë të jenë të përcjella me:

- Deklaratën doganore;
- Faturën komerciale;
- Certifikatën e origjinës;
- Faturën e transportit ajror ose faturën e aterimit; dhe
- Çfarëdo certifikate që nevojitet për kontroll të cilësisë.

Vlerësimi doganor

Vlerësimi doganor bazohet në vlerën e transaksionit të çmimit që është paguar ose që duhet të paguhet për mallrat që shiten si eksport në Bosnjë dhe Hercegovinë. Sistemi i vlerësimit doganor në kuadër të Ligjit për Politika Doganore është plotësisht në përputhje me rregullat e OBT-së.

Hyrja e përkohshme

Prodhimet mund të eksportohen në Bosnjë dhe Hercegovinë edhe përkohësisht. Rregullat për import të përkohshëm janë përcaktuar në Ligjin për Politika Doganore të këtij vendi. Mallrat që hyjnë në Bosnjë dhe Hercegovinë sipas këtij regjimi mund të lirohen plotësisht ose pjesërisht nga taksa doganore dhe nuk duhet të kenë ndonjë ndryshim përveç të humbjes nominale të vlerës për shkak të përdorimit. Periudha maksimale për hyrje të përkohshme është 12 muaj. Bosnja dhe Hercegovina gjithashtu ka nënshkruar Konventën ATA Karnet lidhur me lejimin e përkohshëm të eksportimit të mallrave.³⁹

Eksportet e përkohshme mund të (i) jenë të liruara plotësisht apo pjesërisht nga taksat doganore; (ii) të mos kryejnë ndonjë ndryshim; dhe (iii) hyjnë në vend vetëm për një periudhë maksimale prej 12 muajsh.

Zonat e tregtisë së lirë

Bosnja dhe Hercegovina aktualisht ka tetë zona të lira tregtare: Sarajeva, Vogosca, Visoko, Herzegovina

³⁹ Hyrja e përkohshme (ATA) karnet është një dokument njohur ndërkombëtarisht për importim të përkohshëm të mallrave të ligjshme.

Mostar, Lukavaci, Mostari Jugoistok, Kiseljaki dhe Orasje.

4.2.5.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës

Taksat doganore për të gjithë artikujt e importuar nëpër territorin doganor të Bosnjës dhe Hercegovinës paguhet sipas metodës së voreme sipas shkallës prej 0, 5, 10 dhe 15%. Norma tarifore arrin mesataren prej 5.1%. Këto norma aplikohen për të gjithë mallrat që kanë origjinë prej shteteve që kanë lidhur marrëveshje me Bosnjën dhe Hercegovinën përmes klauzolës Shteti më i favorizuar ose prej atyre shteteve që aplikojnë të njëjtën klauzolë për artikujt që kanë origjinë nga Bosnja dhe Hercegovina. Taksat doganore varen prej mallit që eksportohet. Taksa vlerësohet në CIF-in e mallit. Tarifat përcaktohen në pajtim me rregulloret e OBT-së, edhe pse Bosnja dhe Hercegovina e mban vetëm statusin e vëzhguesit brenda OBT-së. Përfshirje prej taksës doganore bëjnë mallrat që shfrytëzohen për qëllime komerciale / promovuese, përfshirë mallrat që përdoren dhe/ose konsumohen në panairët tregtare duke përfshirë mostrat, materialet e shtypura (broshurat, katalogët, listat e çmimeve, fotografitë, videot, etj.), pajisjet, makinat dhe prodhimet tjera që ekspozohen në panairët tregtare, si dhe njësi të ndryshme që nuk kanë ndonjë vlerë të ndryshme komerciale. Bosnja dhe Hercegovina e pranon ATA Karnetën për mostra komerciale, ekspozita dhe panairë dhe pajisje profesionale.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar ngarkohet sipas normës fikse prej 17% për të gjitha mallrat dhe shërbimet e importuara. Akciza aplikohet për derivatet e naftës, duhanin, pijet përfshirë birrën, verën dhe kafën. Gjithashtu aplikohet edhe vlera prej 1% vlerës doganore të mallrave të importuara për të mbuluar mbajtjen e regjistrit.

Certifikatat e origjinës në përgjithësi nuk kërkojnë përderisa origjina e shtetit është shënuar në faturën komerciale. Zakonisht duhet të përdoret Certifikata për Lëvizje EUR1 për të mbështetur kërkesat për norma të taksave preferenciale.

4.2.5.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore

Standardet dhe kontrolli i cilësisë

Ligji mbi politikën e tregtisë së jashtme (Neni 7) parasheh që mallrat e importuara të jenë në pajtim me standardet dhe normat teknike dhe të cilësisë të përshkruara apo njohura si parakushte për futjen e tyre në qarkullim ose shfrytëzim në Bosnjë dhe Hercegovinë. Standardet ndërkombëtare dhe evropiane zakonisht adoptohen. Standardet evropiane zakonisht preferohen e posaçërisht Standardet e harmonizuara.⁴⁰ Instituti për standardizim, metrologji dhe pronë intelektuale është organi kryesor për vlerësimin e konformitetit në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ka edhe organizata tjera testuese në vend dhe lista e këtyre organizatave mund të merret në Institut.

Kriteret e etiketimit

Etiketat duhet të përmbajnë informatat vijuese: emrin e produktit, adresën e plotë të importuesit dhe vendit të origjinës, sasinë/peshën/vëllimin neto, përbërësit, mënyrën e ruajtjes (transporti, përdorimi ose mirëmbajtja) dhe vërejtjet përkatëse për konsumatorin. Produktet që janë komplekse nga ana teknike duhet të përcillen me udhëzimet e përdorimit, specifikacionet e prodhuesit, listën e personave/bizneseve të autorizuar për mirëmbajtje, informata për garancinë, periudha sa zgjatë garancia si dhe të dhënat tjera të aplikueshme. Të gjitha informatat duhet të përkthehen në gjuhët e vendit dhe duhet t'i ngjiten (të bashkëngjiten) produktit para se ai të plasohet në treg.

⁴⁰ Standardet e harmonizuara të BE-së gjenden në http://ec.europa.eu/enterprise/policies/european-standards/harmonised-standards/index_en.htm

Certifikimi i produktit

Certifikimi i produktit nevojitet me qëllim që të sigurohet se produkti i ka kryer të gjitha testet e duhura dhe se është konform me rregulloret përkatëse.

Rregullat mjedisore

Bosnja dhe Hercegovina e aplikon Konventën e Bazelit sa i përket Kontrollit të lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe hedhjes së tyre.⁴¹ Në pajtim me obligimet që dalin nga marrëveshjet tregtare ndërkombëtare, Këshilli i Ministrave mund të ndalojë importin, eksportin apo transitin e mallrave të caktuara përmes Bosnjës dhe Hercegovinës ose të përcaktojë kushte për import, eksport apo transport të mallrave të tilla me qëllim të parandalimit të rrezikut për jetët e njerëzve, shëndetit dhe ambientit.

4.2.5.7. Kërkesat e sektorit

Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Bosnja dhe Hercegovina kërkon certifikata të ndryshme për prodhimet e importuara ushqimore të cilat duhet të nënshkruhen nga autoritetet e përcaktuara. Megjithatë, nuk ekzistojnë formate specifike që duhet të shfrytëzohen nga eksportuesit, përveç certifikatave fitosanitare që duhet të jenë në përputhshmëri me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e bimëve (IPPC).

Disa certifikata të veterinarisë kërkojnë deklarata specifike p.sh. sëmundjet ngjyeshme, përdorimi i hormoneve, metodat për zvogëlimin e patogjenëve, etj. të përcaktuara nga Zyra Shtetërore e Veterinarisë (ZShV). ZShV-ja është përgjegjëse për verifikimin e kriterëve specifike për importimin e kafshëve të gjalla dhe prodhime të caktuara me origjinë të kafshëve.

Disa prej certifikatave që nevojiten për eksportimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore janë:

Certifikata shëndetësore/dëshmi e atesteve sanitare me shumicë që siguron se produkti është i sigurt për konsum nga ana e njeriut. Autoritetet që i kërkojnë ato janë Inspektorati Federal dhe Inspektorati i Republikës Serbe ose Departamenteve përkatëse për inspektimin sanitar dhe të ushqimit.

Certifikata/dëshmi e atesteve të cilësisë që vlerësojnë cilësinë e produktit dhe për të konfirmuar se produkti i plotëson standardet e caktuara të cilësisë. Autoritetet kërkuese janë Inspektorati Federal dhe Inspektorati i Republikës Serbe ose Departamentet përkatëse për inspektimin e tregut.

Certifikata e veterinarisë nevojitet për kafshët e gjalla, farën, embrionin dhe qeliza vezore, disa prodhime të përpunuara shtazore, lëndë e parë për përpunim, medikamente dhe aksesore veterinarë, vegla dhe materiale diagnostike, ushqim dhe mbetje e kafshëve, si dhe prodhime tjera që mund të jenë bartës të sëmundjeve të kafshëve dhe që rrezikojnë jetën e kafshëve dhe njerëzve. Certifikata vërteton që produkti është i sigurt për shëndetin e kafshëve dhe njerëzve. Autoriteti kërkues është Zyra Shtetërore e Veterinarisë e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Certifikata fitosanitare vërteton shëndetin e të gjitha bimëve dhe prodhimeve të bimëve. Autoritetet kërkuese janë Inspektorati Federal dhe Inspektorati i Republikës Serbe (Departamentet për inspektim fitosanitar).

⁴¹ Teksti i Konventës gjendet në <http://www.basel.int>

Përpunimi i drurit

Ngjashëm me Serbinë, standardi i vetëm me rëndësi që e aplikon Bosnja dhe Hercegovina është ISPM 15 për material ambalazhues nga druri. Megjithatë, në Bosnjë dhe Hercegovinë pothuajse nuk ekzistojnë fare laboratorë për testimin e prodhimeve të drurit.

Materialet ndërtimore

Të gjitha materialet e shfrytëzuara në industrinë e ndërtimit në Bosnjë dhe Hercegovinë i nënshtrohen kriterëve testuese. Këto mund të pranohen kundrejt certifikatës së prodhuesve për cilësi dhe konformitet, ose duhet të dërgohen për testim dhe miratim nga institutet publike gjegjëse. Në Bosnjë dhe Hercegovinë ekzistojnë disa organizata të autorizuara për lëshimin e certifikatës ISO, mirëpo deri më tani vetëm një numër i vogël i bizneseve të ndërtimtarisë kanë arritur nivelin e bizneseve të BE-së. Ekzistojnë tri apo katër përjashtime të dalluara në sektorin privat dhe atë që është pjesërisht shtetëror të kësaj industrie, të cilat kanë punuar me certifikata të organizatave të stacionuara jashtë Bosnjës dhe Hercegovinës. Rregulloret që kanë të bëjnë me materialet ndërtimore të shfrytëzuara në Bosnjë dhe Hercegovinë janë më pak kërkuese se sa ato që kanë të bëjnë me sektorin e inxhinierisë civile, ku të gjithë përbërësit e materialit duhet të dërgohen për testim dhe miratim në laboratorët testues të autorizuar, të cilat i dërgohen Institutit të arkitekturës dhe inxhinierisë së ndërtimit para se të përdoren në vendin e ndërtimit.

4.3. Turqia

4.3.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike

Anëtar i G-20, Turqia është ekonomia e 18-të më e madhe botërore. Pas recesionit të vitit 2008-2009, aktiviteti ekonomik është rimëkëmbur për shkak të rritjes së madhe të kërkesës vendore të shtyrë nga normat e ulëta të interesit, të hyrat e mëdha kapitale dhe përshpejtimit të hovshëm në rritjet e kredive bankare. Në vitet e fundit, normat e rritjes kanë qenë mbi 8% duke e shtyrë BPV-në për kokë banori mbi 8,000 euro. Me norma të shpejta të rritjes dhe me popullatë të re dhe në rritje me mbi 70 milion, Turqia ka potencialin për të qenë ekonomia më e madhe në Evropë pas Gjermanisë. Turqia tani është anëtar i klubit G20 të ekonomive të rëndësishme dhe është pothuajse në hap me gjigantët në rritje të klubit BRIC. Disa parashikime madje sugjerojnë që gjatë dekadës së ardhshme Turqia do të rritet më shpejtë se çdo shtet tjetër përveç Indisë apo Kinës.

Turqia ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkimit të Doganave me BE-në dhe praktikën e saj doganore janë në harmoni me udhëzimet e Organizatës Botërore Tregtare. Nënsekretariati i kryeministrit për Tregti të Jashtme është organi kryesor qeveritar në administrimin e tregtisë së jashtme. Departamentet tjera relevante janë: Drejtorati i Përgjithshëm për Dogana, përgjegjës për formulimin e politikave doganore dhe politikat për tarifa; Institucioni Turk për Standarde, përgjegjës për inspektimin e produkteve industriale; dhe Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, përgjegjëse për formulimin dhe sigurimin e zbatimit të ligjeve që lidhen me tregtinë.

Turqia gëzon një numër të përparësive logjistike. Duke shërbyer si urë ndërmjet veriut dhe jugut, lindjes dhe perëndimit, Turqia paraqet një portë me ndikim të madh dhe efektiv në kosto për tregjet e mëdha. Tregtia ka qenë tradicionalisht aspekt kyç i ekonomisë së Turqisë.

Me gjithë krizën ekonomike globale dhe çështjet politike e sociale që i kanë prekur rajonet fqinje, Turqia ka eksportuar më shumë mallra në vitin 2012 se asnjëherë më parë. Eksportet kishin furnizuar 241 shtete dhe rajone në mbarë botën.

Qeveria turke i sheh investimet e huaja direkte si të rëndësishme dhe të domosdoshme për suksesin e saj. Në vitin 2013, qeveria largoi gati të gjitha kufizimet dhe kërkesat për investitorët e huaj dhe u dha atyre statusin e njëjtë ligjor me kompanitë në pronë të turqve. Qeveria e Turqisë ofron nxitje të shumta në taksa dhe jashtë taksave për investitorët e huaj, të njëjtat që u ofrohen edhe kompanive vendore. Këto përfshijnë përjashtime nga taksat doganore dhe TVSH-ja për mallra të ndryshme të importuara apo të shpërndara brenda vendit, duke përfshirë makineritë dhe pajisjet, si dhe nxitjet e ofruara për rajonet e prioritarizuara si tokë falas dhe përkrahje për energji. Investitorët janë gjithashtu në gjendje të përfitojnë nga mbështetja në hulumtim dhe zhvillim (R&D) dhe hulumtimi i tregut me qëllim të inkurajimit të eksporteve dhe rritjes së konkurrueshmërisë së firmave në tregjet ndërkombëtare. Qeveria turke gjithashtu ka aplikuar politika fleksibile të normave të këmbimit dhe rregullore për import liberal në mënyrë që të promovojë dhe të mbajë investimet e huaja.

4.3.2. Marrëdhëniet me Kosovën

Turqia është një aleat me lidhje të ngushta me Kosovën dhe një prej shteteve të para që ka njohur atë si shtet të pavarur. Misionet diplomatike janë instaluar reciprokisht nga të dy palët në Ankara dhe në Prishtinë dhe nevoja për viza është pezulluar reciprokisht nga të dyja vendet. Diaspora kosovare që jeton në Turqi dhe diaspora turke në Kosovë luajnë rol të rëndësishëm në përforcimin e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të forta. Turqia është një prej partnerëve kryesor ekonomik dhe tregtar të Kosovës dhe është partneri tregtues i katërt më i madhi për Kosovën.

Kosova dhe Turqia kanë nënshkruar Marrëveshje të Tregtisë së Lirë, e cila eliminon taksat doganore në të gjitha mallrat industriale dhe në 850 linja tarifore (në nivelin 8 shifror të Sistemit të Harmonizuar) në lidhje me mallrat bujqësore me origjinë nga Kosova me të hyrë në fuqi. Kosova, në anën tjetër, do të eliminojë taksat doganore në të gjitha mallrat industriale dhe 846 linja tarifore për mallrat bujqësore me origjinë turke, me rritje graduale në nëntë vite, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.


Turqia dhe Kosova gjithashtu kanë nënshkruar Marrëveshje për Bashkëpunim Ekonomik (2009) dhe Promovimin Bilateral të Investimeve dhe Marrëveshjen për Mbrojtje (2006).

Këshilli Biznesor Turqi-Kosovë lehtëson investimet përbrenda kornizës strukturore. Viteve të fundit bashkëpunimi është intensifikuar në sektorin e arsimit dhe atë të kulturës.

Eksportet kosovare për Turqi kanë arritur vlerën prej 7.3 milion euro në vitin 2013, duke u rritur nga 1 milion në vitin 2005. Pesë kategoritë më të importuara ishin: fjetet e tekstilit, pëlhura, artikujt të fabrikuar (2.5 milion euro); minerale me përmbajtje metale dhe skrap i metalit (2.1 milion euro); prodhime gome (1.6 milion euro); prodhime metali (0.5 milion euro); dhe fije tekstili (0.14 milion euro).

Kosova ishte tregu i 75-të më i madh i mallrave i Turqisë në vitin 2012. Importet nga Turqia në vitin 2013 ishin rreth 200 milion euro, me rritje prej 11% krahasuar me vitin 2011 (185 milion euro). Kategoritë më të eksportuara ishin: artikujt për veshje dhe aksesore rrobash, fjetet e tekstilit, pëlhura, artikujt të fabrikuar, prodhime metali, makineri elektrike, aparate dhe pajisje dhe produkte të tjera të prodhuara. Deficiti tregtar i Kosovës me Turqinë në vitin 2013 ishte 197 milion euro (shih Figurën 10 më poshtë).

Figura 10. Shkëmbimi tregtar me Turqinë 2005-2013 (në '000 Euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Firmat turke deri më tani kanë implementuar projekte kyçe në Kosovë me vlerë totale prej afërsisht 400 milion euro. Nga viti 2002 deri në 2012, Investimet e Huaja Direkte (IHD) nga Turqia në Kosovë janë afërsisht 770 milion euro. Investimet direkte të raportuara turke në Kosovë kryesohen nga sektori i bankave dhe minierave.

4.3.3. Pasqyrë e tregut

Përpunimi i ushqimit

Turqia zë vendin e 5-të në aspektin e shpenzimeve në ushqim. Sektori i ushqimit dhe pijeve përbën 21% të BPV-së totale të Turqisë. Industria turke e ushqimit është duke gëzuar trende të vazhdueshme të rritjes falë popullatës së re në vend, shkallës së lartë të urbanizimit dhe rritjes së nivelit të të hyrave. Mallrat më të konsumuara në sektorin e ushqimit janë buka, bishtajoret, sheqeri, prodhimet e bulmetit, pemët dhe perimet.

Sektori turk i përpunimit të ushqimit është i modernizuar dhe i zhvilluar dhe ka kapacitete për prodhimin e artikujve të cilësisë së lartë dhe në sasi të mëdha për nën-sektore të ndryshme. Prodhuesit turk të ushqimit janë fleksibil dhe inovativ dhe priren të prodhojnë produkte të ngjashme me ato të importuarat në momentin që shohin mundësi për rritje të shitjeve, gjë që krijon konkurrencë të madhe për artikujt e importuar ushqimor.

Bujqësia

Bujqësia është ende sektor shumë i rëndësishëm i ekonomisë. Bujqësia merr pjesë me rreth 10% të BPV-së dhe 25% të punësimit. Turqia është prodhues dhe eksportues kryesues botëror në disa sektore (posaçërisht pemë dhe perime).

Turqia është prodhues i madh në sektorin e drithërave. Prodhimi i drithërave në Turqi (duke përfshirë orizin) paraqet më shumë se 10% të prodhimit të BE-së. Turqia është prodhues dhe eksportues kryesues botëror i pemëve dhe perimeve. Nivelet e saj të prodhimit aktualisht arrijnë vlerën prej 26.8 milion ton, e cila paraqet rreth 60% të prodhimit të BE-së të pemëve dhe perimeve. Sa i përket frutave arrorë, Turqia luan rol të rëndësishëm botëror, posaçërisht për lajthitë (eksportuesi më i madh në botë).

Turqia është shumë konkurruese në aspektin e raportit cilësi/çmim falë klimës së saj dhe kostos së ulët të fuqisë punëtore. Turqia është konkurruese në prodhim edhe për të mbjella tjera (në BE dhe mbarë botën) si disa bishtajoreve siç janë leblebiat dhe thjerrëzat, të pambukut dhe disa kualiteteve të sheqerit, duhanit dhe vajit të ullirit. Për kafshët dhe produktet nga kafshët, Turqia ka treg shumë të mbrojtur duke përfshirë edhe kufizime importi. Konsumi i mishit për kokë banori në Turqi është rreth 1/5 e mesatares në BE, por sa i përket mishit të deles mesatarja në Turqi është më e lartë se në BE. Konsumi i qumështit të lopës dhe vezëve është sa gjysma, respektivisht $\frac{3}{4}$ e nivelit të konsumit në BE.

Përpunimi i drurit

Përpunimi i drurit luan rol të rëndësishëm në ekonominë e Turqisë, me prodhim të drurit industrial të drejtuar kryesisht në prodhimin e pllakave me bazë nga druri (mëse 6 lloje të iver-pllakave të densitetit të ndryshëm dhe për qëllime të ndryshme) dhe masës së butë nga druri. Meqenëse konsumi i produkteve nga druri është shumë i lartë në Turqi, prodhimi vendor nga druri duhet të plotësohet me produkte nga importi.

Sa i përket tregtisë, sektori i tregut të drurit është i shumëllojshëm dhe përbëhet nga një numër i prodhimeve duke përfshirë trungjet nga druri, drunj të prerë, rimeso, panele, ornamente druri, dyer dhe korniza dyersh, dritare dhe korniza dritaresh, dysheme dhe komponente tjera ndërtimi. Industritë e prodhimit të drurit përbëhen kryesisht nga ndërmarrje të vogla të shpërndara në të gjithë vendin edhe pse ekzistojnë grupime gjeografike. Industria e drurit është pothuajse tërësisht e kontrolluar nga sektori privat. Shumë nga këto kompani janë në projekte të përbashkëta me partnerë nga BE-ja.

Industritë kryesore që konsumojnë dërrasat e prera dhe drunjtë e përpunuar më tej janë industria e ndërtimtarisë, e mobilieve, industria e paneleve nga grimcat e fibrat e drurit MDF, e dërrasave letër/letër, industrinë për masë të butë nga druri dhe panelet me bazë nga druri.

Në 81 qytete turke, zdrukthëtaritë dhe tregtarët e prodhimeve nga druri janë të organizuara në "Zona të Organizuara të Tregtarëve të Drurit", të cilat shërbejnë si tregje aksionesh për të gjithë drurin e tregtuar në Turqi. Të gjithë akterët në treg duke përfshirë përpunuesit e drurit, importuesit dhe tregtuesit, kanë atelie të vogla apo zyra të vogla tregtimi në këto zona. Zonat e tilla kryesore gjenden në Ankara (qyteti i dytë më i madh në Evropë), Ikitelli (Stamboll), Simav (Kütahya), İzmit, Düzce dhe Bursa.

Materialet ndërtimore

Turqia renditet si vendi i dytë (pas Kinës) në aspektin e numrit të kompanive kontraktuese të nivelit të lartë në industrinë botërore të ndërtimtarisë. Fokusi kryesor është në Stamboll, Ankara dhe Izmir. Me popullatën në rritje të Turqisë, urbanizim rapid dhe mungesën aktuale të njësive të banimit, vlerësohet se nevojitet të ndërtohen rreth 600,000 njësi banimi shtesë për vit.

Ekzistojnë rreth 800 kompani ndërtimore në Turqi dhe 38 prej tyre janë në listën e 250 Kompanive më të Mëdha Ndërtimore në Botë. Sektori i ndërtimtarisë është sektori i tretë më i madh ekonomik në Turqi, pas industrive të ushqimit dhe tekstilit.

Në dhjetë vitet e fundit, sektori turk i ndërtimit ka pësuar rritje të konsiderueshme. Shtytësit kryesorë përfshijnë nevojën e rritur për banim, kreditë e lehtësuara për strehim që u ka mundësuar njerëzve që të përmirësojnë kushtet e banimit, rritja në numrin e firmave kontraktuese turke të shkallës së lartë dhe rritja e sektorit të materialit ndërtimor. Turqia aktualisht është udhëheqës në treg në aspektin e eksporteve të çimentos dhe është në konkurrencë të ashpër me Egjiptin për t'u bërë prodhuesi dominues në të gjithë gjirin Mesdhetar. Prodhimi turk i çelikut të papërpunuar ka arritur në rreth 30 milion ton, një rritje prej 15% gjatë vitit të kaluar. Rrjedhimisht, Turqia renditet e dhjeta në botë për prodhimin e çelikut të papërpunuar.

Ekzistojnë disa mundësi në Turqi për kompanitë eksportuese kosovare, posaçërisht për ato që mund të përfshihen në ofrimin e materialeve për projekte banimi, që është një sektor i cili pritet të rritet shumë në vitet në vijim.

4.3.4. Procedurat e përgjithshme të importit

Regjimi i importit

Regjimi turk i importit reflekton të drejtat dhe detyrimet ndërkombëtare dhe nevojat ekonomike të vendit. Vendimi për Regjim Importi përpilohet çdo vit, publikohet në gazetën zyrtare deri më 31 dhjetor dhe hyn në fuqi më 1 janar. Vendimi për Regjim Importi cakton normat e taksave doganore ndaras për shtete dhe grupe shtetesh, ndërsa produktet klasifikohen në gjashtë listat në vijim:

- Produktet bujqësore (Lista: I)
- Produktet Industriale (Lista: II)
- Produktet e përpunuara bujqësore (Lista: III)
- Peshku dhe produktet nga peshku (Lista: IV)
- Lista e pezulluar (Lista: V)
- Lista e mallrave që përdoren në fushën e aeroplanëve civil me të drejtë të lirimit nga taksat doganore (Lista: VI)

Procedurat doganore

Korniza bazike legjislative doganore në Turqi përbëhet nga Ligji për Doganat Nr. 4458 (i amendamentuar) dhe Rregulloret nga ky ligj. Formulari EUR1 kërkohet për importet nga vendet jashtë BE-së me të cilat Turqia ka marrëveshje të tregtisë së lirë. Format i deklarates doganore të Turqisë është harmonizuar me dokumentin e vetëm administrativ (DVA) të përdorur në BE për procedurat doganore. Të gjitha mallrat e importuara duhet të paraqiten tek doganat përmes DVA-së së shoqëruar me dokumentet tjera përkatëse. Autoriteti doganor mund të japë lejen për thjeshtësim të formaliteteve dhe procedurave (Autorizimi për Procedurë të Thjeshtësuar), duke përfshirë heqjen e kërkesës për disa dokumente. Përdorimi i agjentit zhdoganues nuk është i detyrueshëm. Deklarata përmbledhëse duhet të paraqitet tek zyra doganore para përfundimit të orarit të punës pas arritjes së mallrave në Doganë. Kjo deklaratë për mallrat e importuara dhe ato të eksportuara, përmban të gjitha informatat e nevojshme për identifikimin e mallrave, e ka renditjen e caktuar më parë dhe mund të gjendet në Shtojcën 9 të Rregullores për Dogana. Zhdoganimi i importit në përgjithësi merr më së shumti 24 orë (nëse të gjitha dokumentet e kërkuara janë në rregull), pavarësisht nga mënyra e transportit. Taksat doganore për import duhet të paguhen apo të garantohen në momentin e zhdoganimit.

Dokumentet doganore

Kur dorëzohet deklarata doganore nga deklaruesi apo përfaqësuesi i tij, është obligative që të përgatitet fatura origjinale dhe formulari për deklarim të vlerës së mallrave të importuara para se të jepet deklarata doganore e shtypur tek administrata doganore. Përveç këtyre, dokumentet në vijim duhet të shoqërojnë deklaratën e cila duhet të dorëzohet tek Administrata Doganore: i) fatura e transportit në mënyrë vullnetare apo varësisht nga situata dhe/ose polica e sigurimit në pajtueshmëri me kushtet e pagesës, ii) Fatura e ngarkesës ose Fatura e transportit, iii) lista e paketimit (apo në rastin e aplikimit të dispozitave të lëshimit për qarkullim të lirë procedura është subjekt i autorizimit preliminar apo kur deklaruesi dëshiron të përfitojë nga tarifa preferenciale, dokumenti kontrollues apo certifikata e origjinës), iv) dokumente tjera që kërkohen sipas dispozitave të veçanta si formulari për deklarim për produktet e përpunuara bujqësore. Dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës dhe/apo që duhen përpiluar para dorëzimit të mallrave apo, në disa raste, para ditës kur paraqiten detyrimet doganore varen nga dhe/ose janë subjekt i natyrës së mallrave, vendi apo grupi i vendeve nga ku importohen mallrat, marrëveshjet bilaterale apo multilaterale, kushtet për dërgesë, kushtet për pagesë, origjinën dhe masat e caktuara nga dispozitat që kanë të bëjnë me tregtinë, d.m.th. detyrimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për tregtinë e mallrave, apo aranzhimet speciale të dizajnuara nga agjencitë përkatëse në pajtueshmëri me ligjet, vendimet, rregulloret dhe legjislacionin e ngjashëm.

Përveç kësaj, disa Zyra Doganore të specializuara janë themeluar për të realizuar kontrolle doganore më efektive në kuptimin e vlerësimit, tarifës dhe standardizimit. Disa mallra duhet të doganohen vetëm nga këto Zyra Doganore të specializuara. Mallrat mund të shkarkohen nga mjetet e transportit në vendet e dedikuara apo të miratuara na Dogana dhe me autorizimin e dhënë nga zyra doganore që ka të bëjë me to. Asnjë mall nuk mund të shkarkohet pa përpiluar deklaratën përmbledhëse apo ndonjë dokument tjetër tregtar apo zyrtar që përdoret si deklaratë përmbledhëse. Sidoqoftë, në rast të rrezikut të pashmangshëm ku mallrat duhet të shkarkohen në tërësi apo pjesërisht me urgjencë, mund të mos kërkohet autorizimi. Rastet e tilla duhet të raportohen pa vonesë tek Zyra më e afërt Doganore.

Licencimi i importit

Si rregull i përgjithshëm, nuk kërkohen licenca apo leje importi për mallra të importuara. Megjithatë, autoritetet publike kanë fuqinë për të rregulluar dhe monitoruar importin e disa mallrave të caktuara me arsyetim moralin publik, politikën publike dhe sigurinë publike, mbrojtjen e shëndetit e jetës së

njerëzve, kafshëve dhe bimëve apo mbrojtjen e pronës industriale dhe komerciale. Këto lloj çështjesh rregullohen përmes disa komunikatave të cilat gjithashtu publikohen në Gazetën Zyrtare. Kur importi i një produkti të caktuar shkakton dëme apo cenon prodhuesit vendor të produkteve të njëjta konkurruese, autoritetet mund të vendosin mbikëqyrje të produktit. Produkti i importuar nën vëzhgim duhet të shoqërohet me licencë importi, si dokument shtesë krahas dokumenteve tjera që kërkohen sipas ligjeve dhe rregulloreve doganore.

Zonat e lira tregtare

Zonat për tregti të lirë janë vende të posaçme brenda një shteti, por konsiderohen se janë jashtë territorit doganor. Në këto rajone, rregulloret normale që kanë të bëjnë me tregtinë e jashtme dhe fushat tjera financiare dhe ekonomike mund të mos aplikohen fare, të aplikohen pjesërisht apo të zëvendësohen me rregullore të reja. Në përgjithësi, aktivitetet si prodhimi, magazinimi, ambalazhimi, tregtimi i përgjithshëm, çështjet bankare dhe sigurimi e tregtia mund të kryhen brenda zonave të lira tregtare në Turqi. Mallrat që qarkullojnë ndërmjet Turqisë dhe zonave të lira trajtohen si eksporte dhe importe. Sidoqoftë, operacionet brenda zonave janë subjekt i mbikëqyrjes nga menaxhmenti i zonës (dhe autoritetet doganore), tek të cilët duhet dorëzuar raporte të rregullta për veprimtarinë. Rrjedhimisht, kërkohet nga të gjithë përdoruesit e zonës që të mbajnë regjistra të plotë kontabël (në gjuhën turke) në lidhje me aktivitetet e tyre. Këto kërkesa për të dhëna kontabël shtrihen deri në regjistrat e inventarit. Taksa doganore aplikohet për humbje të pashpjegueshme të inventarit sikur inventari të ishte importuar brenda vendit. E drejta për të operuar në zonë të lirë jepet me licencë të operimit e cila merret tek Ministria e Ekonomisë, e cila shqyrton aplikimin për përputhshmëri me objektivat dhe llojet e aktiviteteve të specifikuar nga Këshilli Koordinues për Çështje Ekonomike.

Vendosja e mallrave në procedurë doganore

Të gjitha mallrat e dedikuara për procedurë doganore duhet të mbulohen me deklaratë për atë procedurë doganore. Deklarata doganore mund të bëhet në cilëndo nga format në vijim:

- me shkrim;
- duke përdorur teknikë të procesimit të të dhënave;
- në mënyrë verbale; apo
- duke përdorur ndonjë mënyrë tjetër përmes së cilës bartësi i mallrave shpreh dëshirën për të vendosur mallrat në procedurë doganore.

Deklarata që regjistrohet nga administrata doganore e lidhë deklaruesin me detyrim financiar në lidhje me taksat doganore dhe gjokat të cilave u referohet dhe është baza për të vlerësuar taksat doganore.

Regjimi i magazinimit të garantuar

Sipas Ligjit Doganor, ekziston mundësia të magazinohen mallrat që nuk janë në qarkullim të lirë në magazina të lidhura pa qenë subjekt i taksave të importit apo masave të politikave komerciale. Nuk ka kufizim kohor lidhur me qëndrimin e mallrave në këto magazina. Çmimi për magazinim dhe ruajtje të mallrave derisa mbesin në magazinë, nuk duhet të përfshihet në vlerën doganore nëse ato shfaqen ndaras nga çmimi i paguar apo i arkëtueshëm për mallrat. Sidoqoftë, ato kosto duhet të shtohen në bazën e tatueshme të TVSH-së.

Regjimi i përpunimit të brendshëm (RPB)

RPB-ja është sistem që mundëson prodhuesit/eksportuesit që të marrin materialin e papërpunuar, mallra të ndërmjetme të papërfunduara që përdoren në prodhim të mallrave të eksportuara pa paguar taksat doganore dhe pa u bërë subjekt i masave të politikave komerciale. Pronari i autorizimit RPB është i obliguar që të importojë mallrat e definuara në autorizim dhe të eksportojë ato pasi të ketë përpunuar mallrat e importuara. Qëllimi kryesor i RPB-së është që ta mbajë materialet në çmim të tregut botëror dhe të rrisë konkurrencën e eksportuesve turk. RPB-ja mund të implementohet në dy mënyra të ndryshme:

1. Sistemi i pezullimit: Në sistemin e pezullimit, mallrat që nuk janë në qarkullim të lirë, që janë të destinuara për ri-eksportim nga Turqia në formë të produkteve të përfunduara në regjimin e përpunimit të brendshëm, mund të importohen përkohësisht pasi të jenë mbuluar me sigurim. Kur mallrat eksportohen në formë të produkteve të përfunduara në regjimin e përpunimit të brendshëm, sigurimi kthehet.

2. Sistemi i kthimit të parave: Në rast se mallrat lëshohen për qarkullim të lirë apo eksportohen nga Turqia në formë të produkteve të përfunduara në regjimin e përpunimit të brendshëm, taksat doganore për import të arkëtuara kur ato janë lëshuar për qarkullim të lirë kthehen.

Firmat që kanë certifikatë autorizimi mund të importojnë dhe të eksportojnë mallra pa paguar ndonjë taksë doganore dhe tarifa tjera gjatë periudhës së cekur në certifikatë autorizimi. Kjo periudhë pa pagesa nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj. Sidoqoftë, për disa objekte të veçanta të prodhimit koha e dhënë mund të jetë deri në 24 muaj. Periudha e lirimit nga pagesa mund të zgjatet në maksimum edhe për gjysmën e periodës së cekur në certifikatën e autorizimit për shkak të situatave të forcave madhore.

Regjimi i përpunimit nën kontroll doganor

Procedura për përpunim nën kontroll doganor mundëson që mallrat që nuk janë në qarkullim të lirë të përdoren në territorin doganor të Turqisë në operime që mund të ndryshojnë natyrën e tyre apo gjendjen dhe pa u bërë subjekt i taksave doganore apo masave të politikave komerciale dhe mundëson që produktet që rezultojnë nga operimet e tilla të lëshohen për qarkullim të lirë me normën e taksës doganore që u përshtatet atyre. Autorizimi për përpunim nën kontroll doganor jepet nga administrata me kërkesë të personi i cili kryen përpunimin apo që aranzhon përpunimin e tyre.

Regjimi i importit të përkohshëm

Regjimi i importit të përkohshëm përcaktohet në Ligjin Doganor si në vijim; "Procedura e importit të përkohshëm mundëson shfrytëzimin në territorin doganor të Turqisë, me lirim të plotë apo të pjesshëm nga taksat doganore dhe pa u bërë subjekt i masave të politikave doganore, të mallrave që nuk janë në qarkullim të lirë të destinuara për ri-eksportim pa iu nënshtruar ndonjë ndryshimi përveç zhvlerësimit të rregullt për shkak të përdorimit të tyre". Autorizimi për import të përkohshëm të pronës së personit të krijuar jashtë territorit doganor të Turqisë jepet nga zyra doganore përkatëse me kërkesë të personit që shfrytëzon mallrat apo mundëson që ato të shfrytëzohen. Mallrat duhet të mbulohen sipas kushteve të veçanta të përcaktuara në dispozitat e Vendimit të Këshillit Ministror Nr. 2000/69 i cili përcakton "Kushtet e veçanta për Procedurat e importit të përkohshëm me Lirim të plotë nga taksat doganore".

Regjimi për përpunim jashtë vendit

Procedura për përpunim jashtë vendit mundëson që mallrat në qarkullim të lirë të eksportohen përkohësisht nga Turqia për t'iu nënshtruar operimeve të përpunimit dhe produktet që rezultojnë nga

ato operime të lirohen për qarkullim të lirë me lirim të plotë apo të pjesshëm nga taksat doganore. Autorizimi specifikon periudhën brenda së cilës produkti i përpunuar jashtë vendit duhet të ri-importohet në Turqi. Autoritetet mund të zgjasin këtë periudhë pas dorëzimit të kërkesës së mbështetur si duhet nga bartësi i autorizimit. Taksat e importit ndikohen duke zbritur nga shuma e taksave të importit të aplikueshme në produktin e prodhuar jashtë vendit, shumën e taksave të importit që do të ishin të aplikueshme në datën e njëjtë për eksportin e përkohshëm të mallrave nëse ato do të importoheshin nga vendi në të cilin ato i janë nënshtruar operimit të përpunimit.

Shuma që duhet zbritur kalkulohet në bazë të sasisë dhe natyrës së mallrave në fjalë në datën e pranimit të deklaratës. Kalkulimi mund të bëhet në bazë të elementeve tjera që kanë të bëjnë me lëshimin për qarkullim të lirë të produkteve të përpunuara jashtë vendit. Në rast kur qëllimi i operimeve të përpunimit është riparimi i mallrave të eksportit të përkohshëm, ato lëshohen për qarkullim të lirë me lirim të plotë nga taksat e importit atëherë kur demonstron se riparimi është bërë pa pagesë, ose për shkak të obligimeve kontraktuale apo atyre statutores që dalin si rezultat i garancisë apo për shkak të defektit në prodhim. Sidoqoftë, kjo dispozitë nuk aplikohet në rastin kur defekti është marrë në konsideratë në momentin kur mallrat në fjalë ishin lëshuar fillimisht për qarkullim të lirë.

4.3.5. Tarifat, taksat doganore, kuotat dhe rregullat e origjinës

Mallrat e importuara në Turqi mund të jenë subjekt i ngarkesave të ndryshme: taksat dhe ngarkesat doganore (tarifat doganore dhe ngarkesa për fondin e banimit masiv) dhe taksat e brendshme (akciza gjithashtu e njohur si Taksa për Konsum të Veçantë, TVSH-ja dhe ngarkesa për vulë).

Sistemi tarifar

Si rezultat i Bashkimit Doganor të formuar me BE-në në vitin 1996, Turqia aplikon tarifën e përbashkët të jashtme të BE-së (CRT) për produktet industriale dhe makinerinë bujqësore nga vendet e treta dhe përfshinë në Sistemin e vet të Preferencave të Përgjithësuara (SPP) të gjitha produktet industriale të mbuluara nga regjimi SPP i BE-së, duke ofruar kushte të njëjta preferenciale si të BE-së. Mallrat e eksportuara në Turqi mund të jenë subjekt i pesë llojeve të ngarkesave: taksat doganore, akcizës, taksën për Fondin e Banimit Masiv (për produkte nga peshkataria), taksën për konsum të veçantë (SCT), dhe taksën mbi vlerën e shtuar. Taksat doganore ndahen në pesë lloje: taksat doganore ad valorem, specifike, të kombinuara, të përziera dhe të bazuar në formulë.

Tarifat turke përbëhen nga norma *ad valorem*, e cila aplikohet tek 97.9% e të gjitha linjave, the norma *jo-ad valorem* (taksat doganore specifike, të përziera, të kombinuara dhe e ndryshueshme) që aplikohen në 378 artikuj të nivelit HS dymbëdhjetë shifror (284 në vitin 2013). Tarifa mesatare MFN e aplikuar është konsiderueshëm më e lartë në sektorin e bujqësisë sesa në sektoret tjera: duke përdorur definicionin e OBT-së, mbulueshmëria e produkteve bujqësore është 47.6%, ndërsa e atyre jo-bujqësore 5%. Rreth 46.3% të linjave tarifore janë të lidhura. Norma e thjeshtë mesatare e lidhur është 33.9%, ndërsa në vitin 2007 norma e thjeshtë mesatare MFN ishte 11.6%. Vlerat kulmore të normave të lidhura i krijojnë Turqisë marzhë të mjaftueshme për ngritje të tarifës.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Sistemi turk i taksave jep tatimin mbi vlerën e shtuar në furnizimin dhe importimin e mallrave dhe shërbimeve. Emri në gjuhën turke për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar është 'Katma Deger Vergisi', me shkurtesë KDV. Çdo person apo subjekt i angazhuar në një aktivitet nën fushëveprimin e Ligjit për TVSH-në duhet të njoftojë zyrën tatimore lokale në vendin ku ndodhet biznesi i tij. Nëse ka më shumë se një vend ku bën biznes, atëherë regjistrimi bëhet në zyrën tatimore që është e autorizuar përkitazi

me taksën në të hyra individuale apo taksën në të hyra të korporatave.

Nuk ekziston një qasje e vetme e “regjistrimit të TVSH-së” në Turqi, pasi që nuk ekziston mundësi e regjistrimit vetëm për qëllime të TVSH-së. Për t’u regjistruar për qëllime TVSH-je, kompania e huaj duhet të ketë vendosje permanente (VP) në Turqi dhe është e obliguar të regjistrohet për qëllimet e të gjitha taksave (d.m.th. TVSH, taksa në të hyra të korporatave, taksa në burim taksa për vulë, etj) në zyrën tatimore lokale.

Rregullat e origjinës

Rregullat preferenciale të origjinës, që specifikojnë standardet për përpunim dhe vlerën e shtuar të produkteve përkatëse, aplikohen në importet nga vendet me të cilat Turqia ka nënshkruar aranzhime bilaterale apo multilaterale të tregtisë preferenciale.

Vlerësimi doganor

Turqia ka harmonizuar dispozitat doganore për vlerësim me ato të KE-së në harmoni me dispozitat e Nenit 28 të Vendimit të Këshillit të Shoqatës KE-Turqi Nr. 1/95. Vlerësimi doganor i mallrave të importuara përcaktohet sipas metodave në vijim dhe këto metoda aplikohen sipas renditjes së tyre hierarkike:

1. Metoda e vlerës së transaksionit;
2. Metoda e vlerës së transaksionit të mallrave identike;
3. Metoda e vlerës së transaksionit të mallrave të ngjashme;
4. Metoda deduktive;
5. Metoda e vlerës së llogaritur’ dhe
6. Metoda alternative.

Procedurat e thjeshtësuara në vlerësimin doganor

Vlera doganore e mallrave që mund të prishen mund të përcaktohet sipas procedurave të thjeshtësuara me kërkesë të deklaruesit. Për mallra që mund të prishen, është e mundshme që të deklarohen artikujt të cilët do t’i shtohen çmimit të paguar apo të arkëtueshëm për përcaktimin e vlerës doganore pas eksportimit në Turqi.

Ripagesa dhe shlyerja e detyrimeve doganore

Taksat doganore kthehen kur konstatohet se me rastin e pagimit, shuma për detyrimet e tilla nuk është kërkuar me ligj. Megjithatë, nuk lejohet kthimi ose shlyerja e detyrimit në rast se provat të cilat kanë sjellë deri te pagesa ose evidentimi i shumës e cila nuk ka qenë e kërkuar me ligj, është shkaktuar si pasojë e veprimit të qëllimshëm të personit të interesuar. Detyrimet doganore kthehen apo shlyhen me ushtrimin e një kërkesë në zyrën doganore kompetente, brenda afatit trevjeçar nga data kur shuma e këtyre detyrimeve i është komunikuar debitorit. Detyrimet doganore të paguara në bazë të deklaratës kthehen me kërkesë të personit që ka të bëjë me to duke e bërë jo-valide deklaratën doganore.

Prej datës së regjistrimit të deklaratës, detyrimet doganore kthehen apo shlyhen për aq sa konstatohet se shuma e detyrimeve të tilla e regjistruar në kontabilitet lidhet me mallrat e refuzuara nga importuesi pasi që ato janë me defekt apo nuk përputhen me kushtet e kontratës në bazë të së cilës ato janë importuar. Mallrat e dëmtuara para lëshimit të tyre gjithashtu pranohen si me defekt. Ripagimi apo shlyerja e detyrimeve doganore lejohet me kusht që mallrat nuk janë përdorur, përveç përdorimit fillestar që është i nevojshëm për të konstatuar që ato janë me defekt apo që nuk përputhen me kushtet e kontratës.

Administrata Doganore mund të lejojë që mallrat të shkatërrohen apo të vendosen për qëllime të ri-eksportimit, në procedurë të transitit apo procedurë të magazinimit doganor apo zonë të lirë, në vend se të eksportohen. Me qëllim të përcaktimit të një prej trajtimeve të aprovuara doganore apo përdorimeve të përmendura në pjesën paraprake të këtij dokumenti, mallrat konsiderohen se janë mallra që nuk janë në qarkullim të lirë.

4.3.6. Kërkesat teknike dhe mjedisore

Rregulloret teknike

Regjimi për Rregullore Teknike dhe Standardizim për Tregti të Jashtme përbëhet nga Vendimi (Nr. 96/7794), Rregullorja dhe Komunikatat. Për herë të parë ka hyrë në fuqi në vitin 1995 dhe vazhdon të jetë rregullues për aktivitetet e standardizimit (për herë të fundit është amendamentuar me Vendimin Nr. 9454/2005). Ky regjim ka për synim të rrisë konkurrencën dhe sigurinë e eksporteve për të siguruar trajtim të njëjtë për produktet e importuara dhe ato vendore, të mbrojtë shëndetin njerëzor, të rrisë sigurinë, të mbrojtë jetën shtazore dhe atë bimë si dhe mjedisin.

Regjimi për Rregullore Teknike dhe Standardizim për Tregti të Jashtme është në përputhshmëri me kërkesat e parashtruara në Marrëveshjen për Barrierat Teknike në Tregti të Organizatës Botërore të Tregtisë. Ajo ndalon diskriminimin ndër partnerë tregtarë dhe ka për qëllim të sigurojë që produktet e importuara përputhen me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, jetës së kafshëve dhe bimëve apo mjedisit. Rregullorja si legjislacion plotësues lidhet me kontrollet e produkteve bujqësore që do të eksportohen brenda fushëveprimit të standardeve të mandatuara në eksporte. Rregullorja gjithashtu përcakton kornizën e kontrolleve të importit, të cilat rregullohen më në detaje me anë të komunikatave.

Për disa produkte kërkohet certifikata e kontrollit. Ministritë përkatëse kryejnë kontroll të dokumentacionit para fazës së importit dhe lëshojnë certifikatën e kontrollit. Këto certifikata janë valide për një kohë të caktuar nga 4 deri në 12 muaj dhe vlejnë për sasinë e cekur të mallrave të importuara. Përbrenda kufizimeve kohore dhe sasiore, importuesi mund të përdorë të njëjtën certifikatë për importe të shumfishta.

Standardizimi

Institucioni Turki i Standardeve (ITS) ka zhvilluar dhe implementuar standarde për produktet e prodhuara apo të importuara në Turqi që nga viti 1960. Është një institucion i pavarur (nuk është themeluar nga shteti), përgjegjës për përpilimin dhe publikimin e standardeve për të gjitha llojet e materialeve dhe produkteve. Përveç kësaj, ai merret me metrologji dhe kalibrim industrial, dhe me shërbime laboratorike për vlerësimin e përputhshmërisë dhe certifikimin.

ITS-a është anëtarë i plotë i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) dhe Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC); është gjithashtu anëtar i Komitetit Evropian për Standardizim (CEN), dhe Komitetit Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC). Sipas autoriteteve, rreth 98% e standardeve CEN dhe 93.5% e standardeve CENELEC janë miratuar (deri në gusht 2007). Njohja e procedurave të testimit është siguruar me marrëveshje reciproke ndërmjet Turqisë dhe shteteve anëtare të BE-së.

4.3.7. Kërkesat e sektorit

Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Rregulloret kryesore –Rregulloret për ushqimin dhe produktet bujqësore në përgjithësi përpilohen dhe publikohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Çështjeve Rurale (MBÇR). Megjithatë, ka edhe rregullore tjera që janë publikuar nga ministritë tjera, si Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë⁴². Aktualisht, objektivi kryesor i politikave turke për ushqimin dhe bujqësinë është harmonizimi i ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me këto çështje me *acquis communautaire* të BE-së.

Ligji kryesor i Turqisë për rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me ushqimin është Ligji për Prodhim, Konsum dhe Inspektim të Ushqimit (Ligji Nr. 5179). Qëllimi i këtij ligji, siç është cekur në nenin e parë, është të sigurojë siguri në ushqim dhe prodhim higjienik të të gjitha produkteve ushqimore dhe materialeve për ambalazhim të ushqimit, të mbrojtë shëndetin publik, të përcaktojë kriteret minimale teknike dhe higjienike për prodhuesit e ushqimit dhe të përcaktojë parimet e monitorimit të prodhimit dhe shpërndarjes. Ky Ligj amandamenton kornizën e Kodeksit Turk për Ushqimin i cili mbulon metodat analizuese të monitorimit të standardeve të cilësisë dhe higjienës së ushqimit, shtesave të ushqimit, materialeve aromatizuese, pesticideve dhe rregullat e ambalazhimit, magazinimit dhe avancimin e mëtutjeshëm për të siguruar përshtatje më të afërt me rregulloret e BE-së. Ky ligj ka rezultuar në krijimin e Komisionit Nacional për Kodeksin Ushqimore përgjegjësia e të cilit është të përpilojë, shqyrtojë dhe aprovojë të gjitha ndryshimet në Kodeksin Turk për Ushqimin, duke përfshirë edhe ndryshimet që ndodhin përmes harmonizimit me BE-në. Aktualisht ekzistojnë 25 nën-komitete që punojnë në revizionet specifike të aspekteve të ndryshme të Kodeksit Turk për Ushqimin.

Përveç Ligjit për Ushqimin të vitit 2004, industria turke e ushqimit dhe importet e ushqimit kryesisht janë të rregulluara nga disa ligje dhe rregullore tjera që ndërlidhen, nga të cilat më i rëndësishme është Kodeksi Turk për Ushqimin. Kodeksi Turk për Ushqimin dhe të gjitha amendamentet, rregulloret e reja, lajmërimet janë në dispozicion në uebfaqen e GDPC-së.

Përveç tjerash, materialet e papërpunuara apo gjysmë të përpunuara bimore dhe produktet nga mishi e ato të bulmetit janë subjekt i Ligjit për Karantinën e Bimëve (Ligji Nr.6968) dhe Ligjit për Shëndetin e Kafshëve (Ligji Nr. 3285). Ligji për Karantinën e Bimëve është në fuqi nga viti 1957 dhe në vitin 2003 është amandamentuar me rregullore për të siguruar harmonizim me BE-në⁴³.

Procesi i importimit

Sipas rishikimit të fundit të Kodeksit Turk për Ushqimin, certifikata e kontrollit e kërkuar më parë, nuk kërkohet për produktet bimore dhe produktet me bazë bimore, por kërkohet vetëm për produktet shtazore dhe produktet me bazë shtazore. Kërkesat për marrjen e certifikatës së kontrollit mund të ndryshojnë për produkte, por më poshtë gjendet lista me elementet bazë:

- Licenca e importit e kompletuar e cila mund të shkarkohet nga uebfaqja www.gkgm.gov.tr;
- Faturë pro forma;
- Certifikatë shëndetësore nga agjencia qeveritare për Inspektim të Ushqimit nga shteti i origjinës ku deklarohet se produkti i përmbushë kërkesat e vendit importues.
- Për produktet e gatshme për konsumatorë, kjo zakonisht është “Certifikatë e Shitjes së Lirë” që tregon se “produkti është prodhuar në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret vendore dhe është e përshtatshme për konsumin njerëzor dhe tregtohet lirshëm në vendin e origjinës”. Kjo mund të jetë problematike, pasi që FDA-ja zakonisht nuk lëshon certifikatë me pikërisht këto fjalë. Në disa raste, ky problem mund të tejkalohet duke marrë certifikatë të shitjes së lirë nga një agjenci

⁴² Shumica e rregulloreve që kanë të bëjnë me bujqësinë, ligjet, komunikatat, direktivat dhe njoftimet janë në dispozicion në uebfaqen e Drejtoratit të Përgjithshëm për Mbrojtje dhe Kontroll (GDPC) të MARA: www.kkgm.gov.tr.

⁴³Versioni i fundit i ligjit mund të gjendet në linkun: <http://www.kkgm.gov.tr/regulation/regulations.html>.

qeveritare në nivelin qendror apo atë vendor.

- Për produkte alkoolike, "certifikata e shpërndarjes" e ofruar nga kompania prodhuese për importuesin dhe/apo distributorin, e cila tregon se kompania turke është e autorizuar të tregtojë dhe shpërndajë produktin në Turqi.
- Për "ushqimet" e veçanta si ushqimet dietale, ushqimet për diabetikët, vitaminat, ushqimet për foshnje, etj., importuesi duhet ofrojë deklaratën e shkruar që produkti nuk do të reklamohet në mënyrë që do të çorientojë konsumatorin. Importuesi zakonisht do të pranojë miratimin me shkrim së bashku me një certifikatë kontrolli të aprovuar nga Autoriteti i Drejtoratit Bujqësor Provincial brenda një apo dy javëve.

Inspektimet dhe dokumentacioni doganor

Me të hyrë produkti në doganë, importuesi duhet të përgatitet për të prezantuar certifikatën e aprovuar të kontrollit si dhe dokumentet tjera të zakonshme të importit si fatura e ngarkesës, fatura origjinale dhe certifikata e origjinës. Përveç kësaj, importuesi duhet të jetë i përgatitur të prezantojë para doganës raportin analizues të kompanisë eksportuese për përmbajtjen fizike, kimike, mikrobiologjike dhe përmbajtjen e metaleve të rënda, dhe certifikatën nga agjencia zyrtare për inspektim të ushqimit nga vendi i origjinës, ku deklarohet se produkti i përmbushë kërkesat e karantinës së vendit importues. Zyrtarët e Ministrisë për Ushqim, Bujqësi dhe Bagëti (MINFAL) marrin mostra të produkteve të importuara dhe i dërgojnë në laboratorë qeveritar për analiza fizike, kimike, mikrobiologjike dhe konfirmon se rezultatet përputhen me informatat e ofruara nga vendi eksportues. Importi i gjërave ushqimore lejohet nëse zbulohet se rezultatet e analizave janë të pranueshme dhe në përputhje me kërkesat turke, dhe nëse importet janë të aprovuara nga MINFAL. Rezultatet e analizave rëndom pranohen brenda disa ditëve të punës. Nëse rezultatet e inspektimit nuk përputhen me kërkesat turke, importuesi mund të kërkojë testim të dytë të mostrave. Në rast se edhe rezultatet e testimit të dytë janë në kundërshtim me kërkesat turke të importit, dërgesa do të refuzohet nga autoritetet e MINFAL. Përveç kësaj, nëse gjërat ushqimore janë mallra të papërpunuara apo gjysmë të përpunuara, atëherë kontrollohen nga specialistët e karantinës së bimëve apo veterineri për përputhshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse.

Certifikatat e kontrollit

Shumica e importeve ushqimore dhe joushqimore kërkojnë atë që në Turqi quhet "certifikatë kontrolli". Certifikata e kontrollit është në thelb licencë importi. Ajo i jepet importuesit me zgjedhjen e zyrtarëve të importit. Sipas Komunikatës Standardizimi në Tregtinë e Jashtme të 17 janarit 2007, procesi i importit për secilin produkt fillon me aplikimin për lëshimin e certifikatës së kontrollit⁴⁴.

Të gjitha produktet ushqimore për të cilat kërkohet certifikatë kontrolli janë të listuara me kodet doganore HS në Nenin e dytë dhe të tretë të Komunikatës 2007/21 dhe në Shtojcën IV A të *Komunikatës Standardizimi në Tregtinë e Jashtme*. Këto produkte përfshijnë drithërat, produktet e industrisë së miellit, farat vajore, yndyrat bimore dhe shtazore, mbetjet, produktet e bulmetit dhe peshkut, drunjtë e gjallë dhe bimët tjera. Vetëm për disa produkte ushqimore si kafja, goma natyrale, lëngjet dhe ekstraktet bimore, dylli bimor dhe kakao nuk kërkohen certifikata kontrolli para se të importohen, por duhet të kenë dokumentet e nevojshme për t'u zhdoganuar. Produktet që nuk kërkojnë certifikatë kontrolli janë të listuara në Shtojcën IV B të Komunikatës së njëjtë. Për produktet e përpunuara, këto certifikata kërkohen për secilën dërgesë.

Së fundmi, në dhjetor 2008, *Komunikata për Standardizimin në Tregtinë e Jashtme* për Produktet e Importuara është publikuar nga GDPC. Kjo edhe më tutje ka definuar disa nga procedurat për marrjen e certifikatës së kontrollit dhe për përcaktimin e datave të skadimit për certifikatat e kontrollit. Sipas

⁴⁴Procesi është përshkruar në Komunikatën Nr. 2003/31, e cila është postuar online, në anglisht, në linkun: http://www.kkgm.gov.tr/regulation/com/Com_Ap-proval.html

kësaj, certifikatat e kontrollit janë valide për një periudhë prej 4 deri në 12 muaj, varësisht nga produkti.⁴⁵ Certifikatat e kontrollit nganjëherë përdoren si instrument për të refuzuar apo vonuar importin e disa produkteve.

Për të marrë një certifikatë kontrolli, varësisht nga lloji i produktit, dokumentet në vijim duhet prezantuar pranë Ministrive përkatëse: fatura *pro forma*, certifikatën shëndetësore, certifikatën e analizës, formulën apo listën e përmbajtjeve të produktit, certifikatën e pedigresë dhe raportin e analizës së rrezatimit. Të gjitha dokumentet të merren dhe/ose të aprovohen nga autoritetet përkatëse në vendin e prodhimit. Dokumentet duhet të jenë në gjuhën e vendit të prodhimit dhe kërkohet përkthimi i tyre në gjuhën turke. Certifikatat e kontrollit duhet të prezantohen tek Autoritetet Doganore pas importit. Periudha e vlefshmërisë së certifikatave të importit sillet prej katër deri në dymbëdhjetë muaj, varësisht nga produkti.

Etiketimi

Çdo produkt ushqimor në treg duhet të etiketohet qartë, në mënyrë të plotë dhe saktë në gjuhën turke. Megjithatë, një artikull ushqimor i importuar mund të arrijë në ambalazhin origjinal, por një etiketë “ngjitëse” e përhershme në gjuhën turke duhet t’i ngjitet në ambalazh para se produkti të plasohet në treg. Mund të ketë edhe gjuhë tjera përveç asaj turke. Zbatimi i kërkesave për etiketim shtyhet nga Ministria e Bujqësisë dhe zyrtarët lokal të komunave. Kjo rregullore përcakton në detaje se në çfarë rrethanash produkti ushqimor mund të etiketohet, për shembull, “i lehtë”, apo “pa sheqer”, apo se si duhet të deklarohen informatat për vitaminat e mineralet. Rregullorja gjithashtu specifikon se çfarë paralajmërimesh duhet të paraqiten tek përmbajtjet e caktuara.

Nëse produkti ka jetëgjatësi në raft më pak se tre muaj, atëherë duhet përfshirë ditën/muajin/vitin e skadimit. Nëse jetëgjatësia në raft është më shumë se tre muaj por më pak se tetëmbëdhjetë, atëherë kërkohen vetëm muaji dhe viti. Nëse jetëgjatësia në raft është më e gjatë se tri vite, atëherë kërkohet vetëm viti i skadimit. Në rast të pemëve apo perimeve të cilat mund të shiten në shporta apo stenda të hapura, etiketat kërkohen të vendosen në pjesën e jashtme kryesore të paketimit. Edhe një rregullore kërkon që etiketat për pije nga frutat të specifikojnë që produkti përmban lëng frutash (përqendrimi 90-100%), nektar (përqendrimi 20-50%), apo pije nga frutat (përqendrimi deri në 10%). Gjithashtu komunikata 2007/26 për pijet jo-alkoolike jep në detaje kërkesat për etiketim të lëngjeve të frutave, pijeve të aromatizuara, sirupeve, pluhurit të lëngut, ujërave minerale natyrale, pijeve të gazuara, tonikave dhe ujërave të aromatizuara.

Përpunimi i drurit

Turqia ka filluar implementimin e ISPM15 sipas standardit ndërkombëtar për ateriale Ambalazhuese nga Druri prej 1 janarit 2006. Nga ajo kohë, të gjitha materialet ambalazhuese nga druri që lidhen me Turqinë duhet të jenë tymosura, me lëvozhgë të larguar dhe të shënuara me shenjat e aprovuara ndërkombëtarisht që certifikojnë trajtimin; përndryshe mallrat ose do të kthehen prapa ose do të shkatërrohen.

Materiali ambalazhues nga druri dhe pjesët nga druri për mbështetje duhet të shënjohen në pajtueshmëri me ISPM15. Në vend të shenjës ISPM15 mund të pranohen edhe certifikatat fitosanitare, por ajo nuk lejohet që të jetë e lëshuar më shumë se 14 ditë nga dita e dërgimit të mallrave. Përndryshe, nëse data e inspektimit është cekur në certifikatën fitosanitare, atëherë periudha ndërmjet inspektimit dhe dërgimit të mallrave nuk guxon të jetë më shumë se 14 ditë.

⁴⁵Komunikata në gjuhën turke mund të gjendet në linkun: <http://www.kkgm.gov.tr/teblig/2009-5.html>

Materialet ndërtimore

Korniza ligjore në këtë fushë përbëhet nga Rregullorja për Prodhimet Ndërtimore e vitit 2002, në fuqi nga viti 2004, amandamentimet e njëpasnjëshme të saj (2 në vitin 2004, 1 në vitin 2005), dhe Komunikata për Parimet dhe Metodën për Mbikëqyrje të Tregut të Materialeve Ndërtimore, Rregullorja për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Inspektimin e Produkteve. Komunikatat implementuese vazhdimisht rishikohen në mënyrë që të mbesin në harmoni dhe të ndjekin zhvillimet e fundit të legjislacionit Evropian. Prandaj, Turqia konsideron që legjislacioni i saj është në harmoni me *acquis*. Në Turqi janë futur standardet relevante Evropiane. Ministria e Punëve Publike dhe Vendbanimeve është autoriteti kompetent përgjegjës për implementimin e mbikëqyrjes së tregut. Në mënyrë sistematike kryhen testime të mostrave të materialit të përdorur në ndërtimet e reja.

4.4. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

4.4.1. Pasqyrë politike dhe ekonomike

Me një treg përafërsisht prej 291 milion popullatë, SHBA-të e kanë ekonominë më të madhe dhe më të fuqishme në botë, me BPV për kokë banori rreth 40,000 euro. Madhësia i jep fuqinë që të ndikojë në pranimin global të gjithçkaje duke filluar me mallrat konsumuese e deri te standardet industriale, dhe i bënë ato magnet për eksportuesit anekënd planetit. Në të njëjtën kohë, SHBA-të janë furnizuesi kryesor i mallrave dhe shërbimeve si për tregjet vendore ashtu edhe për tregjet nëpër botë.

Për shkak të madhësisë dhe një game të gjerë të nevojave, SHBA-të mund të jenë një vend mjaft i përshtatshëm për një eksportues për të bërë biznes. Mirëpo të njëjtat karakteristika që i bëjnë ato tërheqëse, gjithashtu mund t'i bëjnë edhe një treg të vështirë, pasi që eksportuesit që eksportojnë në SHBA jo vetëm që duhet të konkurrojnë me njëri tjetrin por edhe me furnizuesit vendor amerikan.

Për më tepër, llojllojshmëria e madhe e segmenteve të tregut mund ta bëjnë të vështirë për eksportuesin që të përqendrohet në fushat ku kompania do të mund t'i zbatonte më së miri fuqitë e veta.

Sektorët e bujqësisë dhe industrisë përpunuese përbëjnë rreth 1%, gjegjësisht 20% të BPV-së së SHBA-ve. SHBA-të janë jo vetëm prodhuesi i tretë më i madh në botë pas Kinës dhe Indisë, por edhe fuqia kryesore industriale. Industria e shërbimeve në anën tjetër përbën pjesën më të madhe të ekonomisë së SHBA-ve – 80% e BPV-së. SHBA-të janë streha më e madhe dhe më me ndikim e tregjeve financiare në botë duke përfshirë tregjet e aksioneve dhe mallrave.

Nga data 1 janar 1994, SHBA-të janë pjesë e Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Amerikës Veriore (NAFTA) e cila përfshinë Kanadanë dhe Meksikën. E krijuar që të nxisë rritjen e tregtisë dhe investimeve në mes të partnerëve, NAFTA ka një program ambicioz për eliminimin e tarifave dhe zvogëlimin e barrierave jo tarifore, si dhe dispozita gjithëpërfshirëse për bërjen e biznesit në zona të lira tregtare. Implikimi kryesor i NAFTA-s tek eksportuesit që eksportojnë në SHBA është qasja e lirë në tregun e gjerë të Amerikës Veriore që përfshinë Kanadanë dhe Meksikën.

4.4.2. Marrëdhëniet me Kosovën

SHBA-të janë partneri më strategjik për Kosovën. Marrëdhëniet në mes këtyre dyjave janë mjaft të fuqishme dhe Kosova konsiderohet nga SHBA-të si partner i besueshëm. Që nga viti 1999 SHBA-të kanë luajtur një rol aktiv në krijimin e institucioneve vendore dhe rimëkëmbjen e ekonomisë.

SHBA-të kanë qenë përkrahësit më të devotshëm në arenën ndërkombëtare. Ato kanë ofruar mbështetje të madhe politike dhe ekonomike. Prej vitit 1999 SHBA-të kanë kontribuar me rreth 1 miliardë euro për zhvillimin e Kosovës⁴⁶.

Kosova ka mision diplomatik në SHBA dhe anasjelltas. Përveç shërbimeve tjera, ambasada e SHBA-ve në Prishtinë u ndihmon investitorëve, eksportuesve dhe bizneseve që janë të interesuara që të zgjerohen në tregun e Kosovës si dhe ofron shërbime këshilluese për biznese. Seksioni ekonomik dhe komercial i ambasadës mund të ofrojë të dhëna të hollësishme për kushtet e tregut vendor, klimën e biznesit dhe mundësitë për investim.


Oda Ekonomike Amerikane (AmCham) në Kosovë ka një anëtarësi të gjerë dhe organizon mbledhje dhe takime të rregullta me bizneset amerikane dhe jo-amerikane në kërkim të transparencës më të madhe dhe për sigurim të përfshirjes më të madhe të sektorit privat në marrjen e vendimeve dhe reformave qeveritare.

⁴⁶<http://www.state.gov/p/eur/ci/kv/c26235.htm>

Nga viti 2008, Kosova është përfshirë në Sistemin Gjeneral të Preferencave (SGjP), program ky që shkurton tarifat e SHBA-ve për shumë importe nga vendet në zhvillim, me theks të veçantë në prodhimtari të lehtë, minerale, materiale ndërtimi dhe prodhime të caktuara bujqësore. Në vitin 2012 SHBA-të e përtërinë SGjP-në për Kosovën e cila mundëson që një numër i konsiderueshëm i prodhimeve kosovare të eksportohen në SHBA pa taksa të importit.

Siç është paraqitur në Figurën më poshtë, nivelet tregtare në mes të Kosovës dhe SHBA-ve janë të ulëta, natyrisht për shkak të distancës në mes tyre. Deficiti tregtar është rritur prej vitit 2006, si pasojë e performancës së dobët të eksportit. Edhe pse kostot e transportit e bëjnë eksportin më të shtrenjtë, marrëdhëniet e fuqishme politike dhe instrumenti si SGjP-ja ofrojnë mundësi për rritje të tregut që do të mund të tërhiqeshin nga komuniteti i biznesit në Kosovë. Disa eksportues nga Kosova tashmë janë duke përfutur nga mundësi të tilla. Një shembull është prodhuesi i verës, Stone Castle, i cili eksporton në tregun e SHBA-ve, kryesisht në zonat e Nju Jorkut. Programi SGjP gjithashtu ofron një stimulim për investitorët që të prodhojnë në Kosovë dhe t'i eksportojnë prodhimet e përzgjedhura pa taksa doganore në tregun e SHBA-ve.

Figura 11. Shkëmbimi tregtar me SHBA-të 2005-2013 (në euro '000)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Investitorët e SHBA-ve tashmë janë prezent në Kosovë dhe janë të përfshirë në projekte ndërtimi, energjetikë dhe sektorë për zhvillimin e pasurisë së patundshme. Në mesin e kompanive amerikane më të njohura në Kosovë janë Bechtel-i (e përfshirë në ndërtimin e autostradës Ibrahim Rugova), Coca-Cola, FedEx, UPS, DHL, Deloitte, Booz Allen Hamilton, Microsoft, etj.

4.4.3. Pasqyrë e përgjithshme e tregut

Përpunimi i ushqimit

Tregu i ushqimit dhe pijeve në SHBA ka një vlerë prej 1,000 miliardë euro dhe është rritur me një mesatare reale vjetore për 0.5% të vlerës në 5 vitet e fundit. Industria e ushqimit dhe pijeve është mjaft e gjerë dhe komplekse, e përbërë nga zinxhirë furnizues të lidhur shumëfish. Ajo i nënshtrohet një konkurrence ekstreme dhe barriere të madhe të rregullatorit. Ky treg është mjaft i koncentruar, ku 10 kompani kryesore furnizojnë rreth 30% të tregut të përgjithshëm.

Prodhimet e freskëta kanë qenë sektori me rritjen më të lartë në 5 vitet e fundit, me rritje prej rreth 7,000 milion euro në vit, ose një mesatare vjetore reale prej 0.26%, gjatë një periudhe kohore pesë vjeçare. Prodhimet e ftohta kanë arritur një shkallë më të lartë të rritjes së mesatares vjetore rreth 2%. Importi kryesor i ushqimit dhe pijeve në SHBA janë pijet me 17%, peshku (12%), pemët (10%), kafja, çaji dhe erëzat (8%) dhe perimet (7%). Në vitin 2012 Kanadaja ishte burimi kryesor i importit për SHBA-të me 18%, e përcjellë nga BE-ja (17%), Meksika (15%), Kina (5%), Brazili (4%) dhe Tajlanda (4%). Tregu amerikan i ushqimit organik ka pësuar rritje të fuqishme gjatë viteve të fundit, me të hyra të përgjithshme prej 23 miliardë euro në vitin 2011. Ky treg parashihet të vazhdojë të ketë ngritje të madhe. Derisa interesi i konsumatorit vazhdon që të zë momentin, shumë prodhues, përpunues industrial, shpërndarës dhe shitës me pakicë amerikanë po specializojnë në rritjen, përpunimin dhe marketingun e një shkalle në zgjerim e sipër të prodhimeve organike bujqësore dhe të ushqimit.

Bujqësia

Bujqësia në SHBA është një sektor i madh, konkurrues dhe me rritje të shpejtë. SHBA-të janë njëri prej eksportuesve më të mëdhenj bujqësor në botë – eksporti bujqësor ka qenë më i madh se importi prej vitit 1960, duke gjeneruar tepricë në tregun bujqësor të vendit. Fermerët dhe firmat bujqësore amerikane me të madhe mbështeten në tregjet e eksportit për të ruajtur çmimet dhe të hyrat.

Megjithatë, importi i SHBA-ve ka pasur rritje në mënyrë të qëndrueshme, pasi që është zgjeruar kërkesa për llojllojshmëri të ushqimit. Konsumuesit amerikanë përfitojnë nga importi, pasi që importet zgjerojnë llojet e ushqimeve, stabilizojnë furnizimin gjatë tërë vitit me pemë dhe perime të freskëta, si dhe balancojnë ngritjen e çmimeve të ushqimit.

Tregu i SHBA-ve paraqet mundësi të mira për eksportuesit e prodhimeve bujqësore. Ekonomia e shtetit parashihet të zgjerohet paksa më shpejtë në vitin fiskal 2015 krahasuar me 2014 dhe përderisa shpenzimi i konsumatorit rikthehet deri në një shkallë, importet pritet të kenë ngritje. Importet bujqësore të SHBA-ve parashikohet të arrijnë shifrën rekord prej 90 miliard euro në vitin 2015, 6 miliard euro më shumë se në vitin 2014.

Rritjet në vlerën e importit priten që të ndodhin për shumicën e prodhimeve, me përfitimet më të mëdha në prodhimet e hortikulturës, sheqerit dhe prodhimeve tropikale, si dhe prodhimeve të bagëtisë. Teprica tregtare bujqësore e SHBA-ve pritet të bie për 12 miliard euro në vitin fiskal 2015, në 21 miliard euro. Kjo do të ishte teprica më e ulët prej vitit 2009.

Përpunimi i drurit

SHBA-të janë njëri ndër destinacionet më të rëndësishme në botë për eksportimin e prodhimeve të drurit, që përbënë pjesën më të madhe të eksportit për shumë shtete. Importet e prodhimeve të drurit janë rritur ndjeshëm në dekadën e fundit. Rritja e nënkontraktimit të prodhimeve dhe komponentëve gjysmë të përfunduara nga ana e industrisë amerikane të mobilie ka qenë shtytësi kryesor për këtë treg. Globalizimi e ka detyruar industrinë që të ballafaqohet me mungesë të fuqisë punëtore të aftësuar dhe kosto të larta të prodhimit. Një numër i madh i prodhuesve të mobilie në SHBA janë transformuar në fabrika montimi, linja të përfundimit ose shpërndarës dhe tregtarë të mobilie dhe komponentëve të nënkontraktuar nga Kina dhe shtetet tjera.

Tregu i SHBA-ve mund të paraqes mundësi për sektorin e përpunimit të drurit në Kosovë, pa marrë parasysh kostot e transportit që janë shumë më ta larta se sa me shtetet e BE-së. Një përpunim i drurit të cilësisë së lartë i kombinuar me çmimet konkurruese do të mund tu ofronte kompanive kosovare një qasje të mirë në tregun amerikan.

Një mundësi tjetër në zhvillim në tregun amerikan është rritja e kërkesës për materialet e kompanive të përpunimit të drurit e që kanë të bëjnë me ndërtesat e gjelbra. SHBA-të janë lider botëror në teknologjinë e gjelbër dhe ekonominë e pastër, me mundësi të ndjeshme të rritjes në të ardhmen e afërt. Meqë Kosova është në fazë fillestare të zhvillimit në sektorin e përpunimit të drurit, do të ja vlente që të eksplorohej nëse ky treg i posaçëm është i realizueshëm.

Materialet e ndërtimit

Sektori amerikan i ndërtimit ka arritur tu përballojë tronditjeve sistemike dhe të krijojë momentin pozitiv gjatë fundit të vitit 2012 deri në vitin 2013 dhe 2014. Rigjallërimi i tregut të pronave të paluajtshme po ndihmon në shtyrjen përpara të aktiviteteve të ndërtimitarisë dhe punësimit drejt një territori pozitiv, derisa përmirësimi më modest në fusha tjera, siç janë tregu i zyrave, po ndihmojnë në krijimin e një platforme të ardhme të rritjes. Vet industria e ndërtimit më në fund është duke shtuar vende pune, dhe vlera e ndërtimit që nuk ka për qëllim banimin gjatë periudhës së caktuar po rritet, me përjashtim të disa sektorëve.

Ky sektor sigurisht se është në fazën e rikuperimit dhe është përmirësuar mjaft nga nivelet e aktiviteteve që kanë qenë para vitit 2012. Ekzistojnë mundësi të mira për të eksportuar në tregun e SHBA-ve, pasi që industria e ndërtimit, ashtu siç qëndron tani, është e gatshme për rritje të vazhdueshme përgjatë vitit të ardhshëm. Kthesa pozitive në tregun e pronave të paluajtshme bashkë me përmirësimin e themeleve të tregut të punës do ta shpejtojnë fuqishëm rritjen në industrinë e ndërtimit derisa kërkesa për ndërtime të reja në sektorë tjerë po ashtu po përmirësohet. Derisa distanca gjeografike dhe kostot e transportit shfaqin një sfidë për eksportin kosovar në këtë sektor, do të mund të ketë fusha të caktuara nga të cilat do të mund të përfitohej përmes preferencave tregtare të Kosovës dhe lidhjeve nga ana e diasporës.

4.4.4. Procedurat e përgjithshme të importit

Regjimi i importit

Për cilindo subjekt, që eksporton prodhime në SHBA, duhet të plotësohen kriteret vijuese në mënyrë që të kryej zhdoganimin shpejt:

- Një individ mund t'i zhdoganojë mallrat që importohen për shfrytëzim personal apo biznes. Të gjitha mallrat që hyjnë në SHBA duhet t'i nënshtrohen procedurave doganore dhe taksave doganore përderisa nuk janë të përjashtuara nga ligji në mënyrë të posaçme. Zhdoganimi përfshinë një numër hapash: hyrjen, inspektimin, vlerësimin, klasifikimin dhe likuidimin.
- Shërbimi Doganor i SHBA-ve nuk parasheh që eksportuesi të ketë licencë apo leje. Agjencitë tjera mund të kërkojnë lejen, licencën ose certifikatë tjetër, varësisht se çka eksportohet. Licenca dhe leja mund të kërkojnë për importim të mallrave të caktuara të kufizuara, përfshirë pijet alkoolike, kafshët dhe prodhimet e kafshëve, barna të caktuara, fishekzjarrë dhe municion, perime, pemë dhe arra, mish dhe prodhime mishi, qumësht, bulmet dhe prodhime djathi, pemë dhe prodhime të pemëve, prodhime të naftës, etj.
- Formularët doganor për hyrje kërkojnë numrin e importuesit, i cili është ose numri i regjistrimit të biznesit IRS, ose në rast se biznesi nuk është i regjistruar me IRS, numrin e sigurimit social të personit.
- Importuesi duhet ta deklarojë vlerën e mallit për doganim. Vlerësimi përfundimtar kryhet nga dogana. Për të arritur te kjo vlerë përdoren disa metoda të vlerësimit. Vlera e transaksionit shërben si bazë primare e vlerësimit. Vlera e transaksionit është çmimi që blerësi ia paguan ose që duhet t'ia paguajë shitësit për mallrat e importuara. Faktorë tjerë gjithashtu mund t'i shtohen vlerës së mallit për doganim, siç janë kostoja e ambalazhimit, komisionet e shitjes, tantiema (royalty) ose

taksat e licencimit, etj. Në rast se vlera e transaksionit nuk mund të përcaktohet, atëherë vlera e mallrave të importuara që vlerësohen është vlera e transaksionit të mallrave identike. Nëse nuk mund të gjendet malli identik me mallrat e importuara, atëherë vlera është vlera e transaksionit të mallit të ngjashëm.

- Importuesi duhet ta përcaktojë numrin e klasifikimit të mallit që importohet. Programi i Harmonizimit të Tarifave i SHBA-ve, lëshuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Tregut të SHBA-ve, e përshkruan klasifikimin e mallrave sipas llojit të prodhimit; p.sh. prodhime të kafshëve dhe perimeve, fibra tekstili dhe prodhime tekstili. Importuesi duhet t'i paguaj taksat e parashikuara doganore dhe taksat e procedimit nëse ka të tilla. Dogana bënë përcaktimin përfundimtar të normës së saktë të taksës doganore. Norma e taksës së një sendi lidhet me numrin e klasifikimit. Taksat doganore në përgjithësi vlerësohen me normat *ad valorem*, një përqindje e së cilës aplikohet në vlerën e taksuar të mallrave të importuara. Disa artikuj megjithatë taksohen me normë specifike (për copë, litër, kilogramë, etj.); tjerat sipas normës së përbërë të taksës doganore (d.m.th. kombinimi i *ad valorem* dhe normave specifike).
- Nëse kërkohet hyrja formale, importuesi duhet të jap garanci.
- Importuesi është përgjegjës të sigurojë se mallrat që importohen i plotësojnë kriteret e pranimit, siç janë shënjimi i duhur, standardet e sigurisë, etj. dhe se lejet e duhura janë marrë paraprakisht, nëse ato kërkohen.

Dokumentet e doganave

Për të bërë apo paraqitur një hyrje për konsum (për mallra të importuara që shkojnë direkt në tregun e SHBA-ve pa ju vendosur ndonjë kufizim kohor ose të shfrytëzimit) në përgjithësi nevojiten dokumentet vijuese:

- Fatura e aterimit, fatura e transportit ajror, certifikata e transportuesit (duke emëruar marrësin e ngarkesës për qëllime doganore) si dëshmi që tregon se marrësi i ngarkesës ka të drejtë të hyjë;
- Fatura komerciale e marrë nga shitësi, e cila tregon vlerën dhe përshkrimin e mallit;
- Listën e mallrave për hyrje (Formularin e doganës 7533) ose Liferimin hyrës/e të menjëhershëm (Formularin e doganës 3461);
- Listat e ambalazhimit, nëse janë të përshtatshme, dhe dokumentet tjera që nevojiten për të përcaktuar nëse malli mund të pranohet.

Kur bëhet dërgimi i hyrjes së një konsumi, importuesi e tregon numrin e klasifikimit dhe paguan çfarëdo takse doganore të paraparë dhe taksë të procedimit. Mund të kërkohet edhe garanci që përmban kushte të ndryshme, përfshirë dispozitën për pagesën e çdo takse doganore të ngritur e cila mund të gjendet si borxh për tu paguar në një datë më të vonshme.

Përcaktimi i pranueshmërisë dhe ekzaminimi doganor i mallrave

Në raste të thjeshta ku përfshihen dërgesa të vogla ose klasë të caktuara të mallrave, siç janë dërgesa me shumicë, ekzaminimi mund të bëhet në liman, stacione kontejnerësh, terminale të ngarkesës apo në objekte të importuesit. Pastaj mallrat i lëshohen importuesit. Në dërgesa tjera, pako mostrash të mallrave mund të merren nga dogana për vlerësim apo klasifikim, kurse pjesa tjetër e dërgesës lëshohet. Pas ekzaminimit, këto pako të mostrave gjithashtu i lëshohen importuesit. Ekzaminimi i mallrave nevojitet të përcaktojë:

- Vlerën për doganë dhe statusin e tyre të taksës doganore.
- Nëse mallrat janë shënuar si duhet me vendin e origjinës. Mund të aplikohet shënjim apo etiketim i posaçëm. Në përgjithësi, malli i importuar duhet të shënjohet që të jetë i lexueshëm në një vend të dukshëm dhe me emrin e vendit të origjinës të shkruar në gjuhën angleze. Artikuj të posaçëm

përrjashtohen nga ky kriter.

- Nëse mallrat janë faturuar në mënyrë të saktë.
- Nëse dërgesa përmban artikuj të ndaluar.
- Nëse janë plotësuar kriteret e agjencive tjera.
- Nëse sasia e mallrave të paraqitura në faturë është e saktë, dhe se nuk ka mungesë apo tepriçë të mallrave.

Nëse është e nevojshme, mallrat mund të analizohen nga një laborator i doganës për të përcaktuar klasifikimin dhe vlerësimin e duhur, për të përcaktuar se mallrat i plotësojnë kriteret e sigurisë, apo për tu siguruar se ato nuk janë në kundërshtim apo shkelin ligjet e SHBA-ve. Nëse dogana përcakton se mallrat janë të ndryshme nga përshkrimi i futur në sasi apo vlerë, se klasifikimi i mallrave nuk është i saktë dhe se aplikohet normë e ndryshme e taksës doganore nga ajo e paraqitur nga importuesi, atëherë mund të konstatohet rritje e taksës doganore. Nëse dogana përcakton se importuesi në mënyrë të qëllimshme nuk e ka bërë klasifikimin dhe vlerësimin e duhur të mallrave, ky i fundit do të mund të gjobitet me të holla apo dënim tjetër. Kur të jenë marr të gjitha informatat, duke përfshirë raportin e specialistit të doganës për import lidhur me vlerën doganore të mallrave, si dhe raportin e laboratorit, nëse kërkohet, bëhet përcaktimi përfundimtar i taksës doganore dhe hyrja likuidohet. Në këtë kohë, kthehet çfarëdo pagese më e madhe se taksa doganore ose faturohet nëse pagesa ka qenë me e vogël.

4.4.5. Kriteret teknike dhe të ambientit të sistemit të importit

Rregulloret teknike, vlerësimi i standardeve dhe konformitetit

Për kategori të caktuara të mallrave dhe shërbimeve ekzistojnë kriteret të përcaktuara përkitazi me importimin apo shitjen e tyre në SHBA. Këto kriteret janë të përcaktuara në ligjet e qeverisë dhe/ose rregulloret e nivelit federal, shtetëror apo lokal.

Në nivelin federal, ekziston një kriter i politikave rregullative në kuadër të Zyrës për Menaxhim dhe Buxhet (OMB) për të shikuar përdorimin e standardeve dhe që ato të përdoren kur kjo të arrijë objektivat rregullative⁴⁷. Standardizimi ndihmon që të sigurohet se mallrat e importuara i plotësojnë kriteret e SHBA-ve dhe e bënë më të lehtë eksportin në tregun e SHBA-ve.

Vlerësimi i konformitetit

Vlerësimi i konformitetit ndihmon që të sigurohet se prodhimet dhe shërbimet i kanë karakteristikat e kërkuara, dhe se këto karakteristika kanë vazhdimësi nga prodhimi në prodhim dhe shërbimi në shërbim. Vlerësimi i konformitetit përfshinë marrjen e mostrave, testimin, inspektimin, certifikimin dhe regjistrimin e vlerësimin e sistemit të cilësisë dhe të ambientit. Ai gjithashtu përfshinë akreditimin e kompetencës së këtyre aktiviteteve nga një palë e tretë dhe njohja (zakonisht nga një agjenci qeveritare) e akreditimit të mundësisë së programit.

Departamenti i tregtisë⁴⁸ është përgjegjës për të siguruar njohjen dhe përdorimin e standardeve të njohura ndërkombëtare. Ai gjithashtu punon me agjenci tjera të qeverisë së SHBA-ve dhe qeveri tjera për të zgjidhur problemet që kanë të bëjnë me qasjen në treg e që janë të ndërlidhura me standardet ndërkombëtare⁴⁹.

Kriteret për etiketim dhe shënjim

Krahas kërkimit të licencës për lloje të ndryshme të importit, disa agjenci të SHBA-ve kanë rregulla të posaçme për shënjim dhe etiketim. Në rast se dërgesat e mallrave nuk janë në pajtueshmëri me to,

⁴⁷ Më shumë informata mund të merren në pjesën e Çështjeve rregullative të OMB-së në faqen e internetit www.whitehouse.gov/omb/inforeg

⁴⁸ www.commerce.gov

⁴⁹ Informata për standardet e SHBA-ve për zhvillim dhe iniciativat rregullative të SHBA-ve mund të merren nga organizatat vijuese: Instituti Amerikan i Standardeve Kombëtare (ANSI) është organizatë private jo-profitabile e cila administron dhe koordinon sistemin vullnetar të SHBA-ve për vlerësim të standardizimit dhe konformitetit. (www.ansi.org)

Instituti Kombëtar për Standarde dhe Teknologji (NIST) është agjenci federale jo-rregullative në kuadër të Departamentit të Shteteve të Bashkuara për Administrimin e Tregtisë Teknologjike. NISTI- zhvillon dhe promovon matjen, standardet dhe teknologjinë për avancimin e produktivitetit të SHBA-ve dhe lehtësimin e tregtisë. (www.nist.gov)

mallrave të eksportuara mund tu ndalohe kalimi i kufirit. Nga agjencia e dedikuar mund të merren informata specifike për prodhime specifike si dhe shënjimin dhe etiketimin që kërkohet për to. Çdo gjë që importohet në SHBA duhet të etiketohet me vendin e origjinës, që duhet të jetë e lexueshme⁵⁰.

Hollësitë lidhur me llojet, madhësitë dhe lokacionin gjenden në rregulloret e FDA-së të cilat përmbledhen si në vijim. Me disa përjashtime, nëse etiketa e ushqimit paraqitet në gjuhë të huaj, etiketa duhet të përmbajë të gjitha formulimet e kërkuara në gjuhën e huaj dhe në atë angleze. Nëse ushqimi është i ambalazhuar, të dhënat vijuese duhet të paraqiten në etiketë në gjuhën angleze:

- Emri i rrugës, adresa, qyteti, provinca, kodi postar (prodhuesit, shpërndarësi ose ambalazhuesi).
- Deklarim i saktë i vlerës neto të ushqimit në ambalazh. Për disa prodhime të ambalazuara në lëngjeqë nuk konsumohen si ushqim kërkohet pesha e drenazhuar e jo pesha neto.
- Emri i zakonshëm i ushqimit duhet të paraqitet në panelin kryesor të produktit me shkronja të trasha dhe me vija paralele me bazën e ambalazhit.
- Përbërësit e një ushqimi duhet të paraqiten sipas emrit të zakonshëm ose të rregullt në radhitje duke marrë parasysh peshën.
- Informatat ushqyese duhet të ofrohen në etiketë për pothuajse të gjitha ushqimet e ambalazuara që kanë për qëllim t'i shiten konsumatorit.

Rregulloret e ambientit

Janë disa ligje dhe rregullore që trajtojnë kriteret e importit dhe eksportit për materialet të cilat mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe ambientin. Agjencia për Mbrojtjen e Ambientit (EPA) punon me shtetet, agjencitë tjera federale dhe qeveritë e huaja për të siguruar përputhshmëri me ligjet që udhëheqin importin dhe eksportin e disa prej këtyre materialeve.

4.4.6. Kriteret e sektorit

Përpunimi i ushqimit dhe bujqësia

Departamenti i Shteteve të Bashkuara për Bujqësi (USDA), Shërbimi për Inspektimin e Shëndetit të Kafshëve dhe Bimëve (APHIS) rregullojnë futjen e prodhimeve të caktuara bujqësore në SHBA. Departamenti i SHBA-së për Sigurinë e Atdheut, Doganat dhe Mbrojtja e Kufirit (CBP) i zbaton rregulloret e APHIS në portet e hyrjes. Specialistët e CBP-së për bujqësi inspektojnë dërgesat e prodhimeve të importuara dhe sigurojnë që lejet e kërkuara, certifikatat sanitare (për prodhime të kafshëve) dhe certifikata fitosanitare (për prodhime bimë) t'i jenë bashkëngjitur secilës dërgesë. APHIS i rregullon bimët dhe kafshët, si dhe të gjitha prodhimet që derivojnë nga bimët dhe kafshët. Për shembull, farërat për mbjellje dhe farërat që përdoren për sende dekorative artizanale që të dyja janë çështje të rregulluara.

Për t'i futur në SHBA në mënyrë të ligjshme, madje edhe prodhimet e përpunuara dhe ambalazuara për qëllime komerciale, mund të nevojitet leja apo dokumentacioni nga vendi i eksportit, duke certifikuar se prodhimet i plotësojnë standardet e SHBA-ve për shëndetin e kafshëve dhe të bimëve.

Importuesit gjithashtu duhet ta kenë parasysh se në kohë të caktuara disa prodhime nga vende apo rajone të caktuara nuk mund të importohen fare për shkak të pranisë së murtajës dhe sëmundjeve.⁵¹ Baza e të dhënave ua mundëson konsumatorëve që të kërkojnë për pemë dhe perime sipas prodhimit apo vendit, që ofron një mënyrë të shpejtë dhe të lehtë për shfrytëzuesit që të përcaktojnë kriteret themelore të hyrjes për prodhimet e tyre specifike.

⁵⁰ Informata të hollësishme rreth etiketimit mund të gjenden në Zyrën e Shteteve të Bashkuara për Dogana dhe Mbrojtjen e Kufirit, faqja e publikimeve www.cbp.gov/xp/cgov/newsroom/publications/trade (dokumenti i titulluar "Shënjimi i vendit të origjinës"). FTC, www.ftc.gov, ofron informata rreth etiketimit, duke përfshirë kriteret e Aktit për paketim dhe etiketim të drejtë të SHBA-ve.

⁵¹ Informatat e deritanishme rreth kriterëve të përgjithshme për import të bimëve dhe produkteve të bimëve të caktuara mund të gjenden në bazën e të dhënave të APHIS-it për Kriteret e importit të frutave dhe perimeve www.aphis.usda.gov/favir/.

APHIS-i gjithashtu rregullon importimin e bimëve dhe prodhimeve të bimëve, përfshirë bimët për mbjellje (d.m.th. sera për kultivim dhe farëra); prodhimet bujqësore (d.m.th. lëndë druri, pambuk dhe lule të prera); sende të punuara me dorë nga pjesët e bimëve (d.m.th. shportat); bimët dhe prodhimet e bimëve (d.m.th. orkidetë); dhe speciet e bimëve që janë të kërcënuara dhe në rrezik. Për të importuar pemë dhe perime, bimë, farëra dhe prodhime të bimëve të huaja, një importues duhet të aplikojë për leje të importit bujqësor pranë APHIS-it dhe të marrë certifikatën fitosanitare nga vendi që eksporton. Certifikatat fitosanitare vërtetojnë se zyrtarët për mbajtjen në karantinë të bimëve nga vendi që eksporton i kanë ekzaminuar bimët para eksportit nëse kanë murtajë apo sëmundje.

APHIS-i gjithashtu rregullon importimin e mishit, prodhimet dhe nën-prodhimet e kafshëve, si dhe kafshët e gjalla në mënyrë që të sigurohet se në SHBA nuk futen sëmundje ekzotike të kafshëve. Prej vendeve që kanë sëmundje ekzotike të kafshëve mund të kërkohet leja e veterinarisë për importim mishi dhe prodhime mishi të caktuar (p.sh. pitet me mish dhe ushqimi i përgatitur), shpezë, qumësht, vezë dhe prodhimet e bulmetit (përveç gjalpfit dhe djathit) në mënyrë që ato të mund të futen në SHBA. Leja mund të nevojitet edhe për importimin e prodhimeve ushqimore që përmbajnë sasi të vogël mishi, shpezë ose përmbajtje të përpunuar të prodhimeve të vezës.

Dy organe rregullative mbikëqyrin sigurinë e ushqimit dhe pijeve në SHBA. Tetëdhjetë për qind e furnizimit me ushqim udhëhiqet nga Administrata e Ushqimit dhe Barnave (FDA) e cila mbron kundër falsifikimit të ushqimit dhe etiketimit. Departamenti i shteteve të Bashkuara për Bujqësi (USDA) jep llogari për njëzet përqindëshin tjetër dhe mbikëqyrë (mishin e lopës, qengjit dhe derrit), shpezëve, vezëve dhe prodhimeve të prodhuara nga to.

FDA-ja kërkon etiketimin e ushqimit për shumicën e ushqimeve të përgatitura, siç janë bukët, drithërat, ushqimet e konservuara dhe të ngrira, zamrat, desertët, pijet, etj. Etiketimi i ushqimit për prodhimet e pa gatuar (pemë dhe perime) dhe peshk është vullnetar. Ligji thotë se informata e kërkuar e etiketës duhet të vendoset në atë mënyrë që të jetë lehtë e lexueshme si dhe që konsumatori i rëndomtë të mund ta lexojë dhe kuptojë sipas kushteve të zakonshme të blerjes dhe përdorimit.

Rregulloret e FDA-së për etiketimin e ushqimit përfshijnë kritere që kanë të bëjnë me deklaratat obliguese të shumicës së informatave që gjenden në etiketat e ushqimit, siç janë deklarata e identitetit, sasia neto, përbërësit, vlerat ushqyese, rreziqet për alergji, dhe etiketat për deklarimet e ushqimit. Deklarimet për vlerat ushqyese duhet të jenë në pajtim me kriteret mjaft specifike të ndërlidhura me formatimin, emrat e lëndëve ushqyese dhe sasisë dhe kalkulimet e përqindjes së vlerës ditore. Prodhuesit e huaj të ushqimit dhe pijeve që i nënshtrohen kriterëve të Objektit për Regjistrimin e ushqimit të FDA-së duhet gjithashtu ta emërojnë një agjent amerikan për qëllime të FDA-së. Agjenti amerikan i FDA-së vepron si pikë primare kontakti i FDA-së për prodhuesin e huaj të ushqimit apo pijeve.

Shërbimi i Sigurisë së Ushqimit dhe Inspektimit i USDA-së rregullon importimin e mishit, shpezëve dhe prodhimeve të vezëve të dedikuar për konsum nga njerëzit. Kur të eksportohen në SHBA, për këto prodhime kërkohet një certifikatë e shëndetit që i plotëson kriteret e APHIS-it për shëndetin e kafshëve si dhe kriteret e FSIS-it për shëndetin publik.

Përpunimi i drurit

Departamenti i SHBA-ve i Shërbimit për Inspektimin e Shëndetit të Kafshëve dhe Bimëve Bujqësore (APHIS) rregullon importimin e drurit dhe prodhimeve të drurit. APHIS-i kërkon që druri dhe prodhimet e drurit t'i nënshtrohen procedurave të caktuara fitosanitare para se të bëhet importimi me qëllim të eliminimit të rrezikut të futjes së mortajave dhe sëmundjeve të huaja në SHBA. Ekzistojnë dy mundësi për trajtimin e drurit dhe prodhimeve të drurit. Trajtimi i nxehjes përfshinë përdorimin e furrës tharëse

ose nxehjen e thatë, siç është tharësja me mikrovalë. Trajtimi kimik përfshin përdorimin e pesticideve sipërfaqësore, prezervativëve ose tymosjen me metil bram. Leja për import të lëndës së drurit apo prodhimeve të lëndës së drurit duhet t'i bashkëngjitet secilës dërgesë së drurit. Leja e përcakton edhe trajtimin e nevojshëm.

Si eksportuesit ashtu edhe importuesit përballen me kritere shtesë në rast se druri gjendet në listën e rregulloreve të ndërlidhura me Konventën për Tregtinë Ndërkombëtare në Speciet e Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES). Speciet e lëndës së drurit që gjenden në listën e rregulloreve të CITES-it parashohin disa apo të gjitha nga pikat vijuese para hyrjes në SHBA:


- Lejen e përgjithshme (e vlefshme për dy vite) lëshuar nga USDA;
- Certifikatat e lëshuara nga organizata përfaqësuese e CITES-it në vendin eksportues ku thuhet se prodhimi nuk e dëmton mbijetesën e asaj specie dhe se mostra nuk ishte marrë në kundërshtim me ligjet e atij shteti për mbrojtjen e faunës dhe florës;
- Certifikatat e lëshuara nga organizata përfaqësuese e CITES-it në SHBA;
- Arritja në portin hyrës të SHBA-ve të autorizuar për pranim të dërgesave nga lista e CITES-it.

5. PROFILET E SEKTORIT

5.1. Bujqësia dhe Përpunimi i ushqimit

Me më shumë se 50% të popullatës që jeton në zona rurale, përpunimi i ushqimit bujqësor luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës.⁵² Pjesëmarrja e bujqësisë në BPV është rreth 15% dhe kontributi i saj në punësim është më i lartë se cilido sektor tjetër. Edhe pse prodhimi bujqësor dhe eksporti kanë pasur ngritje të qëndrueshme në dekadën e fundit, bilanci tregtar i bujqësisë është përkeqësuar për shkak të shkallës në rritje të importit. Figura më poshtë paraqet nivelet e importit, eksportit dhe bilancin tregtar për bujqësinë dhe prodhimet e përpunimit të ushqimit nga viti 2011 deri 2013.

Figura 12. Importet dhe eksportet e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore në Kosovë, 2010 – 2013 (në euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Në vitin 2013 eksportet bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit kanë qëndruar në vlerën rreth 35 milion euro, që përbën 4% të importeve gjegjëse. Derisa eksporti i përgjithshëm i Kosovës është rritur për rreth 100 milion euro ndërmjet viteve 2007 dhe 2013, eksportet bujqësore gjatë kësaj periudhe janë rritur vetëm për 2 milion euro. Këto shifra tregojnë dobësitë konkurruese të bujqësisë së Kosovës dhe prodhimeve agro-përpunuese dhe pamundësisë së tyre që të konkurrojnë me tregjet e huaja.

Figura më poshtë tregon eksportet bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit sipas kategorisë së prodhimeve për periudhën 2011-2013. Përmes kësaj tabele, është e lehtë që të vërehet se kategoritë e prodhimeve të cilat Kosova eksporton më së shumti janë pijet, perimet, pemët dhe arrat.

⁵²Këto pjesë janë nxjerrë nga një numër i dokumenteve strategjike për industrinë e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit në Kosovë: "Plani për zhvillimin e bujqësisë dhe rural 2010-2013" dhe "Raporti i gjelbër 2013" nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, "Strategjia për mundësitë e bujqësisë në Kosovë" nga USAID-i Kosovë.


Tabela 1. Vlerat e eksportit bujqësor dhe të ushqimit 2011-2013, (në euro)

Grupi i prodhimit	2011	2012	2013
Bagëti	104,109	65,201	-
Mishi dhe organet e ngrënshme	14,428	4,594	23,230
Peshk, kërmijtë, kurrizorët tjerë të ujit	57,919	120,180	-
Prodhimet e bulmetit, vezët, mjalti	289,378	137,919	135,687
Prodhimet me origjinë të kafshëve	-	-	-
Pemë, bimë, lule	8,460	11,853	93,730
Perime dhe disa perime rrënjore dhe arra tokësore	2,642,205	2,873,952	2,641,513
Pemë dhe arra	1,676,847	1,500,337	2,142,454
Kafe, çaj, erëza	573,009	717,204	1,371,330
Drithëra	120,143	78,808	32,341
Prodhime industriale të përziera, nisheste	7,256,078	8,315,908	8,447,686
Vaj i kuzhinës, drithëra të ndryshme, farëra, pemë, bimë kurative, sanë, foragjere	488,993	607,340	690,895
Materiale lidhëse, rrëshirë dhe ekstrakte tjera	381	-	7,800
Material për mbjellje të pemëve, prodhime të pemëve	381	-	-
Yndyrë dhe vajra	-	47,788	45,936
Gatime mishi, peshku, kërmijsh dhe kurrizorë tjerë të ujit	45,140	6,255	102,046
Sheqer dhe ëmbëlsira	140,660	137,276	170,528
Kakao dhe gatime nga kakao	294,864	1,391,888	1,803,095
Gatime nga drithërat, mielli, nisheste	704,969	690,420	1,021,262
Perime, pemë dhe arra të gatuar	2,853,816	2,439,489	1,598,762
Gatime të ndryshme të ushqimit	139,373	164,436	167,489
Pije, pije të ftohta, pije alkoolike, uthull	8,105,752	10,040,081	13,352,191
Foragjere ushqim për kafshë	697,786	898,655	1,089,705
Duhan dhe zëvendësues	-	69,115	87,971
Gjithsej	26,214,691	30,318,697	35,025,651

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Siç është paraqitur në figurën 13 më poshtë, eksportet bujqësore janë më të suksesshme në rajonin e (CEFTA-s) dhe më të dobëta në tregun më të gjerë të BE-së (eksporti bujqësor në raport me importin është posaçërisht i ulët për tregtimin me BE-në dhe është përkeqësuar në vitet e fundit), që tregon se prodhuesit kosovarë të sektorit të bujqësisë nuk po përfitojnë nga kushtet për qasje të favorshme në treg të ofruara nga BE-ja. Raporti i eksportit me import në Kosovë është më i lartë me CEFTA-n se sa me BE-në (natyrisht kjo për shkak se tregu i BE-së është më konkurrues se sa tregu i CEFTA-s). Shumica e eksportit bujqësor të Kosovës shkon në shtetet e CEFTA-s (rreth 80%), në kohën kur vetëm rreth 40% e importeve bujqësore kanë origjinë nga shtetet e CEFTA-s. Në bujqësi, Kosova ka bilanc tregtar pozitiv vetëm me Shqipërinë. Bilanci tregtar është posaçërisht negativ me Serbinë dhe IRJM-në, që paraqet një import të ndjeshëm bujqësor nga këto dy shtete.


Figura 13. Struktura gjeografike e eksporteve të bujqësisë dhe prodhimeve ushqimore në Kosovë, (mesatarja 2011 – 2013)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Siç tregon Figura 14, pjesëmarrja e eksportit të “Bujqësisë dhe ushqimit” në eksportin total gjatë periudhës 2011-2013 ka qenë rreth 10%. Kjo pjesëmarrje ka qenë në një ritëm të ngadalshëm rritjeje gjatë viteve të fundit, që demonstiron disa përmirësime në sektorët e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit krahasuar me fushat tjera të ekonomisë.

Figura 14. Pjesëmarrja e sektorit të bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit në totalin e eksportit 2011 – 2013 (në euro)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Analiza tregon se Kosova nuk ka përfituar nga mundësitë për qasje në treg të mundësuar falë mekanizmave të tregut të lirë në të cilat ka aderuar. Pjesa e mbetur do të përqendrohet më shumë në disa nën-sektorë bujqësorë përmes një vlerësimi të potencialeve për eksport në disa prodhime bujqësore dhe agro-përpunuese.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), gruri dhe misri janë drithërat kryesore në Kosovë si për nga zonat e kultivuara ashtu edhe për nga prodhimi. Në kuadër të grupit të foragjereve sana (livadhe) dhe jonxha kanë zonat më të mëdha dhe prodhimin më të madh. Perimet më të rëndësishme janë fasulja (posaçërisht si drithëra e përzier me misër), patatja, speci, qepa dhe shalqiri. Në kategorinë e drunjve frutorë, mollët dhe kumbullat përbëjnë zonat më të mëdha të kultivuara.

Gruri është drithi kryesor që zë 20-25% të tokës dhe mbulon rreth 2/3 të kërkesës së Kosovës. Shumica e fermave prodhojnë në nivel ekzistence për nevoja të veta familjare. Çka e vështirëson konkurrencën e grurit është çmimi mesatar i prodhimit i cili në fermat komerciale është relativisht i lartë prej 10 deri 12 centë/kg. Ushqimi kryesor i kafshëve është sana që zë rreth 77,000 ha, e përcjellë nga jonxha (alfalfa) që zë rreth 15,000 ha. Gjedhet dhe derrat kryesisht ushqehen në stalla, kështu që kostoja për prodhimin e ushqimit ka ndikim të madh në koston e përgjithshme të prodhimit të mishit të gjedhit, qumështit dhe mishit të derrit. Sa i përket foragjeres, vlera e tyre e ulët dhe sasisë së mjaftueshme nënkupton se ekziston konkurrencë e vogël prej importit. Përmirësimi i prodhimtarisë së ushqimit mund të ketë efekt të ndjeshëm në konkurrencën e bagëtisë. Teknologjitë e reja si bërja e silazhit janë duke u promovuar aktivisht dhe po e fitojnë hapin. Nëse kostot e ushqimit do të mund të zvogëloheshin, atëherë kjo do të kontribuonte në përmirësimin e konkurrencës së prodhimit të bagëtisë, e cila në anën tjetër do të kishte efekte pozitive në eksportin e bagëtive dhe djathërave.

Prodhimi i pemëve dhe perimeve ka potencial të madh në Kosovë, bazuar në një sistem relativisht të mirë të ujitjes dhe qasjes në ujë. Një madhësi e vogël e tokës nuk është pengesë serioze për prodhimin e hortikulturës, edhe pse mungesa e një mase kritike të prodhuesve të organizuar posaçërisht për përpunimin e drithërave mund të jetë pengesë. Prodhimi i perimeve është i koncentruar në rajonin e Rahovecit dhe Vitisë, kurse prodhimi i pemëve është më i paguar. Ajo çka e bënë hortikulturën tërheqëse janë fitimet e larta për hektarë dhe një gamë e madhe e drithërave që mund të kultivohen. Konkurruesi kryesor në rajon është IRJM-ja, e cila furnizon një pjesë të tregut rajonal gjatë sezonit së korre shirjeve në Kosovë.

Zonat me sera ende janë të vogla – sipas anketave të MBPZhR-së rreth 185 ha. Prodhime më të mëdha dhe sezona të zgjatura e në këtë mënyrë edhe çmime më të mira do të arriheshin nëse të lashtat do të rriteshin në poli-tunele dhe sera. Kosova gjithashtu mund të prodhojë edhe pemë, arra dhe fruta të buta dhe të konkurrojë me importin, nëse do t'i kushtohej më shumë vëmendje cilësisë, ruajtjes dhe krijimit të furnizimit lokal. Organizimi i marketingut prej shumë fermave të vogla është sfidë e madhe. Potenciali për eksport dhe lidhja me përpunues në vendet fqinje është mundësi e mirë që duhet të përcillet dhe mbështetet nga institucionet.

Në kategorinë e rrushit të tryezës, Kosova me sukses mund të konkurrojë dhe eksportojë sasi më të mëdha se sa është duke eksportuar tani. Kjo dëshmohet më rritjen e varieteteve të tryezës të cilat po mbillen. Varietetet e verës varen nga tregu i eksportit për të mbajtur zonën e prodhimit aktual, pasi që kërkesa vendore është shumë e vogël prej 5 litra për kokë banori në vit. Afërsisht gjysma e rrushit për verë të kultivuar konsumohet në ferma dhe shndërrohet në "verë lokale" ose raki. Vera është prodhim në të cilën Kosova aktualisht ka bilanc tregtar pozitiv dhe nëse ruhet cilësia dhe rritet sasia, Kosova do të ketë shanse të mira që të rrisë eksportin në mënyrë të ndjeshme.

Aktivitetet tjera bujqësore me potencial për zëvendësim importi me eksport përfshijnë mbledhjen e të lashtave nga pyjet dhe kullotat e papërpunuara (barishte), rritjen e çajit, barishtet, kërpudhat dhe

zbukurimet. Këto aktivitete po i përgjigjen kërkesës së tregut dhe po ndihmojnë në zëvendësimin e importit. Barishtet mjekësore tashmë janë duke u eksportuar dhe ekziston potencial për rritje të tregut për shumicën e këtyre të lashtave.

Tanimë në shumë shtete tregu për të lashta organike/që kultivohen në mënyrë natyrore është duke u rritur. Këto prodhime kryesisht korren në sasi të vogël, që është situatë e përshtatshme për fermerët kosovarë. Tregu botëror për prodhime organike është në rritje dhe paraqet mundësi të mira për prodhuesit kosovarë.

Për shkak të përbërjes gjeografike Kosova gjithashtu ofron kushte mjaft të mira për blegtori. Edhe pse ende është duke përjetuar një proces rikuperimi të bagëtisë, ky sektor ka arritur shumë hapa përpara gjatë viteve të fundit – si në numra ashtu edhe në prodhim. Aktualisht pengesa më e madhe me të cilën ballafaqohen kompanitë kosovare për përpunimin e mishit është rihapja e tregjeve për eksport. Bazuar në lokacionin e vet gjeografik të Kosovës dhe afërsinë me shtetet që nuk janë anëtare të BE-së, siç janë Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Turqia, për fillim do të duhej ndërmerrej një qasje pragmatike afat-shkurtër për tu përqendruar në eksportimin e mishit në këto destinime, me mundësi të zgjerimit në tregjet e BE-së në fazën tjetër.

Prodhimi i qumështit në nivelin e fermës është konkurrues, mirëpo duhet përmirësuar cilësinë. Kostot e grumbullimit janë shumë të larta dhe prodhimi duhet të koncentrohet në zvogëlimin e kostove të grumbullimit. "Qumështi i freskët" ka potencial që të jetë prodhim i mirë krahasuar me atë nga importi, mirëpo duhet të forcohet akoma më shumë zinxhiri ftohës në mënyrë që të arrihet besim më i madh nga ana e konsumatorit. Prodhimi i prodhimeve të bulmetit mund të jetë konkurrues në tregun rajonal, mirëpo kërkon përmirësim të cilësisë në nivelin e fermës dhe fabrikës.

Shumica e mishit të gjedhit të prodhuar në Kosovë është prodhim që rrjedh nga prodhimi në bulmetore. Për momentin është duke konkurruar me mishin e freskët të gjedhit që importohet nga rajoni me çmim të lirë, ose atë të ngrirë të importuar nga SHBA-të dhe Amerika Jugore. Gjodhet duket se ushqehen në stalla, që është një sistem ushqimi me kosto më të lartë se sa shfrytëzimi i fushave të gjera më barë (i kufizuar në Kosovë për shkak të fermave që janë me madhësi të vogla). Përmirësime të caktuara të kullotave dhe zhvillimit të foragjereve mund të përmirësojnë konkurrencën dhe do të hapnin mundësi më të mëdha për eksport. Kosova është relativisht konkurruese dhe është në gjendje të prodhojë qengja të cilësisë së mirë për tregun ndërkombëtar, mirëpo çmimet në Kosovë janë relativisht të larta dhe duhet të ulen në mënyrë që të rritet konkurrenca. Disa qengja veç se janë shitur në Bosnje dhe ka potencial të mirë për gjetjen e rrugëve drejt tregut të BE-së.

Edhe pse prodhimi i mishit të pulës ballafaqohet me konkurrencë për shkak të mishit të importuar me çmim mjaft të lirë (d.m.th. Brazili dhe SHBA-të), ka pasur përparim në rritjen e pjesëmarrjes së prodhimit vendor përmes tregimeve të suksesit siç është rasti i "Konsonit". Tregu për mishin e pulës të prodhuar në vend ka qenë i kufizuar kryesisht si pasojë e kostos më të lartë të prodhimit vendor. Në rast se do të mund të uleshin kostot e prodhimit vendor, do të mund të kishte potencial për eksport. Si hap i parë do të ishte e arsyeshme që eksportuesit kosovarë të testonin tregjet rajonale (që janë më pak konkurrues) para se të përqendroheshin në tregun e gjerë global. Prodhimi i vezëve ka qenë i suksesshëm në Kosovë, ku prodhimi vendor ka arritur 75% të kërkesës së brendshme. Kosova ka përjetuar prodhim stabil me një konsolidim përgjatë kohës dhe parashikimet për eksport janë të mira.

Aktivitetet tjera që mund të kenë potencial për eksport janë tregjet e fushave të caktuara siç janë prodhimi i mjaltit, kërmijve, lepujve, etj. Shpesh këto ofrojnë potencial për të ardhura të mëdha. Mjalti është shumë i vlefshëm dhe mund të ketë shumë potencial, megjithëse çmimet e prodhimit aktualisht janë të larta krahasuar me çmimet në tregjet botërore.

Sektori i agrobiznesit dhe përpunimit të ushqimit është tradicionalisht njëri nga sektorët më të fuqishëm në ekonominë e Kosovës. Gjatë dekadës së kaluar përpunimi i ushqimit në Kosovë ishte në rrugë të rimëkëmbjes. Ekziston një numër i madh i industrive të ushqimit në Kosovë me një potencial të mirë tregu, që u ofron investitorëve potencial qasje të menjëhershme te furnizuesit e prodhimeve primare, kapitalit themelor të trashëguar, mundësi teknike dhe parashikime premtuese të tregut. Stimulimet doganore dhe të taksave i nënvizojnë mundësitë që janë në dispozicion në Kosovë në këtë fushë biznesi. Gjithashtu duke marrë parasysh çmimet e ulëta të prodhimeve primare kjo fushë është mjaft fitimprurëse dhe ka potencial për shtrirje në tregjet e huaja.

Mullinjtë për bluarjen e miellit dhe bukëpjekësit që prodhojnë prodhime të freskëta kanë pasur sukses ndërsa që edhe sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve gradualisht janë shfaqur si sektore me të ardhme. Përpunuesit e qumështit, të cilët fillimisht prodhojnë qumësht të freskët të pasterizuar, janë zhvilluar. Tani ekzistojnë edhe përpunues të qumështit që ka afat më të gjatë të përdorimit. Tentativa për të qenë konkurrues në tregun e djathit ka qenë më e vështirë. Thertoret dhe përpunimi i mishit po fitojnë përparësi krahas kompanive të vogla që therin kafshët në pjesën e pasme të oborrit pa u inspektuar. Industritë tjera janë krijuar si përgjigje ndaj kërkesës vendore dhe që të futen në konkurrencë me importin; siç është prodhimi i lëngjeve të pemëve dhe pijeve freskuese. Disa prej këtyre industrive megjithatë nuk varen nga prodhimi i fermës lokale sa i përket burimit të lëndës së parë.

Përveç prodhimit të verës (të përmendur më lartë), Kosova ka mundësi të mira për prodhimin dhe eksportimin e pijeve tjera siç janë pijet freskuese dhe birra. Tashmë ekziston një numër i kompanive që janë aktive në tregjet vendore dhe ato eksportuese dhe të cilat po tentojnë ta zgjerojnë prodhimin e tyre përmes investimit në “fusha të gjelbra” si dhe marrëveshje partneriteti me investitorë ekzistues. “Birra Peja” tashmë ka marrëveshje me distributorë në Shqipëri, Mal të zi, Serbi dhe IRJM ku synon t’i rrit shitjet dhe të jetë e plasuar mirë.

Shumica prej këtyre bizneseve ballafaqohen me konkurrencë të madhe nga prodhimi i importuar që ka çmim të lirë. Ekziston potencial i dukshëm për zëvendësimin e disa prej këtyre importeve si dhe që të fitohet pjesëmarrje në tregun e rajonit dhe më gjerë përmes eksportit, mirëpo kjo kërkon furnizim të mjaftueshëm me lëndë të parë vendore e cila do të kishte çmim konkurrues. Marrëveshjet për tregti të lirë u japin mundësinë përpunuesve që të gjejnë lëndë të parë në shtetet fqinje si dhe fermerëve që të shesin prodhimet e përpunuara jashtë Kosovës. Standardet e BE-së po bëhen normë në rajon kështu që është qenësore që të jepen stimulime për futjen e tyre në një mënyrë të rregulluar dhe kosto-efektive.

5.2. Materialet ndërtimore

Sektori i materialeve ndërtimore përbëhet nga të gjitha kompanitë që janë të përfshira ose në prodhimin e materialeve ndërtimore ose në furnizimin me to. Këtu përfshihen prodhuesit e çimentos, kornizave të dritareve dhe dyerve, armaturës, struktura të parafabrikuara, tulla dhe pllaka, material kulmi, materiale hidraulike, etj. Fatkeqësisht ka mungesë të informatave që janë në dispozicion lidhur me këtë sektor në Kosovë; shumë pak studime/raporte, edhe pse të vjetruara, janë aktualisht në dispozicion. Megjithatë një vlerësim bazik për disa sektorë në rajonin e Kosovës jugore, ku përfshihet edhe materiali i ndërtimit, ishte kryer nga UNDP-ja në vitin 2013. Ky vlerësim bazik ka treguar se aktualisht ky sektor po zgjerohet në rajonin jugor. Kjo mund të shihet edhe nga trendi në rritje i vendeve të punës në këtë sektor në jug.⁵³


Marrë parasysh nevojën për ndërtimin e vendbanimeve të reja dhe infrastrukturës rrugore, industria e ndërtimit në përgjithësi në vitet e fundit është bërë njëri nga sektorët më të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Aktualisht afro 40% e materialeve të ndërtimit po prodhohen në vend dhe kjo po luan një rol të rëndësishëm në zëvendësimin e importit. Megjithatë me rritjen e ekonomisë në mënyrë të qëndrueshme është rritur edhe importi.⁵⁴ Për më tepër, të dhënat e vitit 2008 tregojnë

⁵³Vlerësimi bazik i ekonomisë së rajonit jugor, 2014, UNDP (f. 40).

se materiali ndërtimor përbën 32.3% të prodhimit industrial. Sa i përket punësimit, në vitin 2008 ky sektor ka përfshirë më shumë se 22% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në industrinë e Kosovës. Edhe sa i përket produktivitetit, materiali ndërtimor është sektori udhëheqës i cili përcillet nga metalurgjia dhe përpunimi i metalit.⁵⁵

Statistikat tregtare të nxjerra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (shih Figurën 13) tregojnë se ekziston një deficit i lartë tregtar në sektorin e materialit ndërtimor në Kosovë. Të dhënat janë nxjerrë për periudhën 2011-2013 për 14 kode të identifikuara 4,6 dhe 8 HS (çimento, tulla, blloqe dhe pllaka, dyer, dritare, prodhime të qeramikës, etj.). Gjatë tre viteve të fundit mesatarisht 94 milion euro të materialeve të ndryshme ndërtimore ishin importuar. Në anën tjetër, Kosova kishte eksportuar përafërsisht 4 milion euro mesatare gjatë periudhës së njëjtë. Në kuadër të sektorit të materialit ndërtimor, importi dhe eksporti i çimentos dhe prodhimeve tjera të çimentos e kanë dominuar këtë sektor, që përbën rreth 47% të vëllimit të importeve dhe 36% të eksporteve.

Figura 15. Importet dhe eksportet e materialit ndërtimor në Kosovë, 2011 – 2013



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Çimento dhe artikujt e saj përbëjnë rreth gjysmën e materialeve ndërtimore të eksportuara në vitin 2013. Dyert, dritaret dhe kornizat e tyre përbënin 37% të eksportit të përgjithshëm të këtij sektori në atë vit. Lista e materialeve ndërtimore më të eksportuara për periudhën 2011-2013 jepet në detaje në tabelën 2.

⁵⁴Përmbledhja e kuartalit ekonomik të Kosovës 2009 që gjendet në http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/1438973-1257960498774/22387507/QEB_2009_1_Exports_and_Imports_2005_2009_Final.pdf

⁵⁵Mustafa M., Zogaj A., and Abdixhiku L. (2010). Sfidat e riindustrializimit në Kosovë (2010)


Tabela 2. Vlerat e eksportit të materialeve ndërtimore sipas kategorive të prodhimit 2011 – 2013 në Euro

Kategoria e prodhimit	2011	2012	2013
Çimento dhe artikuj tjerë të çimentos	1,405,129	438,675	2,770,672
Tulla, blloka dhe pllaka	66,092	47,576	16,484
Struktura dhe pjesë të strukturave (d.m.th. ura dhe pjesë të urave, kulme, etj.)	538,239	357,327	1,003,783
Dyer, dritare dhe kornizat e tyre prej druri	184,108	187,649	210,142
Dyer, dritare dhe kornizat e tyre prej alumini	44,116	64,315	100,887
Dyer, dritare dhe kornizat e tyre prej hekuri apo çeliku	30,456	31,652	34,414
Dyer, dritare dhe kornizat e tyre prej plastike	835,884	1,436,315	1,849,986
Gjithsej	3,104,024	2,563,509	5,986,368

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Partnerët kryesor tregtar të Kosovës në këtë sektor janë shtetet anëtare të CEFTA-s dhe shtetet e BE-së (më shumë se 95% e shkëmbimeve tregtare në këtë sektor). Gjatë tre viteve të fundit importi i materialeve ndërtimore ka pas origjinë nga shtetet tjera anëtare të CEFTA-s duke përbërë një mesatare prej 61%, nga shtetet e BE-së (përfshirë edhe Zvicrën) 38% dhe vetëm 1% nga pjesa tjetër e botës. Në anën tjetër struktura e eksportit gjatë tre viteve të fundit ka qenë goxha e ngjashme; mesatarisht 48% të eksportit të materialeve ndërtimore kishin për destinacion rajonin (shtetet anëtare të CEFTA-s), 51% në shtetet e BE-së dhe vetëm 1% është eksportuar në shtete tjera. Figura më poshtë përshkruan strukturën gjeografike të eksportit të materialeve ndërtimore në Kosovë.


Figura 16. Struktura gjeografike e eksportit të materialeve ndërtimore në Kosovë, (mesatarja 2011 – 2013)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Pjesëmarrja e eksportit të materialeve ndërtimore në eksportin e përgjithshëm të Kosovës është mjaft e ulët. Materialet ndërtimore përbënin vetëm 2% të eksportit të përgjithshëm në vitin 2013 dhe për më pak se 1% gjatë dy viteve të mëhershme (shih Figurën 17). Një pjesëmarrje kaq e ulët do të mund t'i atribuohet rolit të zëvendësimit të importit në sektorin e materialeve ndërtimore në Kosovë që përritet çdo ditë e më shumë.


Figura 17. Pjesëmarrja e sektorit të materialeve ndërtimore në eksportin e përgjithshëm



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Edhe pse diferenca në mes të eksportit dhe importit të materialeve ndërtimore mbetet e lartë, trendi duket premtues. Vlen të theksohet se deficit tregtar me partnerët më të mëdhenj tregtar, BE dhe CEFTA, është duke u ngushtuar. Në vitin 2013 raporti eksport-import me BE-në dhe CEFTA-n ishte 6%, gjegjësisht 7% (shih Figurën 18).

Figura 18. Raporti eksport-import i materialeve ndërtimore sipas partnerëve/tregjeve tregtare (2011 – 2013)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014


5.3. Përpunimi i drurit

Sektori i përpunimit të drurit në Kosovë konsiderohet të ketë potencial për zhvillim pasi që ekziston lëndë e parë për këtë sektor. Zona pyjore në Kosovë është mjaft e qëndrueshme me afërsisht 481,000 ha (44.7% e territorit të përgjithshëm).⁵⁶

Sektori i përpunimit të drurit ka qenë relativisht i suksesshëm krahasuar me sektorët tjerë. Raporti i fundit i UNDP-së, i bazuar në të dhënat e anketës nga ky sektor (periudha 2011-2012), sugjeron se ky sektor ka rritje të qëndrueshme sa i përket fitimit, rezultatit, punësimit dhe eksportit.

Në bazë të të dhënave të zbërthyera vjetore për periudhën 2011-2013, eksporti i prodhimeve të përpunuara të drurit tregon një trend pozitiv. Vlera nominale e këtyre eksporteve ka qenë rreth 0.9 milion euro në vitin 2011 dhe ka kapërcyer në 1.3 milion dhe 1.4 milion euro gjatë dy viteve në vazhdim. Ky trend pozitiv konfirmohet edhe përmes shqyrtimit të të dhënave mujore më të fundit të vitit 2014, sipas së cilave eksporti në këtë sektor nga muaji janar-korrik 2014 ishte rritur për 18% në krahasim me një vit më parë.

Figura 19. Bilanci tregtar i sektorit të përpunimit të drurit (2011-2013)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Tregjet kryesore për eksportimin e prodhimeve të drurit nga bizneset kosovare mund të segmentohen në tri grupe kryesore: CEFTA, BE dhe shtete tjera. Figura në vijim jep një pamje për ndarjen e eksporteve të sektorit të drurit në këto tri grupe.

⁵⁶MBPZhR (2013) Inventari kombëtar i pyjeve të Kosovës 2012. Gjetet në: <http://www.nfg.no/userfiles/file/Kosovo/Kosovo%20National%20Forest%20Inventory%202012.pdf>

Figura 20. Struktura gjeografike e eksportit të sektorit të përpunimit të drurit në Kosovë, (mesatarja 2011 – 2013)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Një shqyrtim më i hollësishëm i eksportit të sektorit sipas shteteve ofron disa të gjetura interesante. Në kuadër të grupeve kryesore, d.m.th. CEFTA dhe BE, ekziston një shpërndarje asimetrike e eksporteve. E para, janë Mali i Zi, IRJM-ja, Shqipëria dhe Serbia brenda CEFTA-s që gjatë kësaj periudhe kanë pasur eksport të përbashkët prej afërsisht 1 milion euro duke ngritur kështu shifrat më lartë; e dyta, Zvicra dhe Gjermania në kuadër të BE-së, që gjatë kësaj periudhe janë karakterizuar me eksport prej 1.8 milion euro dhe afërsisht 1 milion euro respektivisht.

Prodhimet kryesore të eksportit gjatë periudhës trevjeçare (2011-2013) janë paraqitur në tabelën vijuese:


Tabela 3. Vlerat e eksportit të përpunimit të drurit sipas kategorive të prodhimit 2011 – 2013 në euro

Kategoria e prodhimit	2011	2012	2013
Tavolina për zyre me korniza druri	380	529	2,684
Orendi të drurit për zyre (përfshijë tavolinat dhe ulëset)	-	331	9,141
Sirtarë të drurit për zyre	11,583	3,893	4,975
Mobilie të drurit për zyre (përfshijë sirtarët)	600	439	18,730
Njësi të pajisura të kuzhinës	24,956	27,441	290,322
Orendi të drurit të llojit që përdoren në kuzhina (përfshijë ulëset dhe njësitë e pajisura të kuzhinës)	38,334	94,335	215,844
Mobilie druri për dhoma të fjetjes (përfshijë ulëset)	107,270	220,227	357,432
Mobilie druri për dhoma të ushqimit dhe të ditës (përfshijë ulëset)	519,307	584,011	160,579
Orendi druri për dyqane (përfshijë ulëset)	77,110	80,254	2,972
Orendi druri (përfshijë ato për zyre apo dyqane, kuzhina, dhoma të ushqimit, dhoma të ditës, dhoma të fjetjes dhe ulëset)	1,474	5,259	315,497
Pjesë të orendive të drurit, (përfshijë ulëset)	116,767	353,759	35,446
Gjithsej	897,781	1,370,478	1,413,621

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Ngjashëm me materialet e ndërtimit, hapësira në mes të eksportit dhe importit të prodhimet e përpunimit të drurit është duke u ngushtuar lehtësisht, edhe pse mbetet e lartë. Eksportet si me BE-në ashtu edhe me CEFTA-n janë duke u rritur derisa importi ka ngelur pothuajse konstant apo madje është zvogëluar. Në vitin 2013 raporti i eksport-import me BE-në dhe CEFTA-n ishte 26%, gjegjësisht 7%, krahasuar me vitin 2011 kur ky raport ishte 14% gjegjësisht 3% (Figura 21).

Figura 21. Raporti i eksport/import i materialeve për përpunimin e drurit sipas partnerëve/tregjeve (2011 – 2013)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

5.4. Zejet artizanale

Në shumicën e shoqërive që janë të zhvilluara ekonomikisht zejet artizanale paraqesin një lidhje me historinë e shtetit gjegjës. Kjo lidhje shpesh komercializohet dhe për zejet artizanale krijojnë një sektor, i cili për nga ana ekonomike është plotë energji. Megjithatë pika kryesore e shitjes për këtë sektor është atraktiviteti që në mënyrë të barabartë i tërheqë si blerësit vendor ashtu edhe ata të huaj.

Në anën tjetër, te shoqëritë të cilat janë më pak të zhvilluara ekonomikisht zejet artizanale mbeten një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë ekonomike, jo domosdoshmërisht i mbështetur në joshjen nostalgjike të prodhimit.⁵⁷ Raporti konstaton se zanatet si thurja me grep, qëndisja, trikotazhi dhe thurja, thurja e qilimave, druri, prodhimet organike tradicionale dhe punët e dorës kanë paraqitur gjëra të cilësisë së lartë (natyrisht disa më shumë se tjerat), por ende ekziston nevoja për përmirësim dhe kreativitet të mëtejshëm. Njëri prej sugjerimeve është kombinimi i disa zanateve në një prodhim final i cili do të plasohet në treg më lehtë, p.sh. grupi që thur do të mund të koordinohet me grupin që shet perime turshi që të thurte copëza të vogla për të mbështjellë kavanozat gjë e cila do të ndihmonte në bërjen e marketingut për turshitë duke vënë në spikamë ndjenjën autoktone të prodhimit final, kurse personat që thurin do të mund të komercializojnë zanatin e tyre.

Marrë parasysh nivelin paksa të ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës, posaçërisht në krahasim me shtetet tjera evropiane, ndërlidhja ekonomike me zejet mbetet mjaft e fuqishme. Shkathtësitë e zejtarëve janë përcjellë nga një gjeneratë te tjetra dhe mbeten mjaft të pranishme në jetën e kosovarëve. Numri i subjekteve që kryejnë artizanat sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (paraqitur sipas shkurtesës në gjuhën shqipe ARBK) është 98.⁵⁸ Shpërndarja gjeografike e këtyre subjekteve gjithashtu shtrihet përgjatë komunave jugore të Kosovës.

Është theksuar se ka shumë vështirësi që të gjenden të dhëna dytësore lidhur me këtë sektor, pasi që Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk mbledhë apo paraqet asnjë të dhënë për këtë sektor

⁵⁷Me këtë perspektivë, duhet të shikohet edhe raporti i Caroline Winckel, "Zanatet në Kosovë" i cili është bazuar në "Panairin e trashëgimisë kulturore dhe punëve të dorës 2013" (gjendet <http://www.culture-ks.org/pdf/rapport-anglais-kosovo1.pdf>).

⁵⁸Nuk ka kategori të veçantë "Zanatet artizanale", për këtë arsye numri paraqet shumën e kompanive që: presin monedha, prodhojnë stoli ari dhe argjendi, aksesore, orëndreqës dhe dyqane të specializuara (me kode gjegjëse të aktivitetit 3211, 3212, 3213, 4778 dhe 9525)

individualisht. Kështu që çfarëdo raporti që ka për qëllim të ofroj një profil për këtë sektor duhet kryesisht të mbështetet në të dhënat primare. I njëjti rast ka qenë edhe me raportin për Vlerësimin bazik të ekonomisë së rajonit të jugut të përpiluar dhe publikuar nga UNDP-ja në vitin 2014. Raporti e paraqet sektorin e zejeve artizanale të komunave jugore bazuar në një anketë sipas mostrave të 49 kompanive të intervistuar.


Të gjeturat e raportit në këtë pjesë, sipas mostrave, tregojnë se kompania më e vjetër është 113 vjeçare, ndërsa shumica e kompanive janë krijuar pas vitit 1999. 7 nga 49 kompani të intervistuar janë ndërmarrje mikro (me 9 apo më pak punëtorë) dhe dy kompanitë e mbetura janë 1 e madhësisë së vogël gjenerojnë deri 10,000 euro ose më pak). Nga këto mostra vetëm 11 kompani janë anëtarë të ndonjë lloj shoqate.

Në faqen hyrëse të shoqatës së artizanëve dhe biznesmenëve të Prizrenit thuhet se prej 4900 bizneseve të regjistruara në këtë komunë, 2200 kanë të bëjnë me artizanat.⁵⁹ Në një kohë gjatë historisë (1870) kanë ekzistuar më shumë se 60 lloje të aktiviteteve artizanale që kanë operuar në Prizren. Madje edhe tani artizanati gjeneron goxha aktivitete ekonomike por sikurse në sektorët tjerë të ekonomisë, bilanci tregtar është mjaft negativ. Bazuar në shifrat e ofruara nga Dogana e Kosovës për vitet 2011 dhe 2012, Kosova ka eksportuar 213,211 euro, gjegjësisht 600,536 euro. Kjo tregon një rritje të madhe të potencialit eksportues nëse shprehet në terma relativ, pasi që shuma e eksportuar në vitin 2012 është trefish më e lartë se në vitin paraprak.

Duhet të potencohet se prodhimet ishin identifikuar sipas sistemit të harmonizuar 8 shifror që i takon kategorisë së zanateve artizanale.

Sa i përket eksportit, BE-ja dhe CEFTA janë tregjet kryesore, të cilat së bashku përbëjnë 96% të eksportit të përgjithshëm të këtij sektori, siç është paraqitur në diagramin më poshtë.

Figura 22. Struktura gjeografike e eksportit të sektorit të artizanatit në Kosovë, (mesatarja 2011 – 2013)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Tregjet kryesore për eksportimin e artizanateve, sipas të dhënave të përmendura më lartë, janë Gjermania me pjesëmarrje të përmblodhur prej 22% gjatë dy viteve, e përcjellë nga Zvicra me 20%, Shqipëria me 15% dhe Mali i Zi me 12 %. Kjo gjetje e mbështet intuitën se shtetet perëndimore, ku jeton shumica e diasporës, janë tregje të rëndësishme për prodhimet kosovare.

Prodhimi kryesor, që llogaritet të përbëjë më shumë se gjysmën e eksportit në secilin vit, është radhitur me kodin 8 shifror "94036090: orendi tjera druri", që mbështet pasqyrimin e këtij raporti lidhur me sektorët e drurit dhe mobilie.

⁵⁹Shoqata e Zejtarëve dhe Biznesmenëve në Prizren <http://www.shzap.org/artikulli.php?id=1>

Paraqitja grafike e eksportit të artizanateve në vitet 2011 dhe 2012 shpie në dy observime kryesore. I pari, artizanët dhe artizanet kosovare duket se kryesisht eksportojnë në shtetet fqinje (Shqipëria, Mali i Zi, IRJM-ja dhe Serbia); dhe i dyti, eksportet kryesore që e kanë arritur kulmin e afro 160,000 euro në vitin 2012 kryhen në shtetet e Evropës perëndimore, ku është e koncentruar diaspora kosovare.

Të dyja observimet e mbështesin argumentin e paraqitur në paragrafët hyrës të kësaj pjese se zanatet artizanale paraqesin një ndërlidhje me historinë e një territori apo shoqërie të caktuar. Observimi i parë, eksportim më i madh në shtetet fqinje, tregon 'preferencën' e qartë për prodhime kosovare në Shqipëri krahasuar me tri shtetet tjera fqinje. Kjo është e pritshme sepse përkatësia etnike e shumicës së popullatës që jeton në Shqipëri dhe Kosovë është shqiptare, dhe duke pasur histori dhe zakone të njëjta ka sjellë edhe eksport më të madh në mes tyre.

Observimi i dytë e mbështet argumentin e njëjtë se shumica e diasporës kosovare është e koncentruar në dy shtetet që tregojnë kërkueshmëri më të madhe për prodhime artizanale kosovare, d.m.th. Gjermania dhe Zvicra. Mund të konstatohet se pjesa kryesore e të ardhurave nga eksporti i mjeshtërive artizanale në këto dy shtete rrjedh prej kosovarëve që jetojnë dhe punojnë atje. Kështu që kjo gjetje e mbështet mendimin se artizanët dhe artizanet kosovare duhet ta shfrytëzojnë diasporën kosovare duke përdorë komunitetet e tyre si platformë prej së cilës do t'i prezantonin dhe reklamonin prodhimet e tyre.

5.5. Turizmi

Kosova ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit si; ecja verore dhe vizita në bjeshkë, sportet dimërore, kultura, përvojat rurale, shërbimet shëndetësore dhe kuruese, eskursionet dhe rekreacionet, alpinizmi, paraglajdingu, shpeleologjia, gjuetia dhe peshkimi, turizmi për konferenca dhe transit. Eko-turizmi dhe agro-turizmi gjithashtu paraqesin potencial të madh për Kosovën.⁶⁰

Këto janë disa prej atraksioneve natyrore dhe kulturore nga të cilat ndërmarrësit mund të përfitojnë duke zhvilluar iniciativat e tyre turistike:

- Atraksionet natyrore siç janë Gryka e Rugovës, "Burimi i Drinit të Bardhë me Ujëvarat dhe Shpellën e fshatit Radavc", Shpella e Gadimes, Kanionet dhe Parku i Mirushës, parku Nacional "Bjeshkët e Nemuna", Parku i Dragashit, Malet e Sharrit, Parku Pishat e Decanit, Parku Ravani, "Burimi i Istogut", Liqeni i Radoniqit e shumë të tjera;
- Komplekset shëndetësore dhe të rehabilitimit siç është "Banja e Pejës" me burim të ujit termik më cilësor në Kosovë;
- Qendra pushimi dhe sportive, siç është parku i Brezovicës dhe Qendra e skijimit;
- Monumentet kulturore si tregjet e vjetra, shtëpitë tradicionale (kullat – p.sh. "Kulla e Haxhi Zekës"), xhamitë dhe kishat, banjat publike (hamamet – p.sh. "Hamami i Haxhi Beut"), urat e vjetra të gurit dhe mullinjtë e vjetër, veçanërisht në Pejë, Gjakovë, Deçan dhe Junik;
- Zbulimet arkeologjike të epokave ilire dhe romake në Siparunt, Dresnik, Rakosh, etj.;
- Muzetë rajonal etnografik në Pejë dhe Gjakovë;
- Kostumet tradicionale, artizanat (filigran), stoli, vegla, qepje me dorë, gdhendje në dru, pjesë metali dhe terakote, porcelan, përpunim tradicional i gurit dhe drurit dhe ndërtimi i objekteve tradicionale;
- Trashëgimia kulturore si muzika, folklori burimor, festivalet kulturore, lojërat tradicionale të Rugovës, etj.
- Panaiet në Pejë dhe Gjakovë dhe festivalet e filmit dhe artit (d.m.th. festivali i filmit Dokufest në Prizren), etj.
- Mikpritja, ritualet dhe zakonet, ceremonitë dhe mënyra e jetesës në zonat rurale dhe urbane;
- Tregjet tradicionale të hapura të ushqimit dhe ato të artizanatit që ofrojnë përvojë unike të blerjes dhe 'suvenire' nga artizanët e vjetër, veçanërisht në Pejë dhe Gjakovë.


⁶⁰ Për më shumë informata rreth turizmit në Kosovë shiko faqen e internetit të Departamentit të Turizmit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës: <http://www.mti-ks.org/en-us/Department-of-Tourism-and-Hotel>.

Siç ka treguar përvoja e shteteve tjera, sektori i turizmit zhvillohet gradualisht dhe ndërtohet mbi themelet e një rrjeti të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla të koordinuar mirë me mikpritje dhe fjetje e mëngjes për familje, operatorë turistik (shoqata dhe agjenci turistike) dhe individë si udhërrëfyes dhe përkthyes. Agjencitë turistike të cilat tashmë janë aktive në Kosovë duhet ta zgjerojnë rrezet e veprimit dhe t'i reklamojnë shërbimet e tyre më me efikasitet edhe përtej Kosovës, posaçërisht duke shfrytëzuar rrjetet e diasporës. Ato gjithashtu duhet të lidhen në mënyrë më efektive me ofruesit e shërbimeve dhe operatorët turistik në Kosovë si dhe të zhvillojnë oferta tërheqëse dhe të integruara të përshtatura sipas interesave dhe nevojave të grupeve të caktuara të turistëve. Përmirësimet në shërbimet komunale, transport publik, infrastrukturë, prodhime ushqimore dhe tregti janë qenësore pasi që ato kanë ndikim indirekt në industri.

Si një destinacion i vetëm, Kosova do ta ketë shumë të vështirë që të promovojë dhe zhvillojë turizmin. Përvoja ka treguar se për shtetet që kanë kushte të ngjashme me Kosovën bashkëpunimi me iniciativat rajonale turistike dhe pjesëmarrja në pako më të gjera të shërbimeve turistike do të ishte strategjia më e mirë. Kjo nuk nënkupton se Kosova duhet vetëm të promovojë integrimin e turizmit në strukturat rajonale. Kjo gjithashtu nënkupton se ndërmarrësit individual apo grupet e operatorëve duhet të synojnë integrimin e shërbimeve dhe prodhimeve të tyre në rrjetin rajonal. Kosova do të përshtatej mirë në një rrjet rajonal turistik që do të mund të mbulonte Ballkanin perëndimor ose Evropën jug-lindore.

Ashtu siç është raportuar nga UNDP-ja përmes profilit të sektorit⁶¹, aktualisht shumica e turistëve vijnë nga Shqipëria, Sllovenia, Kroacia, Gjermania, SHBA-ja, Turqia dhe shtetet tjera të BE-së (shih tabelën 23 më poshtë).

Figura 23. Numri i vizitorëve të huaj sipas shtetit të origjinës për vitet 2008 – 2012 (8 shtetet kryesore)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

⁶¹ Profili i sektorit të turizmit, Publikim i UNDP-së. Mars 2014.

Numri i vizitorëve është rritur gradualisht dhe trendi duket i mirë. Për shembull një studim ka raportuar se vetëm nga Shqipëria rreth 3,700 persona kanë hyrë në Kosovë gjatë një ditë (maj 2013). Profili i sektorit të turizmit i UNDP-së ka raportuar një rritje të qëndrimeve për një natë ndërmjet viteve 2008 dhe 2012 siç është paraqitur në figurën më poshtë.

Figura 24. Numri i vizitorëve (vendor dhe të huaj) dhe qëndrimet e tyre për një natë gjatë viteve 2008 – 2012



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

Sipas disa parashikimeve shumica e vizitorëve që vijnë nga Shqipëria në Kosovë i vizitojnë vendet në Kosovën perëndimore, sidomos Grykën e Rugovës si dhe vendet tjera kulturore dhe përkujtimore në rajon. Në dy vitet e fundit ka raporte se Kosova perëndimore po i tërheqë turistët jo vetëm nga shtetet fqinje dhe diaspora, por gjithashtu edhe nga shtetet jo-tradicionale si Hungaria dhe Polonia, madje edhe Japonia.

Një lloj tjetër turizmi të cilin me sukses do të mund ta promovonte Kosova brenda rajonit është turizmi kulturor. Gjatë viteve të fundit Kosova ka krijuar përvojë të mirë me këtë lloj turizmi. Siç është përmendur në një anketë të UNDP-së, 10,000 njerëz kanë marrë pjesë në festivalin Dokufest të edicionit të vitit 2013 të organizuar në Prizren, ku 23% nga numri i përgjithshëm i mysafirëve ishin vizitorë të huaj. Hulumtimi i kryer nga Instituti GAP gjatë edicionit të 10 të këtij festivali (2011) ka nxjerr në pah se ndikimi ekonomik i Dokufestit në BPV ishte 3.1 milion euro, derisa ky numër ishte parashikuar të jetë 21.9 milion euro pas periudhës katër vjeçare.

Implikimet praktike të kësaj janë se operatorët dhe agjencitë turistike do të duhej t'i përqendronin përpjekjet e tyre nëpërmjet një strategjie tri degësh: i) të përfitojnë në mënyrë të plotë nga mundësitë rajonale duke vënë objektivin në mënyrë më agresive të tregjet e fqinjëve me paketa dhe oferta të përshtatura nevojave dhe preferencave të tyre; ii) të integrojnë shërbimet me operatorët rajonal dhe kompanitë transportuese në rrjetet dhe klientelën e tyre të krijuar duke tërhequr turistët e tyre në 'shëtitje të zgjeruara' në Kosovë; dhe iii) shfrytëzimi i diasporës së madhe të Kosovës për të arritur segmente më të pasura të tregut turistik, posaçërisht në BE dhe SHBA.

Kjo kërkon nga ndërmarrësit që operojnë në sektorin e turizmit që të përmirësojnë paketat dhe ofertat e tyre si në aspektin e cilësisë ashtu edhe në atë të çmimit. Masa të tilla kërkojnë investime të mëtutjeshme për krijimin e shërbimeve dhe objekteve të reja, si dhe rehabilitimin, rekonstruktimin dhe konservimin e objekteve ekzistuese. Për më tepër, masa të tilla do të mund të përqendroheshin në marketing më të mirë, këshillim dhe shkëmbim informatash që kanë të bëjnë me atraksionet natyrore dhe vendet dhe objektet e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu është e rëndësishme të përmirësohet koordinimi i investimeve nga sektori privat, duke përfshirë shërbimet turistike të operatorëve dhe shërbimet mikpritëse. Shërbimet turistike të operatorëve duhet të fuqizohen akoma më shumë pasi

që aktualisht numri i tyre është mjaft i kufizuar dhe numri i agjencive turistike të drejtuara nga jashtë është më i madh.

Është me rëndësi të nënvizohet se kushtet e sektorit të turizmit në Kosovë janë mjaft të favorshme për zhvillimin e objekteve të vogla mikpritëse dhe atyre që udhëhiqen nga familjarët “fjetje & mëngjes” si dhe promovimin e eko-turizmit dhe agro-turizmit. Megjithatë kjo nuk i len anash edhe qendrat më të mëdha turistike, posaçërisht ato të ndërlidhura me turizmin dimëror në lokacionet e përshtatshme malore të rajonit, siç janë zona e Brezovicës dhe Grykës së Rugovës.

Kutia 1: Çështjet për tu konsideruar për zhvillimin e biznesit të turizmit

Biznesi i turizmit është një lloj tepër i veçantë i biznesit, i cili dallon nga llojet tjera të biznesit në sajë të kriterëve dhe mënyrës së operimit. Disa prej gjërave unike rreth zhvillimit të turizmit janë:

- Objektiva e tregut është shumë më e vështirë për tu përcaktuar për shkak të ndryshimeve të trendeve.
- Biznesi varet nga sezonaliteti i kërkesës lartë dhe ulët).
- Biznesi varet nga kushtet atmosferike.
- Biznesi varet nga pritjet e ndryshme të klientëve.
- Zhvillim afatgjatë i tregut. Shumë pak biznese turistike të reja e arrijnë kapacitetin maksimal të shfrytëzimit në vitet e para të tyre.
- Kosto fikse të larta. Shumë biznese turistike e kanë komponentin e koston fikse të lartë.
- Natyrë bashkëpunuese e konkurrencës. Meqenëse bizneset e turizmit shpesh gjenden në rajone të destinuara për turizëm, ato shpesh punojnë së bashku për të promovuar destinacionin e tyre.
- Stimulim të lartë të kapitalit. Shumë biznese të turizmit kërkojnë investime të mëdha kapitale.

Disa prej këtyre karakteristikave paraqesin sfida të cilat duhet të tejkalohen nga ndërmarrësit me qëllim të zhvillimit të suksesshëm të aktiviteteve. Ndërmarrjet e suksesshme të kësaj fushe zakonisht bazohen në plane të biznesit të menduara dhe përgatitura me kujdes. Nevojitet një plan i biznesit që merr parasysh sfidat dhe paraqet një sërë veprimesh të cilat duhet trajtuar në mënyrë që të ofrojë sqarime dhe që tu ndihmojë ndërmarrësve gjatë procesit të vendimmarrjes. Disa prej elementeve kyçe që zakonisht janë pjesë e planit të biznesit në sektorin e turizmit janë paraqitur më poshtë.

Si hap i parë, ndërmarrësi duhet të vlerësojë fizibilitetin e idesë së biznesit të tij/saj. Procesi për përcaktimin e fizibilitetit të një projekti paraqitet më poshtë:

- Ideja e biznesit duhet të jetë e kristalizuar dhe e qartë sa i përket furnizimit aktual të tregut, kërkesës dhe trendit. Duhet të identifikohen konsumatorët si edhe nevojat e tyre, ku gjenden ata dhe çka kemi në dispozicion për t'i plotësuar nevojat e tyre.
- Ideja e biznesit duhet të zhvillohet sipas një koncepti të biznesit që përcakton projektin e posaçëm për zhvillimin e turizmit që ka për objektiv konsumatorët dhe që përfshinë analizë të tregut dhe analizë financiare, lokacionin potencial, qasjen dhe ofron analizë për vendin. Në mënyrë që të jetë i suksesshëm, zhvillimi i turizmit duhet të ketë një vlerësim pozitiv në

të gjitha këto komponentë.

- Në fazën tjetër, duhet të zhvillohet një projekt gjithëpërfshirës i planit ku përfshihet plani i marketingut, plani i biznesit dhe plani i konceptit fizik. Projekti i planit është përmbledhje e të gjitha vlerësimeve dhe do të jetë bazë për të marrë aprovimin nga autoritetet për zhvillim dhe burimet financiare.
- Pastaj duhet të merren miratimet dhe licencat e nevojshme nga autoritetet rregullative qendrore dhe lokale.
- Në fazën e fundit duhet të sigurohen fondet sipas planit të biznesit dhe mandej fillon zbatimi.

Si hap i dytë, ndërmarrësi duhet të kryej analiza për kërkesën përmes së cilës ai/ajo e identifikon llojin e klientëve që janë objektiv sipas idesë së biznesit. Secili vizitorë është në kërkim të një përvoja ideale të ndryshme dhe ka preferenca specifike për llojin e akomodimit, shërbimet e ushqimit, rekreacionit e kështu me radhë. Për këtë arsye ekzistojnë shumë mënyra për të ndarë tregun e turizmin në nën-grupe. Është me rëndësi që të identifikohen grupet (segmentet) që do të blinin prodhimin apo shërbimin në fjalë. Qëllimi kryesor i analizës së kërkesës është që të kuptohet qartë tregu përkitazi me këto çështje:

- Kush janë klientët/konsumatorët që janë cak i biznesit (mosha, të ardhurat, gjendja martesore, edukimi dhe mënyra e jetesës).
- Sa pritet të jetë numri i tyre.
- Çka u intereson atyre.
- Prej nga vijnë.
- Pse udhëtojnë.
- Kur udhëtojnë.
- Ku udhëtojnë dhe sa shpesh.
- Si udhëtojnë.
- Sa është fuqia e tyre shpenzuese dhe si i shpenzojnë të hollat e tyre.
- Sa ka është i rëndësishëm çmimi për ta.

Si hap i tretë, ndërmarrësi duhet të kryej analiza për furnizimin përmes së cilës vlerëson furnizimin ekzistues të shërbimeve dhe objekteve turistike. Analiza e furnizimit shërben për të përcaktuar:

- Cilat janë objektet konkurruese në atë zonë tregu?
- Cilat janë normat aktuale të shfrytëzimit apo banimit për operatorët si gjatë sezonit ashtu edhe jashtë tij?
- Çfarë pjese e tregut synohet dhe pritet të bëhet për vete?

6. SHËNIME PËRMBYLLËSE

Siç u vërejt nga ky raport, Kosova ka kaluar një rrugë të gjatë për t'u integruar në tregjet rajonale dhe botërore përmes marrëveshjeve për tregti të lirë me CEFTA-n, BE-në, Turqinë dhe SHBA-në. Kjo ka krijuar mundësi të mira për prodhuesit kosovarë që të fitojnë qasje në tregje të mëdha dhe të arrijnë miliona konsumatorë potencial për prodhimet e tyre. Një rol të madh në promovimin e produkteve kosovare në tregjet e huaja mund ta luajë diaspora e saj dinamike, e cila është e shtrirë dhe integruar mirë në shtetet si Gjermania, Zvicra, MB-ja, Suedia, SHBA-të, etj.

Ky studim i ka shqyrtuar tregjet në të cilat prodhimet e Kosovës kanë potencialin për t'u eksportuar në sasi më të mëdha – BE, rajonin e CEFTA-s, SHBA dhe Turqi. Fokusi kryesor i është përqendruar rregullave dhe kriterëve për import të cilat do të duhet t'i plotësojnë eksportuesit kosovarë në mënyrë që të mund t'i eksportojnë prodhimet e veta. Konkludimi kryesor është se në rast se eksportuesit kosovarë do të ishin në gjendje që të plotësonin këto standarde vendore dhe do të mund të arrinin nivelin e produktivitetit dhe cilësisë që do t'i bënin prodhimet e tyre konkurruese në këto tregje, ata do të mund ta zgjeronin bazën e konsumatorëve dhe të gjeneronin të ardhura të konsiderueshme. Pjesët që kanë të bëjnë me kriteret e tregut ofrojnë pikë të mirë referimi për eksportuesit potencial rreth çështjeve kyçe që duhet të merreshin parasysh në kohën kur do të parashikohej hyrja në këto tregje.

Në të njëjtën kohë, ky raport është koncentruar në sektorët vendorë që kanë potencialin më të madh për të gjeneruar të ardhura nëpërmjet eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Këta sektorë janë: bujqësia, përpunimi i ushqimit, përpunimi i drurit, materialet ndërtimore, artizanatet dhe turizmi.

Bujqësia dhe përpunimi i ushqimit janë sektorët më të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës dhe kanë potencial të mirë që të mbështesin aktivitetet konkurruese duke prodhuar prodhime që do të zëvendësonin importin në tregun vendor si dhe të zgjeroheshin në tregjet e huaja, veçanërisht ato të rajonit. Bazuar në një sistem relativisht të mirë të ujitjes dhe qasjes në ujë, prodhimi i pemëve dhe perimeve do të mund t'a zëvendësonte importin në tregun vendor si dhe të zgjerohet në tregjet e huaja, duke filluar me rajonin e CEFTA-s. Kosova gjithashtu mund të kultivojë pemë, arra dhe fruta të buta dhe mund të konkurroj me importin në rast se do t'i kushtojë më shumë vëmendje cilësisë, ruajtjes dhe krijimit të prodhimeve vendore. Vera është prodhim në të cilin aktualisht Kosova ka bilanc tregtar pozitiv dhe në rast se ruhet cilësia dhe rritet sasia, Kosova ka gjasa të mira që të rrisë eksportin në mënyrë të konsiderueshme. Aktivitetet tjera bujqësore me potencial për zëvendësim importi dhe eksport përfshijnë mbledhjen e të lashtave nga pyjet dhe kullotat e papërpunuara (barishte), rritja e çajit, barishteve, kërpudhave dhe zbukurimet. Tregu për prodhime organike gjithashtu paraqet mundësi të mira për prodhuesit kosovarë.

Përmirësimet në kullota dhe zhvillimi i foragjereve mund të përmirësojnë konkurrencën dhe do të hapnin mundësi më të mëdha për eksport në sektorin e mishit të gjedhit. Sasi të kufizuara të qengjave tanimë janë eksportuar në rajon dhe ekziston potencial i mirë për gjetjen e rrugëve drejt tregut të BE-së. Mishi i pulës paraqet potencial, mirëpo si hap i parë do të ishte racionale që eksportuesit kosovarë të testonin tregjet rajonale (që janë më pak konkurruese) para se të përqendroheshin te tregu më i gjerë global.

Sa i përket kompanive për përpunimin e mishit, pengesa më e madhe aktualisht është rihapja e tregjeve për eksport. Bazuar në lokacionin e vet gjeografik të Kosovës dhe afërsinë me shtetet që nuk janë anëtare të BE-së, siç janë Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Turqia, për fillim do të duhej ndërmerrej një qasje pragmatike afat-shkurtër për tu përqendruar në eksportimin e mishit në këto destinacione, me mundësi të zgjerimit në tregjet më kërkuese të BE-së në fazën tjetër.

Sektorët tjerë për të cilët Kosova ka potencial janë sektorët e bulmetoreve, deleve dhe vezëve. Prodhimi i prodhimeve të bulmetit mund të konkurrojë në tregun rajonal, mirëpo kërkon përmirësim të cilësisë në nivelin e fermës dhe fabrikës.

Në sektorin e përpunimit të ushqimit, pijet si birra, lëngjet e pemëve dhe pijet freskuese mund të konkurrojnë në tregun rajonal. Prodhimi i perimeve dhe pemëve të përpunuara gjithashtu mund të zgjerohet përmes zëvendësimit të importit, ndërsa mund të konsideroheshin edhe tregjet e huaja duke përfutur nga preferencat tregtare.

Materialet ndërtimore llogariten si një potencial i madh ekonomik jo vetëm për zëvendësimin e importit, por edhe për eksport. Aktualisht pothuajse gjysma e materialit ndërtimor prodhohet në vend. Gjatë tre viteve të fundit importi ka mbetur pothuajse i pandryshueshëm derisa në vitin 2013 eksporti është rritur ndjeshëm në krahasim me një vit më parë. Duke marrë parasysh afërsinë gjeografike, ashtu siç shihet edhe nga të dhënat tregtare, tregu rajonal, posaçërisht shtetet anëtare të CEFTA-s, mbesin tregje atraktive për prodhuesit e materialit ndërtimor në Kosovë. Gjatë tre viteve të fundit, mesatarisht pothuajse gjysma e materialeve të eksportuara nga Kosova ishin të destinuara për tregun rajonal, kryesisht në Shqipëri, Serbi, IRJM dhe Mal të Zi. Gjysma tjetër ishte eksportuar në BE dhe Zvicër. Për shkak të kostove të larta të transportit dhe ndikimin e këtyre kostove në çmimin përfundimtar të materialeve ndërtimore, tregu i BE-së dhe ai rajonal paraqiten si tregje më potenciale, veçanërisht tregjet rajonale.

Sektori për përpunimin e drurit në Kosovë ka parakushte të mira për zhvillim dhe ashtu siç sugjerojnë të dhënat e përdorura për këtë studim, një lëvizje e tillë tashmë është vërejtur. Njëra prej përparësive kryesore të këtij sektori është egzistenca e zonave pyjore të mjaftueshme, që ofron bazë të mirë për furnizim me lëndë të parë që nevojitet për këtë sektor. Për më tepër, raporti gjithëpërfshirës për këtë sektor për periudhën 2011-2012 i përpiluar nga UNDP-ja konstaton se të gjithë indikatorët në nivelin e kompanisë, siç janë: ndryshimet pozitive në qarkullim, vlera e prodhimit dhe rritja e punësimit tregojnë ngritje në sektorin e përpunimit të drurit.

Rritja e sektorit është konfirmuar edhe nga të dhënat vjetore për periudhën 2011-2013. Trend i njëjtë është konstatuar edhe kur janë shqyrtuar të dhënat më të hollësishme mujore të këtij sektori. Sa i përket tregjeve për eksport, shtetet fqinje janë një destinacion i rëndësishëm të cilat kanë një pjesëmarrje të respektueshme në eksportin e këtij sektori, megjithatë tregjet kryesore janë Zvicra dhe Gjermania të cilat shfaqin potencial të madhë për produktet kosovare të këtij sektori. Prodhimet kryesore të eksportuara janë orënditë e drurit për dhoma të ditës, kuzhina dhe dhoma të fjetjes. Supozohet se arsyeja për këtë ka të bëjë me faktin se në këto shtete ekziston një numër i madh i diasporës kosovare. Kjo e gjetur edhe një herë e përforcon idenë se bizneset kosovare për përpunimin e drurit, si edhe bizneset tjera, duhet t'i kenë cak këto shtete në mënyrë që të maksimizojnë mundësitë për eksport të suksesshëm. Megjithatë ky sektor ka një deficit tregtar të ndjeshëm. Sa i përket organizimit, ky sektor konsiderohet ndër më të organizuarit, derisa sektori për përpunimin e drurit i përfaqësuar nga Shoqata për Përpunimin e Drurit të Kosovës (ShPPDK) kryen shumë aktivitete për të lehtësuar nevojat e prodhuesve individual si dhe ato të sektorit në tërësi.

Zejet artizanale kanë një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës. Kjo për shkak të industrializimit të ulët të ekonomisë, kështu që artizanët mbeten aspekt i rëndësishëm për gjenerimin e të ardhurave. Në Kosovë shkathtësitë mjeshtrërore janë përcjellë nga gjenerata në gjeneratë dhe mbeten mjaft të pranishme në ekonomi.

Të dhënat në dispozicion sugjerojnë se artizanati gjeneron sasi të dukshme të aktivitetit ekonomik. Eksporti i prodhimeve artizanale gjatë viteve 2011 dhe 2012 ishte afro 1 milion euro. Tregjet kryesore

për eksportet e tilla janë Gjermania dhe Zvicra të përcjellë nga Shqipëria dhe Mali i Zi. Ashtu siç ishte konstatuar me sektorët tjerë, sektori i artizanateve duket se eksporton kryesisht në shtetet evropiane ku është e koncentruar diaspora kosovare, d.m.th. Gjermania dhe Zvicra. Marrë parasysh këto gjetje, artizanët kosovar duhet ta shfrytëzojnë këtë “platformë” të diasporës kosovare që jeton në shtetet e Evropës perëndimore për të shtrirë praninë e tyre në këto tregje përmes krijimit të prodhimeve që do t’i joshnin edhe popujt tjerë.

Burimet natyrore dhe trashëgimia kulturore e Kosovës, si dhe pozita gjeografike e saj paraqesin potencial të madh për zhvillimin e turizmit. Në përgjithësi Kosova është e pasur me bjeshkë, liqene artificiale dhe lumenj, kështu që ajo ofron mundësi të dorës së parë për gjueti dhe peshkim, ecje dhe vizita bjeshkatore, sporte dimërore, përvoja rurale, ekskursione dhe rekreacion, alpinizëm, paragljading, shpeleologji, etj. Fusha e shëndetit të mirë në Kosovë gjithashtu ofron potencial të madh për zhvillim. Burimet e shumta termike të Kosovës janë të njohura mirë në rajon për efektet shëruese. Prodhimi i gjithëmbarshtëm i artizanateve në Kosovë, siç është filigrani (argjendi), paraqet edhe një atraksion për turistët e huaj. Për më tepër, Kosova ka potencial për zhvillimin e turizmit kulturor me disa vende religjioze dhe të tjera që kanë vlerë të jashtëzakonshme kulturore dhe historike. Eko-turizmi dhe agro-turizmi po ashtu ofrojnë mundësi të mëdha.

Implikimet praktike të kësaj janë se operatorët dhe agjencitë turistike do të duhej t’i përqendronin përpjekjet e tyre nëpërmjet një strategjie tri degëshe: i) të përfitojnë në mënyrë të plotë nga mundësitë rajonale duke vënë theksin në mënyrë më agresive në tregjet e fqinjëve me pako dhe oferta të përshtatura nevojave dhe preferencave të tyre; ii) të integrojnë shërbimet me operatorët rajonal dhe kompani të transportit në rrjetet dhe klientelën e tyre të krijuar duke tërhequr turistët e tyre në ‘shëtitje të zgjeruara’ në Kosovë; dhe iii) shfrytëzimi i diasporës së madhe të Kosovës për të arritur segmente më të pasura të tregut turistik, posaçërisht në BE dhe SHBA.

Është me rëndësi të theksohet se kushtet e sektorit të turizmit në Kosovë janë mjaft të favorshme për zhvillimin e objekteve të vogla mikpritëse dhe atyre që udhëhiqen nga familjarët “fjetje & mëngjes” si dhe promovimi i eko-turizmit dhe agro-turizmit. Megjithatë kjo nuk i lë anash edhe qendrat më të mëdha turistike, posaçërisht ato të ndërlidhura me turizmin dimëror në lokacionet e përshtatshme malore të rajonit, siç janë zona e Brezovicës dhe Grykës së Rugovës.

REFERENCAT

Çausi dhe Marku (2013). Gjendja aktuale e industrisë së prodhimit të drurit në Shqipëri. Zhurnali i Shkencave Bujqësore (AJAS), Vëllimi 12, numër 4 (2013).

Komisioni i BE-së (2013). Raport ekzaminues – Mali i Zi: Kapitulli 1 – Qarkullimi i lirë i mallrave.

Komisioni i BE-së (2013). Raporti ekzaminues – Mali i Zi: Kapitulli 16 – Taksimi. Në dispozicion në linkun: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/montenegro/screening_reports/screening_report_montenegro_ch16.pdf

FAO (2012). Zhvillimi i Agro-Industriës në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore – raport i shkurtër – Serbia

FAO (2012). Zhvillimi i Agro-Industriës në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore – raport i shkurtër – Bosnja dhe Hercegovina

Zyra Shtetërore e Statistikave të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (2014). Libri vjetor i statistikave për vitin 2014 të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Zyra Shtetërore e Statistikave të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, (2014). IRMJ-ja në shifra 2014

IFC (2008). IFC dhe Materialet Ndërtimore: Ndihma në Zgjerimin e Infrastrukturës – Avancimi i Ngritjes Ekonomike në Tregjet në Rritje.

MBPZHR (2013). Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve të Kosovës 2012.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të Shqipërisë (2011). Fakte nga Bujqësia në Shqipëri.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave e Malit të Zi (2010). Rregulloret për Masa Fitosanitare për Materialin Ambalazhues nga Druri në Tregtinë Ndërkombëtare.

Mustafa M., Zogaj A., dhe Abdixhiku L. (2010). Sfidat e Ri-industrializimit në Kosovë. Artikull pune.

SEED (2002). Studimi mbi ndërtimin e sektorit të ndërtimtarisë dhe zhvillimi i sistemit të gypave – Shqipëri

Doganat e Serbisë (2014). Rregullorja për harmonizimin e nomenklaturës së tarifave doganore për vitin 2014.

UNDP (2014). Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë.

UNDP (2014). Vlerësimi Bazë i Rajonit Ekonomik Jug, Kosovë.

UNDP (2014). Profili i Sektorit të Industriës së Përpunimit dhe Paketimit të Ushqimit në Kosovë.

UNDP (2014). Profili i Sektorit të Turizmit në Kosovë.

UNDP (2014). Profili i Sektorit të Industriës së Përpunimit të Drurit në Kosovë.

USAID (2010). Strategjia e Mundësive Bujqësore në Kosovë.

Banka Botërore (2009). Raporti Tremujor Ekonomik i Kosovës.

Banka Botërore (2015). Prospektet Globale Ekonomike. Në dispozicion në linkun: http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/GEP/GEP2015a/pdfs/GEP2015a_chapter2_regionaloutlook_ECA.pdf